

PERMBAJTJA	FAQE
SHQIPERIA	
HYRJE	1
PJESA I	
PARAQITJA E PERGJITHSHME E ZBATIMIT TE KONVENTES	1-14
KAPITULLI I	
VESHTRIM I PERGJITHSHEM I SHQIPERISE	
1. TERRITORI, POPULLSIA DHE EKONOMIA	1-4
1.1 Territori	1-2
1.2 Popullsia	2-3
1.3 Ekonomia	3-4
2. HISTORIA, POLITIKA DHE SHTETI	4-9
2.1 Historia	4-5
2.2 Politika	5
2.3 Shteti	5-9
1. Pushteti legjislativ	5-6
2. Presidenti	6
3. Pushteti ekzekutiv	6-7
a) Këshilli i Ministrave	
b) Qeverisja vendore	
4. Pushteti Gjyqësor	7-9
KAPITULLI II	
MASAT E MIRATUARA LIGJORE, POLITIKE DHE ADMINISTRATIVE PER TE ZBATUAR CEDAW	9-14
II.1 Korniza ligjore ku jane te mbrojtura te drejtat njerezore	9-10
II.2 Përfshirja e Konventës CEDAW në sistemin ligjor vendas	10
II.3 Mekanizmi Kombëtar për Mbrojtjen e të drejtave të grave	10-14
1. A. Në qeveri. Veprimtaria e KGF	10-11
2. Nënkomisioni Parlamentar për Gruan dhe Rininë	11
3. Forumet e grave në partitë politike	12-13
4. Organizatat joqeveritare dhe shoqatat e grave	13-14

PJESA II

INFORMACION SPECIFIK PER SECILEN DISPOZITE ET KONVENTES

KAPITULLI I 14-20

I.1 Barazia ndërmjet burrave dhe grave- korniza ligjore 14-16

NENI 1

I.1.1. Përcaktimi i diskriminimit sipas legjislacionit shqiptar 15

NENI 2

I.1.2 Përpjekjet për eliminimin e diskriminimit në Shqipëri 17

I.1.3. Ekzistenca e praktikave diskriminuese kundër grave 17

NENI 3

ZHVILLIMI I GRUAS NE SHQIPERI

I.3.1 Mekanizmat kombëtare për zhvillimin e gruas 18

I.3.2 Shoqatat dhe organizatat joqeveritare 18

NENI 4

Veprimet pozitive për të përshpejtuar barazinë 18-19

KAPITULLI II 20-23

NENI 5

STERIOTIPET DHE DHUNA 20-21

II.5.1 Rolet e seksit dhe steriotipet

Zakonet kulturore dhe tradicionale që pengojnë përparimin e gruas në shoqëri

II.5.2 Rolet e burrit dhe gruas në familje dhe shoqëri

II.5.3 Steriotipi në librat shkollorë dhe media

II.5.4 Kryefamiljari sipas ligjit dhe zakonit

II.5.5 Puna e grave dhe burrave, përgjegjësitë familjare

DHUNA NE FAMILJE 22-23

KAPITULLI III **23-26**

NENI 6

III.1 PROSTITUCIONI

III.2 TRAFIKU I GRAVE DHE VAJZAVE

III.3 PORNOGRAFIA DHE NGACMIMI SEKSUAL

III. 3. 1 Pornografia

III. 3. 2 Ngacmimi seksual në vendet e punës

KAPITULLI IV **26-28**

JETA POLITIKE DHE PUBLIKE

NENI 7

IV. 1 Pjesmarrja në jetën politike dhe publike në Shqipëri

NENI 8

IV. 2 Përfaqësimi ndërkombëtar dhe pjesmarrja

KAPITULLI V **28-29**

SHTETESIA

V.I Marrja e shtetësisë

V.II E drejta për të braktisur shtetësinë

KAPITULLI VI **29-33**

ARSIMI

NENI 10

VI.1 Arsimi i detyrueshëm

VI.2 Arsimi i mesëm

VI.3 Arsimi i lartë

VI.4 Norma e braktisjes së shkollës

KAPITULLI VII **33-38**

PUNESIMI

NENI 11

VII. Ndalimi i diskriminimit në punë dhe profesion

VII. 1 Tregu i punës

VII. 2 Shpërblimi i barabartë

VII. 3 E drejta për mbrojtjen e mëmësisë

VII. 4 E drejta për sigurime shoqërore

VII. 5 Puna e natës

VII. 6 Emigracioni

VII. 7 Punësimi part-time dhe puna në shtëpi

VII. 8 Puna e papaguar

VII. 9 Vetëpunësimi

KAPITULLI VIII

38-44

NENI 12

SHENDETI

VIII. 1 Shërbimet shëndetësore bazë

VIII. 2 Shëndeti riprodhues

Planifikimi familjar

Vdekshmëria amëtare

VIII.3 Sëmundjet seksualisht të transmetueshme

VIII.4 Substancat droguese

4.1 Abuzimi me drogën

4.2 Duhani dhe alkooli

KAPITULLI IX

44-46

NDIHMAT SOCIALE DHE EKONOMIKE

NENI 13

IX.1 E drejta për ndihmë familjare

IX.2 E drejta për kredi bankare, për të hipotekuar dhe për forma të tjera

Të kreditimit financiar

IX. 3 E drejta për të marrë pjesë në aktivitetet krijuese, sporte dhe në të gjitha aspektet e jetës kulturore

KAPITULLI X

46-49

GRATE FSHATARE

NENI 14

X.1 Situata e përgjithshme

X.1.1 Kushtet e jetesës në zonat rurale krahasuar me zonat urbane

X.2 Të drejtat specifike

X.2.1 Mundësi për të patur pronësinë e tokës

X.2.2. Mundësi për në vendimmarrje

X.2.3 Mundësitë për shpërblime shëndetësore

X.2.4 Mundësitë për sigurime shoqërore

X.2.5 Mundësitë për kredi bujqësore dhe mjete marketingu

KAPITULLI XI

49-52

BARAZIA PARA LIGJIT DHE NE CESHTJET CIVILE

NENI 15

XI.I BARAZIA E BURRAVE DHE GRAVE PARA LIGJIT

XI.II KUADRI LIGJOR I GRAVE

XI. 1 Kuadri i përgjithshëm ligjor

XI. 2 Pronësia

XI. 3 Trashëgimia

XI. 4 Lëvizja e lirë dhe zgjedhja e vëndqëndrimit

XI. III MUNDESITE PER MBROJTJE LIGJORE

1. Mundësitë në organet e drejtësisë

2. Mundësitë për shërbime ligjore falas

KAPITULLI XII

52-55

BARAZIA NE MARTESE DHE NE JETEN FAMILJARE

NENI 16

XII.1 E drejta për t'u martuar

XII.2 E drejta për t'u divorcuar

XII.3 Të drejtat e familjes

SHTOJCA STATISTIKORE

BIBLIOGRAFIA

**RAPORTI KOMBETAR PERIODIK FILLESTAR DHE I PARE
KONVENTA PER ELEMENIMIN E TE GJITHA FORMAVE TE DISKRIMINIMIT KUNDER
GRUAS**

SHQIPERIA

HYRJE

Qeveria shqiptare paraqet raportin fillestar dhe të pare (raport i kombinuar) pranë Sekretarisë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, në pajtim me detyrimet si palë nënshkruese (Neni 18 i Konventes), rrjedhimisht edhe si palë shtetërore, të Konventës për Eleminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr. 7767, datë 09.11.1993).

Raporti i paraqitur jep në PJESËN I një përmbledhje të situatës politike dhe social-ekonomike të gruas në Shqipëri, të masave aktuale legislative, kushtetuese dhe administrative të marra për eliminimin e diskriminimit të gruas, dhe të programeve të hartuara që nga ratifikimi i Konventës (1994– 2000).

Raporti, në PJESËN II përmban analizat nen për nen të zbatimit të Konventës në Republikën e Shqipërisë.

PJESA I

PARAQITJA E PËRGJITHSHME E ZBATIMIT TË KONVENTËS

**KAPITULLI I
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SHQIPËRISË**

1. TERRITORI, POPULLI DHE EKONOMIA

1.1 Territori

Republika e Shqipërisë është e vendosur në Gadishullin e Ballkanit, e kufizuar nga Greqia në Jug, Republika e Maqedonisë (FYROM) në Lindje, Mali i Zi dhe Kosova në Veri dhe detet Adriatik dhe Jon në Perëndim dhe Jugperëndim. Territori kombëtar përfshin 28,748 km², nga të cilat rreth 30% ndodhen me shume se 1000 metra mbi nivelin e detit. Dy të tretat e territorit perbehen nga kodra dhe male, ndersa pjesa tjeter perbehet nga rrafshnalta me nje lartesi deri ne 300 m mbi nivelin e detit. Gjatësia e përgjithshme e vijës kufitare është 1094 km, nga të cilat 316 km janë vijë bregdetare, 657 km kufi tokësor, 48 km kufi lumor dhe 73 km kufi në liqene.

Shqipëria ka gjithsej 2.875.000 ha tokë nga e cila 24 % (699.000) ha janë tokë bujqësore (arable land), 36% (1.027.000 ha) janë pyje (forestry), 1% (446.000 ha) janë livadhe dhe kullota (pasture) dhe 25% (703.000 ha) janë toka të tjera.

Ne ultesiren bregdetare klima eshte mesdhetare, me vere te thate dhe te ngrohte dhe kryesisht me dimer te lagesht dhe te ftohte. Sasia vjetore e reshjeve varion nga rreth 1000mm ne vendet e uleta deri ne 3000 mm ne vendet e larta. Rreth 90% e reshjeve bie nga Tetori deri ne Prill. Si rezultat, thatesira eshte e zakonshme ne vere, ndersa ne dimer malet jane të mbuluara me borë.

1.2 Popullsia

Popullsia e Shqiperise eshte 3.182.417 banore (regjistrimi i vitit 1989), me nje dendesi prej 115.8 banore per km². Nga ky regjistrim doli se 1.638.074 banore ose 51.5% ishin meshkuj dhe 1.544.343 femra ose 48.5% ishin femra. 1.137.562 ose 35.7% jetonin ne qytete dhe 2.044.855 ose 64.3 ne fshat.

Popullsia e Shqiperise eshte etnikisht homogjene. Sipas regjistrimit te vitit 1989 vetem 2% e popullsisë ose 64.816 nga 3.182.417 banoret ishin me kombesi tjeter: me kombesi greke, me kombesi maqedonase dhe me kombesi malazeze.

Ne Shqiperi bashkejetojne ne menyre paqesore dy fe: islamike dhe krishtere, me kater bashkesi fetare kryesore, myslimane, bektashiane, orthodoxe dhe katolike. Nga viti 1967 deri ne vitin 1991 feja ishte e ndaluar.

Gjuha zyrtare eshte gjuha shqipe.

Gjate periudhes 1950- 1980, popullsia shqiptare u rrit 2.4% si pasoje e politikave prenatale dhe e mungeses se emigracionit. Midis viteve 1950 dhe 1990 numri i banoreve pothuajse u trefishua, duke shkuar nga 1 215 000 në 3 356 000. Sipas INSTAT që nga vitit 1991 norma e rritjes natyrale ka rënë në 1.9% si rezultat i një zvogelimi të mprehtë te numrit te lindjeve, si pasoje e situates se pasigurte ekonomike, perdorimit te kontraktivëve dhe fluksit te emigrimit.

Popullsia eshte kryesisht fshatare. Në 1989 njerezit qe jetonin ne zonat rurale perbenin 64.5% te popullsisë dhe nga viti 1996 ky raport u ul në 56%. Deri ne vitin 1979, norma mesatare vjetore e popullsisë është më e lartë për burrat, 2.35% e krahasuar me 2.25 % për gratë, ndërkohë vitet 1990-1998 shihet një rritje vjetore e popullsisë prej 6.51% për gratë dhe norme rritje negative për burrat me -2.11%.

Piramida e moshes pasqyron një popullsi të re: në 1997 te rinjte nën moshën 20 vjeç perbenin 41.7% te popullsisë në krahasim me 20-25% të vendeve fqinje. Jetegjatesia është vlerësuar të jetë mbi 74 vjet për gratë dhe mbi 68 vjet për burrat. Sipas disa treguesve jetegjatesia si per burrat dhe gratë pesoi nje renie të lehtë pas arritjes së kulmit të saj historik në vitet 1980.

Numri i lindjeve eshte ulur nga 7 fëmijë për grua në 1960, në më pak se 2.6 fëmijë për grua në 1995 dhe 2.5 fëmijë për grua në 1997. Lindshmëria është rreth 25% më e lartë në vendet rurale se në zonat urbane. Vdekshmëria foshnjore (për 1000 lindje) është zvogeluar gjatë vitit 1998 (20.5/1000 lindje të gjalla) në krahasim me periudhën 1987-1997. Në vitin 1996 numri i lindjeve të gjalla meshkuj ishte 35 mijë ose 51,4% të lindjeve të gjalla totale, ndërsa lindjet e gjalla femra ishin 33 mijë ose 48.6% të lindjeve të gjalla totale¹.

Gratë akoma martohen të reja, megjithëse moshë mesatare për martesë është në rritje, nga një mesatare 21.8 vjeç në 1950 në 23 vjeç në 1990, ndërsa për burrat është e qëndrueshme, në 27 vjeç. Martesat me mblesëri janë akoma të zakonshme dhe pas martesës gruaja shkon pranë familjes së burrit.

Gjatë regjimit të mëparshëm emigrimi ishte pothuajse tërësisht i ndaluar. Megjithatë, gjatë dhjetë vjetëve të fundit, ka patur një sërë fluksesh të emigrimit të padokumentuar, kryesisht në Greqi, Itali, Gjermani, SHBA dhe Kanada. Megjithatë sipas të dhënave të Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Çështjeve Sociale, kjo shifer është rreth 600 mijë në periudhën 1990-1997. Numri i emigrantëve shqiptarë në Greqi është rreth 400 mijë, nga të cilët 160 mijë janë gra, ndërkohë në Itali janë 150 mijë emigrantë, prej të cilëve 30% janë gra.

1.3 Ekonomia

Shqipëria paraqiti të dhëna impresionuese në vitet e para të tranzicionit. Pas një rënie në vitet 1989-1992 ekonomia njohu një zhvillim të fuqishëm në vitet 1993-1996 (Tabela 1). Norma mesatare vjetore e inflacionit u zvogëluar nga 226%, në vlera me një shifer në vitin 1995, 6%. Rritja ekonomike udhëhoq fillimisht nga riperteritja e bujqësisë dhe shërbimeve, si dhe nga dërgimi i parave nga jashtë, ndërsa industria nuk po riaktivizohej deri në 1996. Shqipëria trashëgoi nga periudha komuniste një sektor industrial të vjetëruar dhe joefektiv. Nga viti 1994 kontributi i saj për GDP-në u ul në 12.4% krahasuar me 37.2% në 1990, (kur GDP ishte 25% më e madhe se në 1994). Në terma reale prodhimi industrial në vitin 1996 përbënte vetëm 26.5% të atij të vitit 1989. Rënia u ndal në vitin 1995 dhe rritja do të kishte vazhduar po të mos kishin qenë trazirat e vitit 1997. Këto ndryshime strukturore në GDP sollën ndryshime në strukturën e fuqisë punëtore dhe të punësimit. Punësimi në sektorin industrial ra në mënyrë drastike nga 22% në vitin 1991 në rreth 8% në vitin 1996; bujqësia dhe sektori i shërbimeve patën një rritje, por jo e mjaftueshme për të kompesuar rënien e industrisë. Si rezultat, u shfaqën emigracioni dhe papunësia duke arritur kulmin në vitin 1993, me 22% të forcës aktive të punës.

Në vitin 1997 Shqipëria ra pothuajse në anarki, si rezultat i përmbysjes së skemave piramidale. Borxhi total është vlerësuar në 50% të GDP. Krijimi i skemave piramidale mund të shpjegohet nga një sërë faktorësh. Së pari, sektori financiar ishte fillestar dhe nuk ishte në gjendje të plotësonte kërkesat e sektorit privat për kredi dhe si rrjedhim u zhvillua një treg jozyrtar për kredite bazuar në lidhjet familjare dhe të financuar nga dërgimi i parave nga jashtë. Së dyti, korniza rregulluese ishte e papërshtatshme për garantuar kursimet dhe nuk ishte e qartë se kush ishte përgjegjës për të mbikëqyrur tregun jozyrtar.

¹ INSTAT Men and Women in Albania, 1998

Kthimi i nje stabiliteti relativ në vitin 1998 beri qe te rritej prodhimi; prodhimi është vlerësuar të jetë rritur nga 8%, si rezultat i një rritje të fuqishme rreth 20% në sektorin e ndërtimit dhe transportit. Pjesa që zinte bujqësia në ekonomi mbeti rreth 54% në vitin 1998, por madhësia mesatare e fermave prej 1.5 hektarë kufizonte rreptesisht synimet per perfitime te metejshme.

Qeveria u përpoq të vendoste një stabilitet makroekonomik, nisur nga nevoja për të siguruar popullsinë e cila kishte rënë ne nje varfëri të konsiderueshme, kjo e përcaktuar sipas termave te ardhura /ose konsum i ulët si pasojë e mundësive të kufizuara per pune dhe e te ardhurave te ulta, vecanërisht ne zonat rurale. Varfëria në Shqipëri shfaqet gjithashtu edhe ne mundesitë e kufizuara dhe cilesine e ulet te sherbimeve baze si arsimi, kujdesi shendetesor, uji dhe kanalizimet. Gjate periudhes se dimrit ka shpesh nderpreje te energjise elektrike megjithëse kërkesa per energji elektrike është e lartë.

2. HISTORIA, POLITIKA DHE SHTETI

2.1 HISTORIA

Populli shqiptar është autokton në Gadishullin Ballkanik. Paraardhesit e lashtë të popullit shqiptar ishin Ilirët, që jetuan në këtë territor deri ne shekullin e dyte para Krishtit. Ilirët ishin nën sundimin romak për rreth pese shekuj e gjysem. Pas sundimit romak, rajonet e Shqipërisë u sunduan nga Mbreteria Bizantine, Bullgaret, Normanet, Serbet dhe Venedikasit.

Gjate Mesjetes, kulmin e unitetit dhe identitetit kombëtar populli shqiptar e pati gjate periudhes se Heroit Kombëtar Shqiptar, princit Gjergj Kastrioti, Skënderbeu. Gjate shekullit te XIV, per rreth 25 vjet Skenderbeu bashkoi kombin shqiptar dhe i rezistoi me sukses pushtimeve të Perandorisë Turke.

Nga fillim të shekullit të XV e gjithë Shqipëria ra nën sundimin turk qe zgjati për rreth 5 shekuj. Shqipëria fitoi pavarësinë kombetare në vitin 1912 dhe kufij te ri u percaktuan (ne te cilet u humb Kosova dhe disa pjese jugore).

Deri ne vitin 1928 u krijua nje qeveri parlamentare, e cila me pas u kthye ne monarki nen sundimin e Mbretit Zog I. Mbreti mbretëroi me përkrahjen e Italisë deri në vitin 1939, vit ne te cilin forcat ushtarake italiane pushtuan vendin. Pushtimi italian përfundoi në vitin 1943 dhe Shqipëria u pushtua nga Gjermania deri në vitin 1944. Pas mbarimit të Luftës se Dytë Botërore me fitoren e forcave antifashiste, Shqipëria u rreshtua ne bllokun antifashist, vendosi regjimin komunist i cili qendroi ne pushtet per kater dekada.

Gjatë viteve 1945-1948 Jugosllavia ishte shteti i huaj që ushtronte një influencë të madhe në Shqipëri, për t'u zëvendësuar nga BRSS deri në vitin 1960, më pas nga Kina deri në vitin 1978. Nga viti 1978 e deri në vitet e fundit të 1980-ës vendi ishte i izoluar nga komuniteti ndërkombëtar. Gjate kesaj periudhë qeveria ushtroi kontroll te pergjithshem ne të gjitha aspektet e ekonomisë, jetës sociale e intelektuale.

Qe nga viti 1945 kur u vendos regjimi komunist autoriteti politik kryesor ishte Enver Hoxha, sekretari i parë i PPSH deri në vdekjen e tij në vitin 1985. Ai u pasua nga Ramiz Alia, anëtar i Partisë që nga viti 1940. Nga mesi i viteve '80 gjendja ekonomike u keqesua dhe nga fundi i viteve '80 qeveria filloi një proces gradual të liberalizimit dhe kontaktet me vendet e tjera. Nga 1989-1990 keqësimi i gjendjes ekonomike shkaktoi protesta publike dhe një fluks emigrimi të pakontrolluar për në Greqi dhe Itali.

Zgjedhjet e para pluraliste janë mbajtur në mars të 1991. Partia qeverisëse, Partia Socialiste fitoi mbështetjen e popullsisë rurale, ndërkohë që popullsia urbane votoi për Partinë Demokratike. Shqipëria adoptoi Dispozita të reja Kushtetuese dhe një proces të liberalizimit dhe të hapjes me vendet e tjera. Një valë e re grevash në janar-maj 1991 çoi në formimin e një qeverie të stabilitetit me pjesmarrjen e partive opozitare. Qeveria e Stabilitetit funksionoi deri në nëntor të vitit 1991 kur PD u tërhoq dhe u zëvendësua nga një qeveri teknike. Zgjedhjet e reja u mbajtën në mars të vitit 1992, ku fitoi PD. PD fitoi edhe në zgjedhjet e vitit 1996, por kjo nuk zgjati shumë si rezultat, i krizës së skemave piramidale në fillim të vitit 1997. Qeveria e Pajtimit Kombëtar udhëhoqi Shqipërinë në zgjedhjet e reja në qershor të vitit 1997, që u fituan nga koalicioni i majtë i udhëhequr nga Partia Socialiste.

2.2 Politika

Megjithëse në Shqipëri veprojnë një numër i madh organizatash politike, shumë prej tyre nuk arrijnë kuotën minimale prej 4% për t'u përfaqësuar në Parlament. Në vitin 1998, Kushtetuta e re e uli kuotën në 2.5% për partitë, dhe 4% për koalicionet. Parlamenti ka qënë i dominuar që nga rënia e komunizmit nga një bipolaritet i PS dhe i PD. Secila parti e madhe kryeson një grup partish të vogla; në grupimin Aleanca për Shtetin, përfshihen Partia Socialiste, Partia Aleanca Demokratike, Partia Social Demokratike, Partia Agrare, Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, Partia e Unitetit Kombëtar. Në grupin Bashkimi për Fitore përfshihet Partia Demokratike, Partia Monarkiste, Partia Republikane, Partia e Ballit Kombëtar, Partia Legaliste dhe Partia Bashkimi Socialdemokrat.

2.3 SHTETI

Shqipëria është republikë parlamentare. Republika e Shqipërisë është shtet unitar (neni 1 i Kushtetutes). Sistemi i qeverisjes bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor (neni 7 i Kushtetutes).

1. Pushteti Legjislativ

Pushteti legjislativ i përket Kuvendit të Shqipërisë (Parlamenti). Kuvendi është një dhomë dhe përbehet nga 140 deputetë të zgjedhur çdo katër vjet. 100 deputetët janë të zgjedhur direkt nga populli, nga një anëtar në një zonë elektorale dhe 40 deputetë janë të zgjedhur nga lista shumëemërore e partisë apo koalicionit partiak, sipas renditjes në to, (Neni 64 i Kushtetutes).

Zgjedhjet për Kuvendin zhvillohen 60 ditë deri në 30 ditë para mbarimit të mandatit dhe jo

me vone se 45 dite pas shperndarjes se tij. Mandati i Kuvendit te Shqiperise vazhdon deri ne mbledhjen e pare te Kuvendit te ri. Ne kete kohe Kuvendi nuk mund te nxjerre ligje ose te marre vendime, me perjashtim te rasteve te vendosjes se masave te jashtezakonshme, (Neni 65 i Kushtetutes).

Deputet i Kuvendit mund te zgjidhet cdo qytetar qe ka mbushur moshen 18 vjec (nenit 45 i Kushtetutes). Nuk mund te kandidojne e as te zgjidhen deputet pa hequr dore nga detyra, keto kategori: a) gjyqtaret, prokuroret; b) ushtaraket e sherbimit aktiv; c) punonjesit e policise dhe sigurimit kombetar; d) kryetaret e bashkive dhe te komunave si dhe prefektet ne vendet ku kryejne detyrat e tyre. dh) kryetaret dhe anetaret e komisioneve te zgjedhjeve; e) Presidenti i Republikes dhe funksionaret e larte te administrates shteterore te parashikuar nga ligji (neni 69 i Kushtetutes). Deputeti nuk mund te ndiqet penalisht pa autorizimin e Kuvendit (neni 73 i Kushtetutes).

Keshilli i Ministrave, cdo deputet ose 20.000 votues mund te propozojne projektligje per t'u shqyrtuar nga Kuvendi. Disa ligje te rendesishme, si ligji i zgjedhjeve, kerkojne nje shumice prej tre te pestash te te gjitha deputeteve per t'u miratuar. Ligji hyn ne fuqi pas nenshkrimimit nga Presidenti dhe botimi ne Fletoren Zyrtare (neni 81 i Kushtetutes).

2. Presidenti i Republikes

Kryetari i shtetit eshte Presidenti, i cili zgjidhet nga Kuvendi me nje shumice prej tre te pestash per nje mandat pesevjecar. Nese nuk arrihet shumica e kerkuar, pas pese raunde votimesh Kuvendi shperndahet. Kuvendi i ri e zgjedh Presidentin me te njejten shumice prej tre te pestash. Nese as Kuvendi i ri nuk e arrin dot kete shumice, ai shperndahet dhe Presidenti zgjidhet nga Kuvendi pasues me nje shumice te thjeshte. Kur Presidenti i Republikes eshte ne pamundesi te perkohshme per te ushtruar funksionet e tij ose kur vendi i tij mbetet vakant, Kryetari i Kuvendit ze vendin dhe ushtron kompetencat e tij (neni 87 i Kushtetutes).

Presidenti kryen funksionet baze te kryetarit te shtetit: caktimin e dates per zgjedhjet e pergjithshme parlamentare, ushtrimin e se drejtes se faljes, emerimin e Kryeministrit dhe ministrave, emerimin dhe konfirmimin e gjyqtareve, pranimin e kredencialeve diplomatike, lidhjen e marreveshjeve dhe dekretimin e legjislacionit (neni 92 i Kushtetutes), ushtron te drejten e iniciatives legjislative dhe jep te drejten e strehimit politik. Ne lidhje me kete te fundit, Presidenti mund te vere veton mbi nje ligj vetem nje here (neni 85/1 i Kushtetutes).

3. Pushteti Ekzekutiv

a. Keshilli i Ministrave

Keshilli i Ministrave eshte organi me i larte i pushtetit ekzekutiv dhe perbehet nga Kryeministri, zevendes kryeministri dhe ministrat. Kryeministri eshte Kryetar i Keshillit te Ministrave. Kryeministri emerohet nga Presidenti i Republikes ne fillim te legjislatures

se Kuvendit, me propozim te partise ose koalicionit te partive qe ka shumicen ne Kuvend. Ministrat emerohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikes me propozim te Kryeministrit. Keshilli i Ministrave percakton drejtimet kryesore te politikës se pergjithshme shteterore. Ai i merr vendimet me propozim te Kryeministrit ose ministrit perkates. Ne rast nevoje, Keshilli i Ministrave dhe urgjence, mund te nxjerre akte normative qe kane fuqine e ligjit per marrjen e masave te perkohshme. Keto akte normative i dergohen menjehere Kuvendit dhe ne qofte se nuk miratohen prej tij brenda 45 diteve ato humbasin fuqine qe nga nxjerrja e tyre.

b. Qeverisja Vendore

Njesite e qeverisjes vendore jane qarqet, bashkite dhe komunat (Ligji Nr. 8652, 31.07.2000 Per Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore). Shqiperia ndahet ne 12 qarqe, 65 bashki dhe 309 komuna. Secila komune ose bashki dhe qark ka organet e veta te qeverisjes vendore. Organi ekzekutiv i bashkise ose komunes eshte kryetari, i cili zgjidhet me votim te fshehte, drejtperdrejt nga populli. Po ne kete menyre zgjidhet edhe Keshilli, qe eshte organi perfaqesues i njesise se pushtetit vendor. Perfaqesues i qeverise ne qarqe eshte prefekti.

Decentralizimi dhe autonomia e pushtetit vendor parashikohen nga neni 13 i Kushtetutes. Nenet 108-115 te Kushtetutes parashikojne te drejten e pushtetit vendor per te lidhur kontrata, mbledhur taksa, administruar te ardhurat dhe pronat e tyre ne menyre te pavarur dhe per te nxjerre akte me fuqi ligjore.

4. Pushteti Gjyqesor

Pushteti gjyqesor zgjidh mosmarreveshjet lidhur me interpretimin dhe zbatimin e ligjeve. Ky pushtet ushtrohet nga Gjykata e Larte, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e Shkalles se Pare (gjykatat e rretheve). Gjykatat ushtrojne tre tipe juridiksioni: juridiksioni civil, juridiksioni penal dhe juridiksioni administrativ.

Gjykata e Larte ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Gjykata e Larte ka juridiksion fillestar ne rastet kur gjykon akuzat penale kunder Presidentit te Republikes, Kryetarit dhe anetareve te Keshillit te Ministrave, deputeteve, gjyqtareve te Gjykates se Larte dhe asaj Kushtetuese (neni 141 i Kushtetutes) dhe juridiksion rishikues ne ato raste kur shqyrton ankimet ndaj vendimeve te gjykatave te shkalles se pare dhe apelit.

Gjykata e Larte perbehet nga kolegje civile, penale dhe ushtarake dhe ka 17 gjyqtare te cilet emerohen ne detyre nga Presidenti i Republikes, me pelqimin e Kuvendit, per nje mandat 9 vjeçar te parinovuesheme.

Gjykata e Apelit eshte nje gjykate qe shqyrton ne shkalle te dyte te gjitha çeshtjet e gjykuara nga gjykatat e shkalles se pare, te cilat ankimohen nga palet ndergjyqese. Ajo gjykon ne menyre kolegji me trup gjykues te perbere nga tre gjyqtare. Gjykata e Apelit gjykon çeshtjen ne teresi dhe nuk kufizohet vetem me shkaqet e paraqitura ne ankim.

Gjykatat e Apelit funksionojne ne zona te caktuara nga Presidenti i Republikes me propozim te Ministrit te Drejtesise, pasi eshte marre edhe mendimi i Keshillit te Larte te Drejtesise. Aktualisht ekzistojne gjashte gjykata apeli te vendosura ne rrethet: Tirane,

Shkoder, Durres, Korçe, Gjirokaster dhe Vlore me nje numer prej 52 gjyqtarësh. Gjyqtaret e gjykatave te apelit emerohen ne detyre nga Presidenti i Republikës, me propozim te Keshillit te Larte te Drejtesise.

Gjykatat e Shkalles se Pare funksionojne prane çdo rrethi gjyqësor (numri total i tyre eshte 29 dhe kane aktualisht ne organike 293 gjyqtare) dhe kompetenca e tyre shtrihet ne te gjithë territorin e rrethit te cilit i perkasin. Gjykimet realizohen nga nje gjyqtar i vetem, por ne çeshtje te ndryshme mund te zhvillohen edhe gjykime ne kolegje te perbera nga tre gjyqtare.

Gjykatat Ushtarake perbehen nga gjykatat ushtarake te shkalles se pare dhe ato te apelit. Aktualisht, megjithese parashikohen nga ligji si gjykata, faktikisht funksionet e gjykatave ushtarake te shkalles se pare ushtrohen nga trupa gjykues prane gjykatave te rretheve gjyqësore, ndersa gjykata ushtarake e apelit funksionon si gjykate me vehte (me seli ne Tirane).

Keshilli i Larte i Drejtesise perbehet prej Presidentit te Republikës, kryetarit te Gjykeses se Larte, Ministrit te Drejtesise, 3 anetare te zgjedhur nga Kuvendi dhe 9 gjyqtare prej te gjitha niveleve te zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombetare dhe ka nje mandat 5 vjecar. Keshilli i Larte i Drejtesise eshte organi qe emerohet, transferon dhe percakton pergjegjesite e gjyqtareve ne baze te ligjit.

Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe perfaqeson shtetin ne gjykate. Prokurori i pergjithshem eshte emeruar nga Presidenti i Republikës dhe me miratim te Kuvendit (nenet 148 dhe 149 te Kushtetutes) dhe shkarkohet me propozim te tij. Prokuroria i ushtron kompetencat e saj ne menyre te pavarur duke iu nenshtruar vetem kushtetutes dhe ligjeve.

Kontrolli i Larte i Shtetit mbikqyr aktivitetin ekonomik te institucioneve shteterore, perdorimin dhe ruajtjen e fondeve shteterore nga organet e qeverisjes qendrore e vendore dhe aktivitetet ekonomike te personave ne te cilat qeveria zoteron me shume se gjysmen e pjeseve ose aksioneve (ligjet 162-165 te Kushtetutes). Kryetari i Kontrollit te Larte te Shtetit emerohet dhe shkarkohet nga Kuvendi me propozim te Presidentit te Republikës. Mandati i tij eshte 7 vjecar.

4. Gjykata Kushtetuese

Ne veprimtarine e saj Gjykata Kushtetuese i nenshtrohet vetem Kushtetutes se Shqiperise. Ajo gezon pavaresi te plote organizative, administrative e financiare per realizimin e detyrave te caktuara me Kushtetute dhe me ligj.

Gjykata Kushtetuese perbehet nga nente anetare te zgjedhur nga rradhet e juristeve me kualifikim te larte dhe me pervoje pune jo me pak se 15 vjet ne profesion te cilet emerohen nga Presidenti i Republikës me pelqimin e Kuvendit dhe qendrojne ne detyre per nente vjet pa te drejte rimerimi.

Ne zbatim te funksioneve te saj, Gjykata Kushtetuese vihet ne levizje me kerkese te Presidentit te Republikes, Kryeministrin, te nje grupi jo me te vogel se 1/5 e te gjithë deputeteve si dhe te Kryetarit te Kontrollit te Larte te Shtetit. Gjithashtu, ajo mund te vihet ne levizje edhe nga Avokati i Popullit, organet e qeverisjes vendore, bashkesite fetare, partite politike, ose organizata te tjera kur ato argumentojne se çështja lidhet me interesat e tyre, si dhe nga çdo gjyqtar i zakonshem kur gjate shqyrtimit te çështjes çmon se ligji vjen ndesh me Kushtetuten ose nje marreveshje nderkombetare, te ratifikuar nga Republika e Shqiperise. Gjykata Kushtetuese ka keto funksione themelore: interpreton Kushtetuten dhe ligjet; gjykon papajtueshmerine e akteve dhe dispozitave nenligjore, te marreveshjeve nderkombetare, si dhe papajtueshmerine e ligjeve me normat e se drejtes nderkombetare dhe te marreveshjeve ne te cilat Republika e Shqiperise eshte pale.

KAPITULLI I DYTË

MASAT E MIRATUARA LIGJORE, POLITIKE DHE ADMINISTRATIVE PER TE ZBATUAR CEDAW

II.1 KORNIZA LIGJORE KU JANË TË MBROJTURA TË DREJTAT NJERËZORE

Neni 3 i Kushtetutës shpall që "... të drejtat njerëzore dhe liritë.. janë bazat e këtij Shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë ato.", ndërsa Pjesa II (nenet 15-58) parashikon mbrojtjen e të drejtave të qytetarit, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 116 parashikon që instrumentat ndërkombëtare të ratifikuar janë në mbështetje të Kushtetutës dhe jo mbi ligjet e ngjashëm kombëtare (neni 122(2)). Shqipëria miratoi në vitet '90 të gjashtë instrumentat kryesore të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa të tjera rajonale për të drejtat e njeriut. Sipas nenit 180(1), marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara para vitit 1998, vit kur Kushtetuta hyri në fuqi janë konsideruar të ratifikuara dhe në përputhje me të.

Për më tepër, në bazë të neneve 60-63 të Kushtetutës krijohet Avokati i Popullit për të mbrojtur të drejtat dhe liritë individuale nga aktet e paligjshme apo të pahijshme, apo rrëzimin e akteve të organeve të administratës publike. Secili person, grup ose organizatë joqeveritare që përfaqësojnë ata që deklarojnë se kanë patur dhunim të të drejtave të tyre njerëzore sipas ligjit, kanë të drejtë të ankohen dhe të kërkojnë një hetim për zhdëmtim, pasi të kenë ndjekur cdo rrugë të mundshme ligjore. Pas hetimit, Avokati i Popullit mund: të pushojë çështjen; të paraqesë rekomandime pranë institucioneve për të rregulluar të drejtat e dhunuara; të rekomandojë një hetim prej prokurorit publik ose të rekomandojë pushimin nga puna të zyrtarëve fajtorë.

Zyra e Avokatit të Popullit është krijuar në fund të pranverës të vitit 2000. Ankesat i janë drejtuar në lidhje me detyrimet e gjyqtarëve, pronësisë, lirisë së shtypit dhe deklarimin e brutalitetit policor.

Autoriteti dhe funksionet e Avokatit të Popullit janë percaktuar shprehimisht ne dispozitat kushtetuese, ne ligjin per Avokatin e Popullit, si dhe ne Rregulloren e

brendshme të Kodit Etik të Institucionit, të gjitha këto të asistuar edhe nga ekspertet ndërkombetare.

Mbrojtja e te Drejtave te Grave nga Institucioni i Avokatit te Popullit

Nga ankesat e paraqitura prane këtij Institucioni, rezulton se shume pak prej tyre jane bere nga grate. Dhe ato pak raste qe jane prezantuar prej këtyre të fundit, nuk kane patur të bëjnë me shkelje të të drejtave themelore të tyre apo diskriminimin per shkak të seksit, por kryesisht ato kane patur të bëjnë me veprime të administrates së gjyqësorit ose probleme te tjera të rrjedhura nga marrëdhënie te posacme.

Sipas ligjit “ Per Avokatin e Popullit”, në kryerjen e funksionimeve të veta, ky i fundit bashkepunon ngushtë me organizatat joqeveritare, duke marë periodikisht, mendimet e tyre për gjendjen e te drejtave dhe lirive të njeriut. Në këtë kuptim ai ka ofruar bashkepunim OJQ-ve më të angazhuara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke i bërë të ditur funksionin e institucionit dhe strategjinë e tij të bashkëpunimit.

Avokati i Popullit ka bere nje oferte te vecante per cdo organizatë joqeveritare qe merret me mbrojtjen e te drejtave te grave.

II.2. PËRFSHIRJA E KONVENTËS SË CEDAW NË SISTEMIN LIGJOR VENDAS

Procedura për përfshirjen e konventave ndërkombëtare në sistemin ligjor shqiptar është parashikuar në nenet 121-123 të Kushtetutës. Marrëveshjet ndërkombëtare janë ratifikuar nga shumica e anëtarëve të Kuvendit dhe përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm ligjor pas shpalljes nga Presidenti i Republikës dhe publikimit në Fletoren Zyrtare. Shqipëria ratifikoi Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave me ligjin Nr.7767, date 9 Nëntor 1993. Sic është përmendur më sipër, sipas nenit 122(2) të Kushtetutës. Në pajtim me këtë parim hierarkik, i gjithë legjislacioni i mëparshëm duhet rishikuar për të eliminuar ndonjë dispozitë që mund të jetë në kundërshtim me ato të Konventës.

II.3. MEKANIZIMI KOMBËTAR PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË GRAVE

1. Mekanizmat Kombetare per zhvillimin e Gruas

Komiteti Shteteror Gruaja dhe Familja - Komiteti per Mundesi te Barabarta.

Mekanizmat kombetare per mbrojtjen dhe promovimin dhe te drejtat e grave kaloi ne disa stade qe nga krijimi ne 1992, derisa ne vitin 1998 me vendim te KM u ngrit ne nivelin e Komitetit Gruaja dhe Familja ne varesi te drejtperdrejte te KM, ku kryetarja e Komitetit raporton direkt te Zv/kryeministri dhe buxheti i Komitetit Gruaja dhe Familja eshte pjese e buxhetit te Keshillit te Ministrave

1992	Sektori Gruaja dhe Familja, prane Ministrise se Punes, Emigracionit dhe te Perndjekurve Politike
1994	Drejtori Gruaja dhe Familja prane Ministrise se Punes, Emigracionit dhe te Perndjekurve Politike
1996	Sekretariat Shteti prane Ministrise se Kultures, Rinise dhe Gruas
1997	Drejtori Gruaja dhe Familja prane Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Gruas
1998	Komiteti Gruaja dhe Familja, si nje institucion qendror ne varesi te Keshillit te Ministrave me Vendim Nr.415 dt.1/07/1998
2001	Me Vendim te KM Komiteti Gruaja dhe Familja mori emertimin Komiteti për Mundesi të Barabarta.

- Përgjegjësitë e Komitetit Gruaja dhe Familja (VKM Nr.415, date 01.07.1998) janë zbatimi i politikave qeveritare për problemet e gruas dhe te familjes, koordinimi i programeve për nxitjen e barazisë midis burrave dhe grave ne nivelin e pushtetit qendror e lokal, zbatimi dhe vlerësimi i programeve të qeverisë per gruan dhe familjen, propozimi i legjislacionit të ri dhe /ose i amendamenteve e instrumentave ne legjislacionin ekzistues për të drejtat e grave dhe të fëmijëve në pajtim me standartet ndërkombëtare, përkrahja dhe koordinimi i aktiviteteve të OJQ-ve në fushën e të drejtave të grave dhe të familjes.

VEPRIMTARIA E KGF

Objektivi kryesor i veprimtarise se Komitetit GF eshte realizimi i Platformes se Qeverisë Shqiptare për gruan (miratuar me VKM Nr.267, date 03/06/1999). Për më tepër, Komiteti po punon për ngritjen e një sistemi efektiv të informimit për të monitoruar zhvillimin në të gjithë vendin, përmes rrjetit të pikave të kontaktit të caktuara në pushtetin lokal dhe për nxitjen e veprimeve pozitive nga ana e institucioneve përgjegjës (Kuvendi i Shqipërisë, ministrinë, Pushteti Lokal etj). Strategjia e Komitetit Shtetëror “Gruaja dhe Familja” bazohet në konventën e CEDAW-t, në Platformën për Veprim të Pekinit dhe Pekin + 5 dhe në Platformën Kombëtare për Gruan (VKM Nr.267, datë 03.06.1999).

Instrumenti i fundit, ndër të tjera, merr masa për:

- Rritjen e pjesmarrjes së gruas në institucionet qeveritare, në organet e drejtësisë dhe në administratën publike.
- Përpunimin e informacionit dhe inkurajimin e kërkimeve në fushën e barazisë gjinore.
- Rritjen e ndërgjegjësimit të grave për të drejtat e tyre sociale, ekonomike dhe kulurore.
- Përmirësimi i legjislacionit ekzistues në lidhje me përparimin e grave.
- Përmirësimi i punës në rrjet midis institucioneve qeveritare dhe atyre joqeveritare për problemet e barazisë gjinore.

2. Nënkomisioni Parlamentar për Rininë dhe Gruan.

Në maj të vitit 1994 u krijua Grupi i Grave Parlamentare, i cili pas zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 1997 u shndërrua në Nënkomision Parlamentar për Rininë dhe Gruan. Por aktiviteti i tij për gruan është i vakët, nuk është mbrojtur apo miratuar asnjë ligj për gruan.

3. Forumet e grave në partitë politike.

Ne Shqipëri janë krijuar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre këto forume politike të grave:

1) *Forumi i Gruas Socialiste të Shqipërisë (FGSSH)*

u formua në Qershor 1992, është OJQ, është e lidhur dhe mbështet alternativën e Partisë Socialiste. Ky forum ka dege në 36 rrethe të vendit me rreth 30 mijë anëtarë dhe simpatizantë dhe është angazhuar kundër çdo lloji diskriminimi midis seksit, bindjeve, etnive, etj. FGSSH punon për: garantimin e një statusi dinjitoz të grave në të gjitha fushat; Vendosi e barazisë gjinore në këtë shoqëri, në veçanti për zbatimin real të lirisë dhe të drejtave të grave; ruajtjen dhe përsosjen e familjeve shqiptare dhe rritjen e pozitës së gruas në të.

2) *Forumi i Gruas Demokratike të Shqipërisë*

3) *Forumi i Gruas Republikane të Shqipërisë*

Forumi i Gruas Republikane është një organizatë që aktivitetin e vet e ka shtrirë brenda Partisë Republikane dhe Kongresi i Partisë së Krahut i këtij forumi është mbajtur në 12/11/1993 në të cilin u zgjedhën edhe organet e tij drejtuese. Në këtë forum aderojnë 11.5 % të anëtarëve të përgjithshëm të Partisë Republikane. Gjate gjithë veprimtarisë së tij ka mbështetur politikën e Partisë Republikane dhe politikën e gjendjes.

4) *Forumi i Gruas Social-Demokratike*

Forumi i Gruas SocialDemokratike të Shqipërisë është një strukturë politiko-shoqërore që mbështet alternativën e Partisë SocialDemokratike të Shqipërisë. Ky Forum ruan pavaresinë e tij si institucion në veprimtarinë e tij organizative e social-kulturore. Organi më i lartë e Forumit është Kongresi që përcakton politikën e këtij Forumi në përputhje me bazën e Socialdemokracisë. Pas një pune intensive për krijimin e të gjithë degeve, organizata e Gruas SD në 23-24 Qershor 1995 mbledhi Konferencën e Partisë Kombëtare që institucionalizoi këto organizatë, zgjedhi strukturën e saj, aprovoi programin dhe statutin si materiale ku do të mbështetej veprimtaria e organizatës. Me 03/09/1996 në New York të SHBA grua SD u pranua anëtarë me të drejtë të plotë në Internacionalen Socialiste. Ky Forum është për një shoqëri ku çdo jeri mund të zhvillojë personalitetin me liri dhe respekton mundësitë dhe shanset e e barabarta për të punuar dhe kontribuar dhe të jemi të aftë të pranojmë përgjegjësitë “se bashku”.

- 5) Forumi i Gruas Demokristiane
- 6) Levizja e Gruas Liberal-Demokrate
- 7) Forumi i Gruas te Bashkimit te te Drejtave te Njeriut

4. Organizatat joqeveritare dhe shoqatat e grave

Lëvizja e shoqatave joqeveritare në Shqipëri rregullohet me dispozitat e Kodit Civil (ligji Nr.1994, nenet 39 deri 63). Aktualisht po punohet për një legjislacion i ri për shoqatat dhe fondacionet.

Në Gjykatat e Rretheve janë regjistruar rreth 100 shoqata kombëtare dhe OJQ të cilat kanë në fokusin e tyre problemet e barazisë gjinore. Fusha e aktiviteteve të tyre varion që nga planifikimi familjar që është në krye, tek mbrojtja ligjore dhe këshillimi, tek sensibilizimi për problemet e barazisë gjinore, tek dhuna shtëpiake, etj.

Forum i Pavarur i Gruas Shqiptare u themelua ne Shtator 1991 si nje organizate Joqeveritare, jo-fetare, jo-fitimpruese e shperndare ne te gjithë vendin. Qellimet e kesaj organizate jane: mbrojtja e te drejtave te gruas, ngritja e ndergjegjesimit te grave per te drejtat e tyre dhe rolin e tyre ne familje dhe shoqeri, mosmarreveshjet dhe shfrytezimi, ndryshimet raciale dhe fetare etj. FPGSH ka zbatuar shume projekte mbi ceshtjet e permendura me siper.

Organizata Shqiptare per Planifikimin Familjar e themeluar ne 1993 si nje organizate jo-fitimpruese, si nje nga organizatat kryesore qe punojne ne drejtim te permiresimit te te drejtave te shendetit riprodhues ne Shqiperi, duke perfshire dhe planifikimin familjar. Brenda kesaj punon nje grup te rinjsh me emrin "Grupi Rinor" dhe 2 trajnues. Neprmjet tre qendrave te planifikimit familjar te ngritura ne Tirane, Durres dhe Lezhe, ata ofrojne konsulta dhe sherbime falas mbi planifikimin familjar. Ndersa, qe kur u ngrit Qendra Gruas ne Vlore ne 1998, ata ofrojne keshilla ligjore dhe psikologjike. Organizata ka botuar nje game te gjere publikimesh. Prane organizates ka nje biblioteke te pasur.

Rrjeti i Grave "Milenium" dhe Federata Shqiptare e grave punon ne drejtim te te drejtave te femijes dhe gruas, promovimin e shendetit, krijimin e nje rrjeti te OJQ-ve dhe bashkepunimin ndermjet tyre. Ata kane nje eksperience te madhe ne lidhje me aktivitetet qe organizohenper promovimin e pjesemarrjes se gruas ne proceset vendimmarrese.

Te nejtin sukses ka dhe OJQ-ja e grave "Ne dobi te Gruas Shqiptare". Kjo OJQ eshte e fokusuar ne trajnimet per ceshtjet e punesimit, ne ndihmen ekonomike te nevojshme per gruan dhe femijen, dhe ne parandalimin e trafikut te qenieve njerezore etj.

Grupi i OJQ-ve te quajtura "Vatra e Gruas Vlonjate" po punon ne bashkepunim me institucionet shtetore per permiresimin e kuadrit ligjor qe lidhet me trafikun e qenieve njerezore.

Qendra Avokatore e Grave, qe funksionon qe nga Nentori 1997, ofron këshillim falas dhe asistence ne gjykatë për grate e abuzuara dhe per grate qe s'mund te kene asistence ligjore ne ndonje menyre tjeter.

Nje nga organizatat e para te themeluara ne Shqiperi eshte shoqata "Refleksione" e fokusuar ne mbrojtjen e grave kunder dhunes. (shume projekte u transformuan ne OJQ te suksesshme si "Qendra e Grave" qe ofron trajnime dhe informacione mbi grate, "Linja Keshillimi per Grate e Abuzuara" dhe ngritja e qendrave per sistemimin e tyre). Dhuna ne familje u trajtua per here te pare ne vitin 1995, ne nje fushate ndergjegjesimi të ndërmarre nga shoqata "Refleksione". Te dhena te pjesshme tregojne se mbi 63,7% te grave të martuara abuzohet psikologjikisht, fizikisht ose seksualisht dhe nga raporte indirekte tregojnë se vetem 5% e abuzimit te kryer mbi to raportohet. Hapja e qendres së pare per grate që kane pësuar dhunë (Dhjetor 1998) ne Shqipëri është shembull i nevojës për institucione që mbrojne viktimat e abuzimit.

Legjislacioni shqiptar nuk eshte diskriminues kundrejt gruas. Gjithsesi fusha te ndryshme kerkojne rishikime ose plotesime, ne menyre te vecante ato qe kane te bejne me trashëgimime e tokes, ushtrimin e te drejtave te femijeve, dhunen ne familje dhe te drejtat riprodhuese. Per kete grupimi i shoqatave qe merren me te drejtat e grave dhe te miturave ne bashkepunim edhe me ekspert ligjor shteteror jane duke diskutuar si nevoje urgjente Kodin e Ri te Familjes. Se bashku me permiresimin e ligjit dhe statusin ligjor te gruas, organizatat e grave ofrojne asistence ligjore per grate e abuzuara.

Persa i perket menaxhimit te burimeve njerezore, OJQ-të e grave, të krahasuara me tipet e tjera te organizatave joqeveritare, kane arritur nje nivel të lavderushem të punës vullnetare. Keshtu, puna vullnetare e kerkuar shpesh nga OJQ_të, krahasohet me pune vullnetare të cilen njerëzit ishin te detyruar ta kryenin gjate regjimit. Per kete arsye 36% e njerëzve nuk kane me deshire te punojne vullnetarisht ne nje OJQ.

Persa u perket financimeve, ne pergjithesi OJQ-të e grave mbijetojne nepermjet projekteve te financuara nga donatoret, vendas dhe te huaj. Kontributet financiare nga anëtarët jane pothuajse te paperfillshme, si pasoje e varferise ekonomike. Fakti qe nuk ka nje legjislacion, i cili lejon nje OJQ te shese sherbimet e saj per te mbuluar koston, shton varesine nga donatoret. Ka bile disa raste te tjera, kur projektet e OJQ-ve te grave udhehiqen nga donatoret.

Antarsia e OJQ, ne pergjithesi është më shumë cilësore sesa sasiore, por emigracioni i madh i grave te arsimuara po ndikon negativisht ne lëvizjen e grave, perderisa ai prek cilesite e antareve.

Tendenca e përgjithshme e grave për t'u organizuar në shoqata të pavarura (jo të lidhura me partite politike në pushtet) u zhvillua që në vitin 1990 si një përgjigje e situatës së vështirë gjatë periudhës së tranzicionit dhe gjithashtu si një nevojë për të tërhequr vëmendjen e qeverisë kundrejt grupeve të pambrojtura dhe vështirësive të tyre për t'u përtshatur në një shoqëri që po ndryshonte me shpejtësi.

Në periudhën e parë pas rënies së komunizmit, përfshirja e grave në OJQ ishte spontane dhe ato nuk kishin asnjë strategji afatmesme apo afatgjatë. Në vitet e fundit u vu re një pjekuri e përgjithshme e organizatave të grave (1995-2000). Organizatatat e grave filluan të ofrojnë shërbime sociale për shumicën e grupeve të pambrojtura (fëmijët, gratë kryefamiljare, të moshuarit dhe personat e sëmurë). Duhet theksuar që shumica e OJQ-ve të grave janë me qendër në Tiranë ndërkohë që në prefektura te tjera niveli i organizatave është i ulët. Shumë prej organizatave të grave kanë një qëllim të përgjithshëm dhe jo specifik si dhe kanë probleme në vlerësimin analitik dhe në mbledhjen e fondeve.

PJESA E II

INFORMACIONI SPECIFIK PËR SECILËN DISPOZITË TË KONVENTËS

KAPITULLI I

KORNIZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË GRAVE (Nenet 1-3)

I.1. BARAZIA NDËRMJET BURRAVE DHE GRAVE-KORNIZA LIGJORE

Neni 1

Në këtë Konventë shprehja "diskriminimi i gruas" nënkupton çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë gjinie, që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në çdo fushë tjetër.

1. Përcaktimi i Diskriminimit sipas legjislacionit Shqiptar

Parimi i barazisë së burrave dhe grave është pjesë e sistemit ligjor shqiptar në të gjithë Kushtetutën dhe ligjet kombëtare.

Kushtetuta: Neni 18 i Kushtetutës së Shqipërisë shpall që "të gjithë janë të barabartë përpara ligjit" dhe që "Asnjë nuk do të jetë i diskriminuar padrejtësisht për shkaqe të tilla, si seksi, raca, besimi dhe përkatësia etnike".

Kushtetuta parashikon garantimin e të drejtës qytetare, politike, ekonomike dhe kulturore për të gjithë (nenet 15-58), por nuk përcakton termin *diskriminim*.

Ndërsa në lidhje me dokumentat ndërkombëtare Kushtetuta në Nenin 122 pika 2 shprehet qartë: "Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të"

Kodi i Punës: Neni 9(1) i Kodit të Punës (Ligji Nr.7961, datë 12.07.1995), ndalon të gjitha format e diskriminimit në punë dhe profesion, ndërsa paragrafi (2) i këtij neni parashikon përkufizimin e diskriminimit:

"Diskriminimi është dallimi, përjashtimi ose preferenca e bërë në bazë të racës, ngjyrës, seksit, moshës, besimit, opinionit politik, perkatesise etnike ose origjinës sociale, dëmtimit fizik ose mendor, i cili ka efektin e shfuqizimit ose dobësimit të barazisë të mundësive ose trajtimit.

Shkelja e parimit të mosdiskriminimit në punë sanksionohet me një gjobë deri në 50 herë të pages minimale të përcaktuar me ligj (neni 202 i Kodit të Punës).

Kodi i Punës në fuqi, është formuluar duke u bazuar në standartet ndërkombëtare të punës, ratifikuar nga shteti gjatë viteve dhe neni 9 i Kodit të Punës pasqyron dispozitat e Konventës Nr.111 të ILO.

Kodi Civil: neni 1 i Kodit Civil të Shqipërisë parashikon “mundësi të plota dhe të barabarta për cdo person”; dispozitat e mëpasshme u referohen fjalëve “të gjithë”, “asnjë njeri” dhe “person” pa dallim seksi.

Kodi Penal: Neni 253 i Kodit Penal parashikon që:

Shkelja e barazisë së shtetasve

Kryerja për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

Shqipëria është anëtare e OKB-së që nga 14 dhjetori 1955 dhe ka ratifikuar pothuaj të gjitha konventat kryesore të kësaj organizate lidhur me të drejtat e njeriut. Përsa i përket diskriminimit Shqipëria është palë në konventat si më poshtë:

- Konventa kundër diskriminimit në arsim (UNESCO), 1960 (1963)
- Konventa ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial, 1969 (aderuar më 1994).

Konventa të ILO-s lidhur me diskriminimin të ratifikuara nga Shqipëria:

- Konventa Nr.111 mbi Diskriminimin në Punësim 1958, ratifikuar më 27.02.1997.

Gjithashtu Shqipëria është anëtare e Këshillit të Europës që nga 13 Korriku 1995. Ajo është palë në një numër të madh dokumentash të rëndësishme të adoptuara nga Këshilli i Europës, ndërmjet të cilave në Konventen Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe në protokollin 1,2,3,4,5,6,7,8, dhe 11. Duke qënë se Shqipëria është palë në Protokollin 11, shtetasve të saj u lind e drejta që t’i drejtohen Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut pasi të kenë shfrytëzuar të gjitha shkallët e procesit gjyqësor kombëtar.

Neni 2

Shtetet palë dënojnë diskriminimin e gruas në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë një politikë me pikësynim eliminimin e diskriminimit marrin përsipër

- a) *Të përfshijnë në Kushtetutat e tyre kombëtare ose në cdo dispozitë tjetër ligjore të përshtatshme, parimin e barazisë së burrit dhe të gruas, nëse kjo nuk është bërë deri tani, dhe të sigurojnë përmes legjislacionit apo me mjete të tjera të përshtatshme zbatimin praktik të këtij parimi;*
- b) *Të miratojnë masa legjislative dhe masa të tjera të përshtatshme, të shoqëruara edhe me sanksione po të jetë nevoja, për ndalimin e cdo diskriminimi të gruas;*
- c) *Të vendosin mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të gruas mbi bazën e barazisë me burrin dhe të garantojnë, përmes gjykatave kombëtare kompetente dhe institucioneve të tjera publike, mbrojtjen efektive të gruas nga cdo veprim diskriminues;*
- ç) *Të mos ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj gruas dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike t' i përmbahen këtij detyrimi;*
- d) *Të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas, që ushtron një person, organizatë ose ndërmarrje e çfarëdo shme;*
- e) *Të marrin të gjitha masat e përshtatshme, përfshirë dispozita ligjore, për të ndryshuar ose anuluar çdo ligj, dispozitë rregulluese, zakon apo praktikë, që përbën diskriminim ndaj gruas;*
- ë) *Të anulojë gjithë dispozitat penale që përmbajnë diskriminim ndaj gruas.*

1.2. Detyrimi për eliminimin e diskriminimit në Shqipëri

Që nga ratifikimi i Konventës, Shqipëria nuk ka bere një rishikim të legjislacionit nga këndvështrimi i përkatësisë gjinore, në përputhje me parimet e Konventës. Pavarësisht nga kjo mungesë, legjislacioni shqiptar është krejt i ri dhe në përshtatje me të drejtat njerëzore themelore sipas instrumentave ndërkombetare.

Dispozita e vetme ligjore, që parashikonte hapur një trajtim të ndryshëm për burrat dhe gratë në Kodin e Familjes lidhur me minimumin e moshës për martesë; gratë mund të martohen në moshën 16 vjeç, ndërsa burrat mund të martohen në moshën 18 vjeç (neni 14 i Kodit të Familjes, Ligji Nr. 6599, datë 29.06.1982), është duke u rishikuar në Projekt Kodin e Ri të Familjes.

1.3. Ekzistenca e praktikave diskriminuese kundër grave

Pavarësisht nga një legjislacion modern dhe jodiskriminues në lidhje me gratë, zbatimi dhe aplikimi i të drejtave të barabarta, ka nevojë për përmirësim.

Zgjedhja e lirë e vendbanimit: Pavarësisht nga dispozitat e Kodit Civil, zakonisht është burri si kryefamiljar që vendos se ku do të jetojë familja.

Trashëgimia: zakonisht, pavarësisht nga fakti që Kodi Civil parashikon barazi ndërmjet burrave dhe grave në lidhje me problemin e trashëgimisë së tokës, në shumicën e rasteve është burri ai që trashëgon token e familjes, pasi gruaja shkon në shtëpinë e burrit.

Pronësia: zakonisht toka është e regjistruar në emrin kryetarit të familjes (burrit), duke i mohuar kështu gruas të drejtën e pronës së përbashkët pas martesës, (ju lutem referojuni neneve përkatës për një analizë të detajuar të situatës *de juro* dhe *de facto*). E njëjta gjë zbatohet për regjistrimin e kompanive, pavarësisht se kontributi financiar i gruas mund të jetë i barabartë ose më i madh se i burrit, shoqëria private është e regjistruar në emër të burrit.

Neni 3

Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme, në të gjitha fushat, sidomos ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, përfshirë dispozitat legjislative ,për të siguruar zhvillimin e plotë dhe përparimin e grave me qëllim që t'u garantojnë atyre ushtrimin dhe gëzimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore mbi bazën e barazisë me burrat.

Zhvillimi i gruas në Shqipëri

Të ndërgjegjshme për ekzistencën e një boshllëku të dukshëm midis dispozitave ligjore që ndalojnë diskriminimin gjinor dhe ushtrimin të plotë të të drejtave të grave, Qeveria ka marrë një sërë masash për të zhvilluar të drejtat e gruas në vendin tonë.

1. Mekanizmat Kombëtare për zhvillimin e gruas

Mekanizmi kombëtar për mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të grave ka pësuar ndryshime të shumta që me krijimin e tij në vitin 1992. Nga 1992 deri 1994 zhvillimi i gruas ishte kompetencë e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe të Përkrahjes Sociale. Në vitin 1996 u krijua Sekretariati i Shtetit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Gruas, i cili u transformua në vitin 1997 në Drejtorinë Gruaja dhe Familja në Ministrinë e Punës, Cështjeve Sociale dhe Gruas. Në Korrik të vitit 1998 Këshilli i Ministrave e ngriti këtë Drejtori në varësi të

Këshillit të Ministrave duke krijuar Komitetin “Gruaja dhe Familja”; Kryetarja e Komitetit raporton direkt tek Zëvendëskryeministri dhe buxheti i Komitetit është pjesë e buxhetit të Këshillit të Ministrave.

Detyrat e Komitetit Gruaja dhe Familja jepen në VKM nr. 415 datë 01.07.1998

- Zbatimi i politikave qeveritare për gruan dhe familjen;
- Koordinimi i programeve për nxitjen e barazisë midis burrit dhe gruas në nivel qendror dhe lokal;
- Zbatimi dhe vlerësimi i programeve qeveritare për gruan dhe familjen ;
- Propozimi i ligjeve ose amendamenteve të reja ndaj legjislacionit ekzistues për të drejtat e gruas dhe familjes në përputhje me standartet ndërkombëtare;
- Mbështetja dhe koordinimi me veprimtaritë e OJQ-ve në fushën e të drejtave të gruas dhe familjes.

Komiteti Gruaja dhe Familja vepron nëpërmjet një rrjeti të pikave të kontaktit emëruar në secilën ministri, (deri tani 15) dhe prefektura, (deri tani 12).

2. Shoqatat dhe organizatat joqeveritare

Shoqatat dhe OJQ, aktivitetet e të cilave janë mbështetur nga shteti, punojnë paralelisht me administratën publike për zhvillimin e gruas.

Ekzistojnë grupe të shoqatave të grave të cilat janë aktive në fusha të ndryshme. Më poshtë po paraqesim një listë si vijon:

Zhvillimi ekonomik

Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare

Në Dobi të Gruas Shqiptare

Organizata e Grave biznesmene - Vlora

Grate ne Organizata Biznesi - Korce

Organizata e Grave Profesionale dhe te Biznesit.

OJQ ne vende rurale

Ligji, biznesi dhe gruaja rurale

Gruaja produktive ne tranzicion

Mbrojtja e të drejtave të grave

Linja-Qendra e Këshillimit për Gratë dhe Vajzat

Qendra Avokatore e Grave

Shoqata e Grave Juriste

Grupi Ligjor i Grave

Vatra e Gruas Vlonjate

Shëndeti i gruas

Shoqata Shqiptare e Planifikimit Familjar.

Shoqata për Shëndetin e Gruas në Përmet, Tiranë, Vlorë

Zhvillimi social-kulturor
Përkrahja dhe Trainimi
Qendra e Gruas
Lindart
Grate ne Zhvillim

Aktualisht janë krijuar dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre dhe tre grupime te medha te OJQ-ve te grave:

1. Këshilli Kombëtar i Gruas
2. Rrjeti i Grave “Millenium”
3. Unioni GTF
4. Rrjeti i OJQ-ve Kundër Dhunës ndaj Gruas.

Pavarësisht se dispozitat ligjore garantojnë të drejtat njerëzore të gruas, ato akoma përballen me pengesa serioze në aktivitetin e tyre nga ku, në veçanti në vendimmarrje, në mundësitë për punësim dhe kujdes shëndetësor.

Neni 4

1.Kur shtetet Palë marrin masa të përkohshme, të veçanta që synojnë përshpejtimin de facto të vendosjes së barazisë midis burrit dhe gruas, kjo nuk duhet të konsiderohet si diskriminim sipas përkufizimit të kësaj Konvente, por në asnjë mënyrë nuk duhet të ketë për pasojë ruajtjen e normave të pabarabarta apo të veçuara; këto masa duhen ndërprerë sapo të jenë arritur objektivat e barazisë së mundësive dhe trajtimit.

2.Marrja e masave të veçanta nga Shtetet Palë, përfshirë ato të parashikuara në këtë Konventë, që synojnë mbrojtjen amësisë, nuk duhet konsideruar veprim diskriminues.

VEPRIMET POZITIVE PËR TË PËRSHPEJTUAR BARAZINË

Aktualisht Shqipëria nuk ka një politikë zyrtare që synon në përshpejtimin de facto të barazisë ose për të ndërmarrë përkohësisht masa të veçanta (sistemi i kuotimit ose veprime pozitive) në nivel kombëtar. Komiteti Gruaja dhe Familja po ben te gjitha përpjekjet për ndërmarrjen e këtyre masave të veçanta dhe për arritjen e mbeshtetjes nga ana e Parlamentit shqiptar per t'i diskutuar e miratuar ato.

E rëndësishme është të përmendet që Kodi i Ri Elektorale (Ligji Nr.8609, datë 08.05.2000) nuk parashikon sistemin e kuotimit. Pavarësisht nga kjo mungesë, partitë politike parashikuan në listat e tyre elektorale për zgjedhjet lokale në Tetor 2000 një kuotë minimale të kandidateve gra dhe arritjet qene me te mira se ne zgjedhjet e shkuara.Nuk po ndodh e njejta me zgjedhjet e pergjitheshme parlamentare.

Neni 5

Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme me synimin që:

- a) të ndryshojë skemat dhe modelet e sjelljes shoqërore dhe kulturore të burrit dhe gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikat zakonore, ose të çdo lloji tjetër, që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të epërsisë të njërit apo tjetrit seks, apo në rolin stereotip të burrit dhe gruas;
- b) të sigurojnë që edukimi i familjes të përfshijë kuptimin e duhur të amësisë si një funksion shoqëror dhe njohjes e përgjegjësisë së përbashkët të burrit dhe të gruas në edukimin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre, duke bërë të qartë se interesi i fëmijëve është kushti parësor në të gjitha rastet.

STEREOTIPET DHE DHUNA

1.1. ROLET E SEKSIT DHE STEREOTIPET

1. Zakonet kulturore dhe tradicionale që pengojnë përparimin e gruas në shoqëri.

Pavaresisht me 45 vitet e regjimit komunist ku barazia gjinore ishte e imponuar në mënyrë formale nga sipër, roli i gruas në Shqipëri gjithmonë ka qënë inferior në lidhje me burrat. Pas vendosjes së sistemit demokratik, rolet tradicionale seksuale, që nuk ishin eliminuar kurrë, u rishfaqën edhe si rezultat i kushteve të vështira ekonomike të vendit. Si rezultat i politikave të përshtatjes strukturore, vendet e punës i humbën më shumë gratë se burrat dhe në këtë mënyrë ato u bënë të varura nga burrat ose pranuan përkrahjen e familjes për të mbijetuar.

Shume shërbime sociale të vlefshme gjatë regjimit të kaluar për nënat punonjëse u mbyllën për shkak të mungesës së financimit shtetëror të tyre. Gjithmonë e më tepër gratë qëndrojnë në shtëpi për të kryer rolin riprodhues si nënë dhe kujdestare pjesërisht për arsye se janë të detyruara nga situata e varfër ekonomike e vendit.

Pas viteve 1990 gratë përfaqësohen në jëtën politike në një nivel më të ulët (në legjislaturën e vitit 1997-2001 vetëm 7% e vendeve në Kuvendin e Shqipërisë janë fituar nga grate në krahasim me 30% në vitet '70).

Përveç kësaj, kodi i vjetër tradicional shekullor i sjelljes, *Kanuni* është ringjallur, veçanërisht në Veri të vendit. *Kanuni* është term i përbashkët për ligjet tradicionale i krijuar në vitet 1400 nga Lekë Dukagjini.

Besimet fetare nuk luajne ndonje rol ne stereotipin gjinor ne Shqiperi. Veprimtaria e organizuar fetare e tre besimeve kryesore (Mysliman, Kristian Ortodoks, dhe Katolik) nuk është shume intensive.

2. Rolet e burrit dhe gruas në familje dhe në shoqëri

Si ne familje ashtu dhe ne shoqeri roli i burrit konsiderohet me i rendesishmi. Ai është shtylla e familjes, ndërsa gruaja shihet ne kendveshtrimin e rolit riprodhues, si bashkëshorte

dhe nënë. Ndërsa në kryeqytet, Tiranë, dallimet midis sekseve nuk janë kaq të mprehta, në qytetet më të vogla dhe zonat rurale, kjo gjë është shumë e dukshme. Gratë kujdesen për punët e shtëpisë, të bujqesise, për femijet, të moshuarit, ndërsa burrat merren me biznes, shesin prodhimet bujqësore, menaxhojnë financën e shtëpisë. Në shoqëri, burrat zoterojnë vendet e punës që janë me shume të paguara, pozicione vendim-marrëse (pavaresisht nga fakti që shpesh grate janë me të arsimuara), ata marrin pjesë aktive në jetën politike dhe kulturore të vendit dhe drejtojnë shumicën e bizneseve private dhe publike.

3. Stereotipi në librat shkollorë dhe media

Ndarja tradicionale e roleve është pasqyruar në mënyrë të vazhdueshme në media ku jo rrallë evidentohen ndryshimet në sjelljen seksuale të grave, (si prostitucioni apo tradhëtia bashkëshortore). Ndërkohë që konsiderohet normale për një burrë të martuar të ketë një të dashur (si një tregues i fuqisë seksuale), gratë janë të detyruara, të jenë besnike ndaj bashkëshortit.

4. Kryefamiljari sipas ligjit dhe zakonit.

Sipas nenit 224 të Kodit Civil, familja fshatare përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj. Në realitet si në zonat urbane dhe ato rurale, kryefamiljari është kryesisht burri (bashkëshorti). Vetëm kur burri nuk është prezent (për shkak të braktisjes, divorcit/ndarjes ose emigrimit), gruaja ze vendin e tij, por vetëm për sa kohë që nuk ka anetare të tjerë meshkuj që ta zëvendësojnë atë (vëhëri, djali i madh etj.).

5. Puna e grave dhe burrave, përgjegjësitë familjare

Sipas statistikave të punësimit dhe arsimit të dhjetë viteve të fundit, kufizimi i profesioneve të gruas, është përherë e më i dukshëm. Për shembull nga statistikave të marra nga INSTAT në lidhje me pagën mesatare, ekziston një diferencë në pagat e burrave dhe grave jo vetëm në sektorin privat, por edhe në atë publik, duke treguar që në postet e larta dhe me shume të paguara punësohen me shume burra sesa gra. (Tabela 4)

Kolapsi i shërbimeve sociale gjatë rikonstruktimit të ekonomisë shqiptare, i detyroi grate që të rrisin rolin e tyre riprodhues në familje dhe vecanerisht për kujdesin e fëmijëve

Sot numri i fëmijëve në arsimin parashkollor ka rënë për shkak të mungesës së infrastrukturës dhe mësuesve me eksperiencë, por gjithashtu meqenëse grate janë të papuna, ato kujdesen për femijet në shtëpi. Kur gruaja punon, grate e tjera të familjes (gjyshja, tezet/hallat ose vajzat e medha), marrin përsipër këtë përgjegjësi. Tradicionalisht, rritja e fëmijës është përgjegjësi e gruas, ndërsa babai është një figurë e rastesishme në familje. Ky zakon pasqyrohet në rritjen e fëmijëve; ku vajzat janë ato që kujdesen për punët e shtëpisë dhe për vellezerit dhe motrat me të vegjël, për të ndihmuar nënën e tyre në shtëpi, ndërsa djemtë kryejnë punët jashtë shtëpisë ose nxiten të dalin dhe të argetohen.

II.2. DHUNA NE FAMILJE

Dhuna ne familje në Shqipëri konsiderohet akoma si nje problem privat qe duhet diskutuar vetem brenda saj. Keshtu qe, pavaresisht se ne Kodin Penal ka nje sere dispozitash të cilat dënojnë dhunen (qofte ajo brenda apo jashte familjes), numri i grave që janë objekt i dhunes eshte relativisht i larte por keto raste nuk denoncohen prane organeve te rendit, autoriteteve shendetesore dhe sherbimeve specifike te krijuara per kete problem.

Kodi Penal Shqiptar nuk ben dallime ne formulim midis akteve te dhunes te kryera nga nje i huaj apo nga nje anetar i familjes. Keshtu, kercenimet serioze per vdekje ose demtime te renda personale, denohen me gjobe ose deri ne nje vit heqje lirie (neni 84 i Kodit Penal), ndersa trajtimet jonjerezore qe cojne ne gjymtime fizike te perhershme denohen nga 10 - 20 vjet heqje lirie (neni 86 dhe 87 i Kodit Penal). Demtimet serioze te qellimshme denohen nga 3-10 vjet heqje lirie (neni 88) ndersa demtimet e qellimshme joserioze denohen me gjobe ose deri ne 2 vjet heqje lirie.

Ngacmimet seksuale perfshihen ne Kodin Penal, nenet 100-108 dhe janë objekt i sanksioneve penale duke patur parasysh shkallen e krimit dhe moshen e viktimes. Marredheniet seksuale me nje minorene e cila nuk ka mbushur 14 vjec ose nuk ka arritur pjekurine seksuale, dhe qe kryhen me deshiren e te dy paleve, denohen 5-15 vjet heqje lirie per te rriturin; nese marredhenia kryhet me dhune atehere denimi shkon nga 10-20 vjet heqje lirie. Nëqoftëse marredhenia sjell si pasoje vdekjen ose vetevrasjen e viktimes, denimi eshte jo me pak se 20 vjet heqje lirie.

Marredheniet seksuale me dhune me nje vajze minorene (14-18 vjec) denohen 5-10 vjet heqje lirie. Ne rastet kur rrethanat rendohen, denimi eshte mbi 10 vjet heqje lirie. Marredheniet seksuale me dhune denohen 3-10 vjet heqje lirie (dhe deri ne 20 vjet heqje lirie ne rast vdekje).Neni 106 ka te beje me incestin, i cili denohet maksimumi deri ne 5 vjet heqje lirie.

Dhuna familjare nuk denoncohet ne pergjithesi per disa arsye:

- Koncepti i grave se shkaku i abuzimit ndaj tyre jane gabimet qe ato mund te kene bere.
- Mosbesimi i grave në forcat e policisë dhe sistemin ligjor.
- Mungesa e ndergjegjesimit publik per faktin që dhuna familjare paraqet një krim dhe si i tillë ajo duhet të jetë e dënueshme.
- Mungesa e strukturave te vecanta policore dhe shendetesore qe merren me dhunën familjare.
- Mungesa e ndergjegjesimit te sistemit ligjor per permasat e fenomenit dhe se si duhet te trajtohet ai.
- Mungesa e sherbimeve ne te gjithë vendin per rastet e dhunes ne familje.

Shteti deri tani nuk siguron sherbime asistence per rastet e dhunes ne familja, ndersa shoqatat e grave kane krijuar linja telefonike te ndihmes dhe sherbime konsultimi (ne Tirane, Durrës, Elbasan, Berat, Shkoder dhe Pogradec). Gjithashtu ne Tirane eshte ngritur nga nje OJQ edhe nje strehez (shtepi) ku strehohen grate e dhunuara.

Ne lidhje me fenomenin e dhunes ne familje, nuk ekzistojne statistika zyrtare, kjo edhe si rezultat i numrit te ulet te denoncimeve zyrtare. Nderkohe qe vezhgimet e kryera nga OJQ-te tregojne se 64% e te intervistuarave kane qene objekt i dhunes, fizike ose psikologjike, ne shtepi ose jashte saj. Rreth 34% e tyre pranojne qe edhe ne familjet ku ato jane rritur eshte ushtruar dhune (fizike ose psikologjike). Fakti qe dhuna ne familja eshte nje problem shume i madh ne Shqiperi konfirmohet ne menyre indirekte edhe nga numri i madh i grave qe kane kryer krime. Gratë jane me pak te perfshira ne krim sesa burrat, por nga 28 gra te cilat ndodheshin ne te vetmin burg per femra ne Shqiperi ne vitin 1999, 23 prej tyre ishin te denuara per vrasje dhe viktima ne pergjithesi ishte partneri ose ish-partneri, ose nje anetar mashkull i familjes. (tab.5)

Komiteti Gruaja dhe Familja në bashkëpunim me Qendrën Avokatore për Gratë e Dhunuara po punojnë për hartimin dhe përcjelljen për miratim në Parlament të një ligji kundër dhunës ndaj gruas.

KAPITULLI III SHFRYTËZIMI I GRAVE

Neni 6

Shtetet palë marrin të gjitha masat e duhura, përfshirë legjislacionin, për të zhdukur të gjitha format e trafikut të grave dhe shfrytëzimin e prostitucionit të grave.

III.1. PROSTITUCIONI

Kodi Penal (nenet 113-115 Aktet Kriminale kundër Moralitetit dhe Dinjitetit) klasifikon si krim ushtrimin e prostitucionit (denohet me gjobë ose deri në 3 vjet heqje lirie), joshja, ndërmjetësimi ose përfitimi nga prostitucioni (dënohet me gjobë ose me 5 vjet heqje lirie), dhe cdo akt tjetër që con ose favorizon prostitucionin. Neni 114/a parashikon edhe kushtet renduese si pasojë e të cilave shfrytëzimi për prostitucion dënohet me 7-15 vjet heqje lirie:

- Kur viktima është minorene;
- kur shfrytëzimi përfshin më shumë se një person;
- kur shfrytëzimi është kryer ndaj një anëtari të familjes;
- kur perdoret detyrimi, dhuna ose mashtrimi;
- kur personi është detyruar të ushtrojë prostitucion jashtë kufinjve të Shqipërisë.
- Ose kur shfrytëzimi kryhet nga organizata kriminale.

Ne Kodin Penal te Shqiperise nuk ekziston asnje dispozite e cila lejon ndjekjen penale te klienteve te prostitutave. Gjithashtu nuk ka asnje dispozite te sakte qe ben dallimin midis prostitutave dhe personave te tjere ne rastet e ushtrimit te dhunes pasi ushtrimi i prostitucionit perdoret nga pala mbrojtese si nje rrethane lehtesuese per autorin e krimit, duke deshmuar keshtu per izolimin shoqeror te prostitutave. Pavaresisht se eshte i ndaluar, ne Shqiperi ka raste te ushtrimit te prostitucionit.

III.2. TRAFIKU I GRAVE DHE VAJZAVE

Gjate viteve te fundit, me renien e komunizmit, dhe problemet e krijuara nga tranzicioni, Shqiperia u kthye vend origjine dhe tranzit të trafikut të grave.

Grate dhe vajzat shqiptare te trafikuar per qellim prostitucioni ne Europen Perendimore: perfshirja e grave shqiptare ne prostitucion jashte vendit filloi me valet e para te refugjateve ne vitin 1990 dhe 1991. Nuk ka shifra të sakta për numrin e femrave viktime të trafikut për qëllim shfrytëzim prostitucioni.

Forcat policore te Bashkimit European kane shprehur alarmin e tyre per rritjen e aktiviteteve kriminale te kontrolluara nga bandat europiane. Shume vende europiane po perballen me nje vale me prostituta te reja shqiptare te cilat jane mashtruar nga trafikantet per te kaluar me pas kontrabande ne vendet e Europes Perendimore. Disa prej vajzave jane rrembyer, te tjerave u jane bere premtime fallso per pune apo besojne se do te “martohen” me shfrytezuesin. Varferia e madhe nga njera ane dhe nevoja e deshperuar per te ikur nga ana tjetere, çoi ne shfaqjen e prostitucionit te organizuar ne Shqiperi.

Kodi Penal Shqiptar ka nje sere dispozitash kunder trafikut dhe aktiviteteve kriminale, ndersa ka mangesi ne zbulimin, gjetjen e fakteve dhe hetimin rreth ketij fenomeni. Disa nga keto dispozita jane:

- Neni 114 dhe 114(a): Shfrytëzimi i prostitucionit dhe rrethanat renduese;
- Neni 115: Krijimi kushteve per prostitucion;
- Neni 28: Bandat e armatosura dhe organizatat kriminale;
- Neni 333 dhe 334: Krijimi i bandes se armatosur dhe krimet e kryera nga bandat e armatosura ose organizatat kriminale;
- Neni 109 dhe 110: Rrembimi dhe privimi i paligjshem i lirise;
- Neni 86–90: Tortura, plagosjet e qellimshme serioze dhe joserioze, përdhunimi.
- Neni 100-104: Përdhunimi seksual i minoreneve, të rriturve dhe personave të paaftë për të mbrojtur vetëveten.

Gjate viteve 1993-1998 nga 103 raste te zhdukjes se vajzave me te cilat është marrë Interpoli në Tiranë i mbeshtetur ne denoncimin e familjeve te tyre, vetëm 44 prej këtyre grave jane gjetur gjalle. Nga 580 persona te denoncuar ne periudhen 1991-1997 per trafik prostitucioni jane arrestuar 200 vete. Sipas burimeve policore grupet kriminale te perfshira ne trafikun e grave gjenden kryesisht ne Tiranë, Shkodër, Berat, Vlorë dhe Fier. Megjithatë, në vitet e fundit, duket që krimi i organizuar është perqendruar më shumë në rekrutimin e grave të huaja, te cilat kalojne tranzit nëpër Shqipëri për në Europën Perëndimore, sesa ne trafikun e grave shqiptare. Kjo erdhi edhe si rrjedhoje e fushatave ndergjegjesuese te ndermarra nga oganizatat e shoqerise civile ne media, ne shkolla dhe universitete, duke paralajmeruar vajzat e reja mbi rrezikun e emigrimit ilegal dhe nepermjet lajmeve te televizioneve te huaja per grate shqiptare te perfshira ne prostitucion ne Itali dhe Greqi.

Grate dhe vajzat joshqiptare te trafikuar nëpërmjet Shqipërisë: Kohët e fundit eshte kthyer ne shqetesim per autoritetet shtetërore kontrabanda e grave dhe vajzave me kombesi te huaj (kryesisht nga Europa Qendrore dhe Lindore) nepermjet Shqiperise.

Gratë e reja nga Moldavia, Rumania, Ukraina, Rusia, Bullgaria kane hyre në Shqipëri nëpërmjet Rumanisë, Serbisë dhe nga Mali i Zi ose Maqedonia. Shkodra (ne veriperëndim të Shqipërisë) është zakonisht qyteti i parë ku trafikantët e qënieve njerëzore me qëllim shfrytëzim prostitucioni lidhen me të tjerë për të realizuar kalimin e grave e vajzave në vendet e Europes Perendimore nepermjet detit.

Në disa raste gratë janë arrestuar nga policia për kalim ilegal të kufirit shtetëror (neni 297 i Kodit Penal Shqiptar) dhe mbahen ne arrest derisa ato te kthehen në vendet e tyre te lindjes ose derisa te paguhet garancia (shume shpesh kjo behet nga vetë shfrytëzuesi). Statistikat tregojne qe prej muajit Korrik 1999 jane riatdhesuar 126 gra (19 moldave, 19 rumune, 5 bullgare, 4 ruse dhe 1 ukrainase) te ardhura ne Shqiperi per qellime trafiku drejt Perendimit.

Vështirësitë në kufizimin e këtij trafiku nuk janë aq shumë në fazen e ndjekjes penale, ku mund te kerkohen nje sere nenesh te Kodit Penal, por në procesin zbulues. Pikat e hyrjes per ne vendin tone ashtu si dhe rruget e transportit ndryshojne vazhdimisht.

Përveç të gjitha dispozitave të përmendura me lart, në rastet e trafikimit të grave të huaja, neni 297 dhe 298 (kalimi i kufirit shtetëror në mënyrë ilegale dhe ndihma e dhene per te kaluar) dhe neni 186 (fallsifikimi i dokumentave) perdoren ne fazen e ndjekjes penale.

Me hapjen kohet e fundit ne Tirane, te nje strehëze per grate e trafikuar, policia tani ka nje alternative vec mbajtjes se grave ne qeli. Nëse është e qartë që gruaja është trafikuar dhe dëshiron të kthehet në shtëpi, ajo do te strehohet ne këtë strehëz per asistencë, rikthim dhe ristabilizim. Duket qarte qe ka kerkesë më të madhe për këtë lloj shërbimi sesa ofertat ekzistuse, keshtu qe shume gra mbahen ende ne qelite e policise. Nepunesit e te drejtave te njeriut te OSBE monitorojne qelite e policise; gra dhe vajza jane identifikuar dhe referuar disa here nëpërmjet ketij kanali.

Agjensitë e specializuara ndërkombëtare kanë ndihmuar në katër drejtime kryesore:

- Parandalimi (UNICEF)
- Mbarvajtja Sociale dhe Sherbimet (IOM dhe ICMC)
- Rishikimi Legal (OSBE)
- Mbeshtetja Ligjore (MAPE)

Puna e këtyre nëngrupeve do të përbeje bazën per rekomandime ne qeveri dhe hartimin e një Plani Kombetar te Veprimit.

Aktualisht nuk ka asnje OJQ, te perfshire ne nengrupet, me perjashtim te Parandalimit. Perderisa ky grup pune synon te behet nje mekanizem efektiv koordinimi, ai synon te perfshije perfaqësues nga te tre sektoret, qeveria, agjensite nderkombetare dhe OJQ-të, ne nje te ardhme te afert.

III.3. PORNOGRAFIA DHE NGACMIMI SEKSUAL

2. Pornografia

Kodi Penal permban nje dispozite (neni 117) qe synon kufizimin e prodhimin, shperndarjen, reklamimin, importimin dhe publikimin e materialeve pornografike. Të tilla krime denohen me gjobë ose deri ne dy vjet heqje lirie. Në praktikë, materialet pornografike gjenden lehtesisht ne tregjet e reja te cilat kane kontroll te ulet ne lidhje me moshen e klienteve.

3. Ngacmimi seksual në vendet e punës

Punëdhënësi është i ndaluar të kryejë ndonjë veprim që u shkakton shqetësime seksuale punonjësve dhe nuk duhen lejuar të tilla veprime nga punonjësit e tjere (neni 32(2) dhe 32(3) i Kodit të Punës. Me ngacmim seksual kuptohet cdo shqetësim, i cili ne menyre te qarte demton gjendjen psikologjike te punonjesit, per shkak te seksit.

Me qellim pasjen e nje akti parandalues, sipas Kodit te Punes eshte vendosur nje denim deri ne 10 fishin e pages mujore minimale. Kodi Penal nuk e parashikon ngacmimin seksual si nje krim (ashtu si ne vendet e tjera) me qellim qe te garantoje nje efektivitet te larte te mbrojtjes sipas dispozitave te Kodit te Punes. Qe kur eshte aprovuar Kodi i Punes, nuk eshte denoncuar asnje rast i ngacmimeve, megjithese ky fenomen ne Shqiperi konsiderohet si mjaft i perhapur, vecanerisht në kompanitë private të vendit e të huaja.

KAPITULLI II JETA POLITIKE DHE PUBLIKE (Nenet 7 dhe 8)

Neni 7

Shtetet Palë marin të gjitha masat e duhura për të eleminuar diskriminimin e gruas në jetën politike dhe publike të vendit. Në mënyrë të veçantë i siguron, në kushtet e barazisë më burrat, të drejtën që ajo;

- a) Të votojë në të gjitha zgjedhjet dhe në të gjitha referendumet publike, si dhe të zgjidhet në të gjitha organizmat publikisht të zgjedhur.*
- b) Të marrë pjesë në përpunimin e politikës qeveritare dhe në zbatimin e sa; të punojë në poste publike dhe të kryejë të gjitha funksionet publike në të gjitha hallkat e qeverisjes;*
- c) Të marrë pjesë në organizatat dhe shoqatat joqeveritare që merren me jetën publike dhe politike të vendit.*

IV.1. PJESEMARRJA NE JETEN POLITIKE DHE PUBLIKE NE SHQIPERI

Pjesemarrja e grave në jetën publike dhe politike përfshin në veçanti të drejtën e tyre për të marre pjese ne te gjitha zgjedhjet dhe referendumet publike e politike, te zgjidhet ne te tere organet e zgjedhura politike, te marre pjese ne pergatitjen dhe zbatimin e politikave

qeveritare, te punoje ne institucionet politike e publike ne te gjithë nivelet, te marre pjese ne organizatat joqeveritare qe jane te perfshira ne jeten politike dhe publike te vendit. Te gjithë keto te drejta baze jane te garantuara me Kushtetute (neni 45, 46 dhe 48), por te dhenat statistikore provojne qe ne Shqiperi postet drejtuese, politike, ne qeveri dhe vendimarrjen publike jane te zena kryesisht nga burrat, pavaresisht nga fakti qe niveli arsimor i grave eshte i njejte, dhe shpesh edhe me i larte, se i burrave (Tabela 6-14).

Pjesemarrja me e larte politike e grave ne historine e Kuvendit te Shqiperise u arrit ne vitin 1974 me 33% te vendeve ne Kuvend dhe ne vitin 1989 ku 1/3 e anetareve te Kuvendit ishin gra. Ne zgjedhjet e para politike pluraliste ne Mars 1991, pjesemarrja e grave ne organet e zgjedhura u ul ne 51 kundrejt 199 burrave, ndersa ne 1997 u zgjodhen vetem 11 gra kundrejt 144 deputeteve burra. Kjo situatë eshte pothuajse e ngjashme edhe per pushtetin lokal. Per shembull ne 1996 nga 309 Kryetarë Komunash, vetem 1 ishte grua. Pati një përmirësim në zgjedhjet vendore të 1 Tetorit 2000.

Sipas nenit 3 te Kodit Elektorale (Ligji Nr.8609, date 08.05.2000), cdo qytetar shqiptar, prej moshes 18 vjec, pa dallim race, perkatesie etnike, seksi, gjuhe, bindjeje politike, besimi ose kushteve ekonomike ka te drejten te votoje dhe te zgjidhet. Disa kategori te qytetareve nuk lejohen as te kandidojne dhe as te zgjidhen si deputete pa dhene doreheqjen nga pozita aktuale (gjqytaret dhe prokuroret, ushtaraket ne detyre, anetare te policies apo Sigurimit Kombetar, perfaqesues diplomatike, ose anetare te pushtetit lokal).

Pjesemarrja e ulet e grave, pjeserisht vjen si pasoje e opinionit te tyre per politiken si nje pune e nderlikuar, por kryesisht eshte si rezultat i opinionit se grate jane te papershtatshme per ne pozitat vendimmarrese.

Ne Kodin Elektorale te miratuar se fundi nuk u arrit te futej nje klauzole ne lidhje me kuoten per grate. Si rezultat, vendimi ne lidhje me kandidatet femra eshte lene krejtesisht ne duart e partive politike (pavaresisht nga e drejta e nje individi te kandidoje si i pavarur). Ne zgjedhjet lokale te 1 Tetorit 2000, Partia Socialiste Shqiptare, e shtyre nga Forumi i Gruas Socialiste, vendosi te percaktojte si objektive nje kuote prej 30% per kandidatet femra. E njejta gje u krye edhe nga partia opozitare, Partia Demokratike, e cila gjithashtu ofroi nje kuote prej 30% per kandidatet femra. Por, pavaresisht nga premtimet e bera, per kandidaturen per Kryetarin e Bashkise se Tiranes asnjera prej tyre nuk propozoi nje grua dhe statistikate per prezencen e grave brenda partive politike akoma tregojne nje boshllek thelbësor ne lidhje me barazine gjinore. Per me teper, akoma nuk eshte krijuar nje sherbim perkrahes per te nxitur pjesemarrjen e grave ne kete fushe.

Neni 8

Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura me qëllim që gruaja, në kushtet e barazisë me burrin, dhe pa asnjë diskriminim, të ketë mundësinë të përfaqësojë qeverinë e saj në arenën ndërkombëtare dhe të marrë pjesë në punimet e organizatave ndërkombëtare.

IV.2. PËRFAQËSIMI NDËRKOMBËTAR DHE PJESEMARRJA

Sipas ligjit, çdo qytetar shqiptar ka mundësinë për të përfaqësuar qeverinë e tij/e saj, në nivelet ndërkombëtare (në shërbimet diplomatike ose si një anëtar i një organizate ndërkombëtare). Statistikat e fundit tregojnë që numri i grave që punojnë për Shërbimin e Jashtëm Shqiptar po rritet vit pas viti.

KAPITULLI IV SHTETËSIA

Neni 9

1. Shtetet Palë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit në fushën e marrjes, ndërrimit dhe mbajtjes së shtetësisë. Në mënyrë të veçantë ata garantojnë që as martesë me një të huaj, as ndërrimi i shtetësisë së burit gjatë martesës nuk e ndërrojnë automatikisht shtetësinë e gruas, po ashtu nuk e bjnë atë pa shtetësi dhe nuk detyrojnë të marrë shtetësinë e burrit.

2. Shtetet Palë i japin gruas të drejta të barabarta me ato të burrit përsa i përket shtetësisë së fëmijëve të tyre.

VI. MARRJA E SHTETËSISË

Bazat ligjore për shtetësinë shqiptare parashikohen nga Kushtetuta dhe nga Ligji për Shtetësinë Shqiptare (Ligji Nr.8389, datë 05.08.1998). Sipas nenit 19 të Kushtetutës çdo fëmijë i lindur me të paktën njerin prind (qofte nena apo babai) me kombësi shqiptare, fiton automatikisht kombësinë shqiptare. Neni 6 i Ligjit për Shtetësinë parashikon tre mënyrat e fitimit të shtetësisë shqiptare:

1. lindja 2. Natyralizmi 3. Birësimi , ndërsa neni 10 parashikon që kur një i huaj është i martuar me një shtetas/e shqiptare për jo më pak se tre vjet, atëherë ai/ajo mund të fitojë shtetësinë shqiptare nëse dëshiron. Prandaj martesë nuk është një faktor vendimtar për fitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare. Në këtë mënyrë legjislacioni vendas është në përputhje me Konventën e vitit 1954 për shtetësinë e grave të martuara, Konventë në të cilën aderohet edhe Shqipëria.

Në vendin tonë, para Luftës II Botërore, martesë konsiderohej si mënyrë e fitimit të shtetësisë. Në mënyrë të veçantë Kodi Civil i vitit 1929 sanksiononte parimin e pabarazisë së gruas dhe parashikonte se gruaja ndjek shtetësinë e burrit. Pas Çlirimit u vendos edhe në çështjen e shtetësisë parimi i barazisë së gruas me burrin. Nga viti 1954 deri më 1998 shtetësia rregullohej me Dekretin Nr. 1874 dt.07.06.1954. Më 1998 miratohet Ligji "Për shtetësinë" Nr. 8389/05.08.1998, i cili rregullon edhe disa mardhënie të reja të lindura pas 1990.

V.2. E DREJTA PËR TË BRAKTISUR SHTETËSINË

Sipas nenit 4 të Ligjit mbi Shtetësinë Shqiptare, çdo qytetar, mund të braktisë shtetësinë e tij/e saj shqiptare, duke marrë parasysh që ai/ajo, ka ose është duke marrë një tjetër shtetësi. Minorenët mund të fitojnë dhe ta braktisin shtetësinë shqiptare me aprovimin e prindërve. Megjithatë çdo ndryshim në shtetësinë e një minorenit (14-18) duhet të bëhet edhe me miratimin e tij.

KAPITULLI VI

ARSIMI

Neni 10

Shtetet Palë marrin të gjithamasat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas, me qëllim që asaj t'i sigurohen të drejta të barabarta me burrin në fushën e arsimit dhe, në mënyrë të veçantë, t'i sigurohen, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas:

- a) *Të njëjtat kushte të kualifikimit profesional, të ndjekjes së shkollave dhe të marrjes së diplomave në institucionet shkollore të të gjitha kategorive, si në fshat ashtu edhe në qytet. Kjo barazi duhet siguar në arsimin parashkollor, të përgjithshëm, teknik profesional dhe teknik të lartë, si dhe në çdo institucion tjetër të përgatitjes profesionale;*
- b) *Të drejtën për të ndjekur të njëjtat programe, për t'iu nënshtruar të njëjtave provime, përtë patur një personel mësimor me të njëjtin kualifikim, mjedise shkollore dhe pajisje të një cilësie të njëjtë;*
- c) *Eliminimin e çdo koncepti stereotip mbi rolin e burrit dhe të gruas në të gjitha nivelet dhe në të gjitha format e arsimit, duke nxitur arsimin mikst dhe tipe të tjera arsimimi që ndihmojnë për realizimin e këtij objektivit, duke rishikuar sidomos librat dhe programet shkollore dhe duke përshtatur metodat pedagogjike;*
- ç) *Të njëjtat mundësi në përfitim të bursave dhe të ndihmave të tjera për studime;*
- d) *Të njëjtat mundësi për të ndjekur programet e shkollimit të pandërprerë, përfshirë programet e luftës kundër analfabetizimit për të rritur, në mënyrë të veçantë programet që synojnë ngushtimin e dallimit arsimor që ekziston midis burrit dhe gruas;*
- e) *Uljen e përqindjes së braktisjes së shkollave nga vajzat dhe organizimin e programeve për të reja dhe ato vajza që janë larguar nga shkollat para kohe;*
- ë) *Të njëjtat mundësi për të marrë pjesë në sportet dhe edukimin fizik*

f) të drejtën për të marrë informacione specifike të karakterit edukativ që synojnë mbarvajtjen e shëndetit dhe mirëqënien e familjeve, përfshirë informacionin dhe këshillimin për planifikim familjar.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë çdo njeri ka të drejtën për t'u arsimuar. Arsimi tetëvjeçar dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas. (neni 57 i Kushtetutës).

Arsimi është një sektor ku kontributi i gruas është shumë i rëndësishëm. Në të gjithë vendin janë 58.856 arsimtare prej të cilëve 36.939 (ose 63,2%) janë femra, ndërsa numri i përgjithshëm i studentëve në vitin shkollor 1998-1999 ishte 694.474. Aktualisht sistemi arsimor përfshin 1852 institucione parashkollore, 1798 shkolla tetëvjeçare të detyrueshme, 375 shkolla të mesme dhe 11 universitete dhe shkolla të larta.

Në krahasim me periudhën para tranzicionit ka rënë interesimi për arsimimin nga brezi i ri. Gjatë viteve të para të tranzicionit arsimi u perball me shkatërrimin dhe amortizimin e shume objekteve shkollore; shumë mësues me përvojë braktisën punën e tyre dhe shumë nxenes braktisën shkollat e mesme. Një element shqetësues i periudhës së tranzicionit është largimi i mësuesve të kualifikuar dhe zëvendësimi i tyre me një staf të pakualifikuar; si dhe rritja e numrit të nxenesve që braktisin shkollën.

Gjatë vitit shkollor 1992-1993, 7.8% e mësuesve të ciklit të ulët në shkollat tetëvjeçare kishin një nivel të pamjaftueshëm të arsimit, ndërkohë që sot kjo shifer ka arritur në 10%. Në ciklin e lartë të shkollave tetëvjeçare numri i mësuesve me nivel të pamjaftueshëm arsimimi është ngritur nga 24.2%, në 1992-1993 në 26%, ndërsa në shkollat e mesme kjo norme është 6-8%.

VI.1. Arsimi i detyrueshëm

Arsimi tetëvjeçar në Shqipëri përfshin moshat nga 6-14 vjeç dhe është i ndarë në dy cikle: cikli i ulët (nga klasa e parë deri tek klasa e katert) i cili është i ngjashëm me shkollën elementare të vendeve perëndimore dhe cikli i lartë (nga klasa e pestë deri në tetën). Në arsimin tetëvjeçar numërohen 553 411 nxënës, prej të cilëve 48% janë vajza dhe 52% janë djem. Për dekada të tëra Shqipëria i kushtoi një rëndësi të madhe zhvillimit të arsimit tetëvjeçar, por shpërfillja, mirëmbajtja jo në nivelin e duhur dhe mungesa e fondeve shkaktoi një keqësim të pakthyeshëm të godinave të shkollave duke bërë të pamundur një proces cilësor të mesimdhënies. Një vlerësim i përgjithshëm tregon që prej 1 815 shkollave të arsimit tetëvjeçar që operojnë tani në Shqipëri, vetëm 65% janë në kushte të pranueshme për të realizuar mesimin.

Në vitet e fundit, një aspekt i rëndësishëm i arsimit të detyrueshëm ka qenë dhe zhvillimi i institucioneve private. Kështu, vetëm në vitin 1997, janë hapur tre shkolla të reja jopublike,

duke e rritur numrin e përgjithshëm të institucioneve arsimore jopublike në 36 për 5-6 vitet e fundit. Prej këtyre institucioneve, 22 janë jo-fetare dhe 14 janë fetare (medrese). Rreth 3 800 nxënës ndoqën këto institucione në vitin 1998 (duke përfshire edhe ndjekjen e arsimit parashkollor).

Statistikat tregojnë që raporti djem/vajza në këto institucione është pothuajse i barabartë. Kështu, për shembull, nga 522 nxënës të regjistruar në kolegjin "M.Arif", 52% janë vajza dhe 48% janë djem; në Medresenë e Shkodrës në 258 nxënësve në të ciklin e lartë të shkollës tetevjecare dhe shkollën e mesme, 53% janë vajza. Ndryshe paraqiten statistikat gjinore në 13 shkolla të tjera fetare (myslimane) ku është i ndaluar regjistrimi i vajzave.

VI.2. ARSIMI I MESEM

Arsimi i mesëm përfshin moshat 14 –18 vjeç dhe përbehet nga arsimi i mesëm i përgjithshëm 4 vjeçar dhe arsimi profesional 4-5 vjeçar. Numri i studentëve që ndjekin të dy shkollat e përgjithshme dhe profesionale me dhe pa shkëputje nga puna është 102 161 nxënës, prej të cilëve 48% janë vajza dhe 52% djem. (shtojca III, tab.1)

59% e nxënësve që mbarojnë arsimin e detyrueshëm, vazhdojnë studimet e tyre në shkollat e mesme. Në vitin 1998 përfunduan arsimin tetevjeçar 50 387 nxënës (50% vajza) dhe vetëm 30 350 u regjistruan në vitin e parë të shkollës së mesme (44% vajza Tabela15). Në qytete 52% e vajzave që mbarojnë arsimin tetevjeçar vazhdojnë studimet e tyre në shkollat e mesme, ndërsa në zonat rurale kjo shifer është 28% për vajzat dhe 72% për djemtë. Kështu, nga 14 458 vajza fshatare që mbarojnë arsimin tetevjeçar vetëm 4.065 vazhdojnë shkollën e mesme. Megjithatë në zona të tjera numri i vajzave që regjistrohen në shkollat e mesme është më i lartë, diferenca midis numrit të vajzave dhe djemve është akoma e lartë.

Një tjetër fenomen shqetësues është pjesëmarrja e ulët e nxënësve në shkollat profesionale (vetëm 14% e numrit të përgjithshëm të nxënësve Tabela (16-17). Në shkollat profesionale janë regjistruar 14.423 nxënës, prej të cilëve 30% janë vajza dhe 70% janë djem, ndërsa në zonat rurale kjo përqindje është 22.6% për vajzat dhe 77.4% për djemtë. Në shkollat bujqësore, të ndërtimit dhe ato mekanike pjesëmarrja e vajzave ndryshon nga 10-25%. Këto raporte të ulta vijnë nga vështirësitë që paraqet profesioni ose për shkak të ndonjë mentaliteti për natyrën e këtyre profesioneve.

Përpara vitit 1990 shkollat bujqësore kishin një pjesëmarrje të lartë nga vajzat e fshatit, kryesisht për shkak të mundësive të kufizuara në pranimin në shkollat e mesme të përgjithshme ose në shkollat të tjera profesionale (shtojca III, tab.3). Në kundërshtim me këtë fakt, përqindja e vajzave që ndjekin shkollat e mesme të gjuhëve e huaja, liceun artistik ose shkollat pedagogjike është shumë e lartë, në disa zona është mbi 90%. Gjithashtu nga vajzat frekuentohen shumë edhe shkollat ekonomike dhe teknologjike (informatike) (respektivisht 50% dhe 70%). Nxënësit në shkollat e mesme janë më të rrezikuarit për shkak të braktisjes së shkollës dhe përfshirjes së tyre në krime (kryesisht droga, prostitucioni). Analiza të pjesëshme tregojnë që minorenët e përfshirë në krime shpesh kanë braktisur shkollën, por nuk egziston akoma një studim kombëtar në lidhje me këtë fenomen.

VI.3. ARSIMI I LARTË

Aktualisht në Shqipëri ka 11 Universitete dhe shkolla të larta, nderkohe qe në vitin 1991 kishte vetëm një universitet dhe 7 Institute te larta Pedagogjike, Bujqesore, i Arteve dhe Edukimit Fizik. Rritja e numrit te Universiteteve erdhi si rezultat i faktit se Instituteve te Larta te mëparshme ju dha statusi i Universitetit. Në nivelet e larta akademike nga 146 profesorë vetëm 10 jane gra (6.8%), nga 250 asistent profesorë 58 jane gra (23.2%). Megjithatë ka një ulje te ndjeshme te numrit te studentëve të ardhur nga zonat rurale (shkaktuar nga kushtet e veshitira ekonomike dhe dhe fluksi i emigrimi te brendshem). Kështu, nga 7.670 studentë me shkeputje nga puna, të ardhur nga zonat rurale në vitin 1991, në vitin 1998 ishin vetëm 3.231, ose 42% e tyre, nderkohe qe thame se numri i pergjithshem i studenteve eshte rritur me mbi 30%. Sidoqofte, raporti djem-vajza te ardhur nga zonat rurale qe frekuentojne shkollat e larta eshte i kenaqshem; 33% djem dhe 77% vajza (në vitin 1991 raporti ishte 54% për djemtë dhe 46% për vajzat). Përqindja e vajzave të regjistruara në universitete është në rritje. Kështu, nga 53.1% vajza te pranuar ne vitin akademik 1990-1991, sot janë 65%.

Fakultetet e shkencave sociale, mjekesia dhe ekonomia janë shumë popullore (vetëm një ne 10 kandidatë është pranuar), ndërkohë që fakultetet e mesimdhënies dhe te bujqësisë mbulojne me veshtiresi vendet qe kane ne dispozicion. (Tabela 19,20)

VI.4. NORMA E BRAKTISJES SË SHKOLLËS

Nje fenomen mjaft shqetesues i viteve te fundit eshte braktisja e shkollës dhe sipas statistikave te fundit kjo norme ka arritur ne 2.7%. Kjo rritje e papritur është si rezultat i mendimit që arsimit nuk është rruga e vetme për të siguruar një jetë më të mire: Shumë studentë pas mbarimit te arsimit të detyrueshem e lene shkollen per te gjetur mundesi punesimi, ndërsa të tjerë madje s'e ndjekin as arsimin e detyrueshëm. Kjo është në veçanti e dukshme ne zonat rurale, ku kushtet e vështira ekonomike detyrojnë fëmijët të braktisin shkollën për të ndihmuar familjet e tyre në punët e bujqësisë. Përveç kësaj, migrimi ne shkalle te gjere nga zonat rurale në qytete krijoi probleme në sigurimin e stafit pedagogjik (veçanërisht në zonat e largëta) si dhe në mbingarkimin e shkollave ne qytete me nxënës dhe mbylljen e shkollave në zonat rurale. Përsa u takon vajzave, ato përballen me vështirësi të tjera per te frekuentuar shkollën, pasi shpesh shkollat jane shumë larg dhe transporti i tyre nuk është i siguruar.

Fenomeni ka marrë përmasa dramatike në disa qytete (si Kuçovë, 12.9%, Durrës 8.8%, Kukës 8.2%, Mallakastër 7%, Has 5.6%, Elbasan 5%), e cila lë të kuptojë se është një shpërndarje gjeografike që përfshin jo vetëm zonat e largëta malore, por gjithashtu edhe qytetet. Në vitet 1991-1992 norma e braktisjes se arsimit të detyruar arriti në 6.34%, duke rene ne 4.1% në vitet 1992-1993.

Braktisja e shkolles në përqindje (%) nga fëmijët e arsimit tetëvjeçar sipas viteve është paraqitur ne grafikun 1.

KAPITULLI VII PUNËSIMI

Neni 11

1. Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar diskriminimin e gruas në fushën e punësimit, me qëllim që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të njëjtat të drejta, dhe konkretisht:

- a) të drejtën për punë si një e drejtë e pamohueshme e çdo njeriu;*
- b) Të drejtën për të njëjtat mundësi punësimi, përfshirë zbatimin e të njëjtave kriteret të përzgjedhjes për punësim;*
- c) Të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës , të drejtën për t'u ngritur në përgjegjësi, për punë të qëndrueshme, për përfitimet dhe kushtet e shërbimeve, të drejtën për përgatitje profesionale dhe kualifikim, përfshirë mësimin e zanateve, përsosjen profesionale dhe kualifikimin e pandërprerë;*
- ç) Të drejtën për pagë të barabartë,përfshirë shpërblimet , për trajtim të barabartë për punë më të njëjtën vlerë, si dhe për trajtim të barabartë lidhur me vlerësimin e cilësisë së punës;*
- d) Të drejtën për sigurime shoqërore,veçanërisht në rastet e daljes në pension, të papunësisë, të sëmundjeve, të invaliditetit dhe pleqërisë ose për çdo humbje tjetër të aftësisë për punë, si dhe të drejtën për pushime të paguara;*
- e) Të drejtën për mbrojtjen e shëndetit dhe për sigurimin në punë, përfshirë ruajtjen e funksionit të riprodhimit.*

2. Për të parandaluar diskriminimin e gruas për shkak martesë ose të amësisë dhe për të garantuar të drejtën e saj afektive për punë, Shtetet Palë zotohen të marrin masat e duhura që të kenë për efekt:

- a) Moslejimin e pushimit nga puna për shkaqe shtatëzanie apo amësie, si dhe diskriminimin në raste të pushimit nga puna për shkak martesë, duke parashikuar edhe sanksione;*
- b) Vendosijen e dhënies së lejes së paguar të amësisë ose ndihmave sociale të krahasueshme, duke ruajtur vendin e punës së mëparshëm, vjetërsinë dhe shpërblimet sociale;*
- c) Inkurajimin e sistemit të shërbimeve sociale mbështetëse të nevojshme për t'u lejuar prindërve të gërshetojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë profesionale,e njëherësh të marrin*

pjesë në jetën publike, sidomos duke favorizuar vendosjen dhe zhvillimin e një rrjeti çerdhesh e kopshtesh;

ç) Sigurimin e një mbrojtjeje të veçantë për gratë shtatzëna kur provohet se puna që kryejnë është e dëmshme

3. Ligjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e grave në fushat që përmenden në këtë nen do të rishikohen periodikisht në varësi të njohurive shkencore e teknike dhe sipas nevojave , do të rishikohen, anulohen ose zgjerohen.

VII.1. NDALIMI I DISKRIMINIMIT NË PUNËSIM DHE PROFESION

E drejta për t'u punësuar sanksionohet në Kushtetutë, neni 49(1): “Çdo njeri ka të drejtë të fitoje mjetet e jetesës së tij me punë të ligjëshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lire të zgjedhë profesionin, vendin e punës si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.”

Ky parim gjen zbatim për të gjithë shtetasit, si për burrat dhe për gratë. Kodi Penal ndalon diskriminimin në bazë të seksit që çënon të drejtën e individit për të qenë i barabartë në punësim dhe në trajnim, në procedurat e marrjes në punë dhe kushtet e punës, në kryerjen e detyrave, në shpërblim, asistencë sociale dhe përfundimin e kontratës së punës si dhe në pjesëmarrjen në sindikatë.

Në veçanti kodi i punës parashikon:

- Neni 9(1): Ndalimi i diskriminimit
- Neni 9(2): Përcaktimi i diskriminimit
- Neni 10: Pjesëmarrja në sindikatë
- Neni 32(1): Detyrimi i punëdhënësit për të respektuar dhe mbrojtur personalitetin e të punësuarit
- Neni 32(2): Ndalimi i ngacmimit seksual
- Kapitulli 8, nenet 39-75: Shëndeti dhe sigurimi në vendin e punës
- Kapitulli 9, nenet 76-97: Orët e punës dhe leja e paguar
- Kapitulli 10, nenet 98-108: Masat për veçanta mbrojtëse për gratë dhe fëmijët.
- Kapitulli 11, nenet 109-134. Shpërblimi

Shkelja e dispozitave të sipërpërmendura denohet me një gjobë që shkon nga 20-50fishin e pages minimale të vendosur me ligj.

Në Kodin e Punës janë parashikuar rregulla të veçanta për mbrojtjen e gruas punëtore. Neni 54(3) parashikon që gruaja shtatzënë që punon vazhdimisht në këmbë, në çdo katër ore duhet të pushojë të paktën 20 minuta. Neni 55 parashikon që pesha që mund të ngrëjë gruaja është deri në 20 kg, ndërsa për burrin është 55 kg.

Sipas nenit 72 punëdhënësi, në vendet ku punojnë gra, është i detyruar, përveç kushteve të tjera higjienike, të sigurojë dhoma të veçanta për to.

1. Tregu i punës

Vitet e para të tranzicionit u karakterizuan nga një rritje e menjëhershme e numrit të të papunëve si rezultat i mbylljes së shumë ndërmarrjeve shtetërore. Kjo tendence negative filloi të përmirësohet dhe në vitet 1993-1996 papunësia filloi të ulet si rezultat i përmirësimit të ekonomisë dhe rritjes së numrit të bizneseve të vogla e të mesme. Megjithatë një vlerësim i saktë i tregut të punës në Shqipëri aktualisht është i veshtirë pasi shumica e popullsisë është fshatare (dhe nuk janë të regjistruar si të papunë) dhe i nivelit të lartë të punësimit në punë të zeza.

Rritja e shifrave të papunësisë pas vitit 1997 është gjithashtu e lidhur me faktin se shumë prej punonjësve potenciale, me parë nuk ishin deklaruar dhe regjistruar si të papunë pasi ata përfitonin pagesa mujore nga investimet e bera në skemat piramidale.

Tregu shqiptar i punës ofron mundësi të kufizuara për të papunët me kualifikim të ulët. Ndërsa 48% janë me arsim të nivelit të ulët dhe 49% janë me arsim të mesëm, të papunët kanë nevojë për kurse ri-trajnimi profesional që të realizojnë punë specifike. Mundësitë e trajnimit profesional mungojnë si nga ana cilësore ashtu dhe nga ajo sasiore.

Mungesa e mundësive të grave në tregun e punës është e mirëdokumentuar. Norma aktuale e papunësisë së femrave është 21% përkundërt 16% për meshkujt (Tabela 21)

Faktorë të ndryshëm të brendshëm e të jashtëm kanë penguar bizneset private (me përjashtim të fushave të tilla si tregti, shërbime dhe ndërtim) në rritjen e tyre. Në të njëjtën kohë është penguar edhe roli i rëndësishëm që luajnë ato në ekonomi dhe në tregun e punës.

Shkaku kryesor i papunësisë së qyteteve, përveç nivelit të ulët të aftësive, është edhe migrimi masiv i popullsisë nga zonat rurale në ato urbane.

Sipas INSTAT në vitin 1989 niveli i punësimit ishte 85% për gratë dhe 94% për burrat, ndërsa pas vitit 1990 ai u ul në 50 - 60% për të dyja sekset².

2. Shpërblimi i barabartë

Përsa i përket shpërblimit të barabartë midis burrave dhe grave nën 115 i Kodit të Punës, në paragrafin 3 parashikon që punëdhënësi t'u japë burrave dhe grave page të barabartë për punë me vlerë të barabartë. Kufiri i provës me anë të së cilës punëdhënësi duhet të provojë se nuk ka diskriminim. Ky formulim është në përputhje me të gjithë instrumentat ndërkombëtarë (ILO-Konventa nr.100 mbi Shpërblimin e barabartë, 1951), në të cilën Shqipëria është palë.

² INSTAT Femra dhe Meshkuj në Shqipëri, Tirane 1998, fq.4

Gjatë dekadës së fundit niveli i pagës ka ndryshuar vazhdimisht. Deri në fundin e vitit 1989 paga ishte i vetmi burim të ardhurash për tërë popullsinë punëtore. Pagat ishin percaktuar nga shteti si një sistem i caktuar të ardhurash bazuar në cilësinë dhe sasinë e punës kryer. Që nga viti 1991 pagat u rritën në të gjithë sektorët e rëndësishëm ekonomikë. Për nëpunësit shtetërorë u paraqit një sistem i ri pagash që përfshinte 22 kategori të bazuara në vlerësimin e vendit të punës, që merrte në konsideratë llojin e punës, përgjegjësitë dhe vështirësitë. Ky sistem i ri shënoi fillimin e procesit të diferencimit midis pagës për punë të kualifikuar dhe asaj të pakualifikuar (Tabela 22).

3. E drejta për mbrojtjen e mëmësisë

Një grua ka të drejtën e lejes së lindjes, nëse ajo ka qënë e përfshirë në skemat e sigurimeve shoqërore për 12 muajt e fundit dhe ka qënë e punësuar me një kontratë punësimi nga momenti i fillimit të shtatëzanisë deri në fillimin e lejes së lindjes. Periudha e përfitimit të lejes së lindjes është 365 ditë duke përfshirë një minimum prej 35 ditë përpara lindjes dhe 42 ditë pas lindjes (neni 104 i Kodit të Punës). Një grua e cila lind me shumë se një fëmijë njëherësh ka të drejtën e 390 ditëve leje duke përfshirë një minimum prej 60 dite para lindjes dhe 42 dite pas lindjes.

Gruaja e punësuar merr gjatë lejes së lindjes 80% të pages ditore përpara lindjes dhe për 150 ditë pas lindjes dhe 50% për periudhën e mbetur, bazuar kjo në pagën mesatare të vitit të mëparshëm. Përfitimet e lejes së lindjes së gruas së punësuar janë të njëjta me përfitimin e saj të pensionit. Një nënë që birëson fëmijë, ka gjithashtu të drejtën e një përfitimi të tillë kur ajo është e siguruar dhe plotëson kushtet e parashikuara nga ligji (neni 106 i Kodit të Punës). Punëdhënësi është i detyruar që t'i ruajë vendin e punës një gruaje gjatë periudhës që ajo është me leje lindjeje.

Këshilli i Ministrave në 1996 percaktoi rregulla të posaçme për mbrojtjen e grave shtatzëna dhe ndalon punësimin e grave shtatzëna dhe me fëmijë në gj, në veprimtari që i ekspozojnë ato ndaj faktoreve dhe kushteve të punës të rrezikshme. Gratë shtatzëna dhe nëna me fëmijë në gj nuk janë të detyruara të fillojnë punën para orës 5 në vere, (apo 6 në dimer), dhe pas orës 8 në mbremje. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë konsideron një akt kriminal kundër grave shtatzëna kushtet e keqësuar, (neni 50(e), ndërsa neni 79(b) parashikon burgim të përjetshëm për vrasjen e gruas shtatzënë.

4. E drejta për sigurime shoqërore

Në fushën e sigurimeve shoqërore gratë gëzojnë një sërë të drejtash, të tilla si përfitimet në rastin e sëmundjeve, pensioni i pleqërisë, përfitimet e invaliditetit, përfitimet familjare dhe përfitime të tjera të lidhura me aksidentet në vendin e punës, sëmundjet profesionale, papunësia etj. Sipas ligjit 7703, të 11 Majit 1993, një grua mund të përfitojë nga paaftësia e përkohëshme e shkaktuar nga një sëmundje ose aksident që nuk është i lidhur me punën që ajo ben. Paaftësia duhet të provohet nga një raport mjekësor, në bazë të rregullores nr.3, të datës 05.10.1993, "Për leshimin e raporteve të paaftësisë së përkohëshme në punë" i leshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Ministria e Shëndetësisë.

Gratë perfitojne pensionin e tyre te plotë në moshën 55 vjeç, me kusht që ato të kene punuar për 35 vjet dhe te mos kene ndonje aktivitet ekonomik. Nënats që kanë 6 ose më shumë fëmijë mbi 8 vjeç kane te drejte te perfitojne pension ne moshen 50 vjeç, nese ato kane jo me pak se 30 vjet pune (neni 31).

Përfitimi nga papunësia, i parë si sigurim shoqëror u paguhet individëve, për një vit. Në vitin 1998, 25. 000 persona përfituan nga kjo skemë. Mbrojtja sociale përfshin programin e asistencës sociale, e cila i jepet shumicës se familjeve, të cilat nuk kanë të ardhura ose kane shumë pak për të jetuar. Gjithashtu është një skemë e mbrojtjes sociale për invalidët. Ky sigurim i jepet te paaftëve qysh nga lindja (per të paaftët për punë). Ndonëse vendi ka pasur një rrjet të vazhdueshëm të programeve të mbrojtjes sociale për shumë vjet, një pjesë e madhe e popullsisë është akoma e pambrojtur ose e papërfshirë ne keto skema. 54% e të papunëve marrin asistencë sociale, dhe 9% marrin përfitim si të papunë, por që akoma 37% e të papunëve nuk marrin asgjë.

5. Puna e nates

Neni 108 i Kodit të Punës dhe Vendimi i KM Nr.145 i datës 10 Gusht1998 ndalon punën e natës për gratë shtatëzëna. Kjo dispozitë u diskutua gjate hartimit te Kodit te Punes, pasi puna e nates u konsiderua e dëmshme për shëndetin e grave.

Keshillin e Ministrave në zbatim të Ligjit nxjerr akte nënligjore ku percaktohen rastet e vecanta kur gruaja mund te punojë gjatë natës.

6. Emigracioni

Gratë emigrante janë ne pergjithesi me te prekura se burrat. Nje numer i madh i grave shqiptare qe ndodhen ne emigracion, jane te punesuara ne tregun joformal, pa kontrate punesimi dhe si pasoje pa sigurime shoqerore dhe shendetesore. Shumica e grave jane te punesuara ne pune me kualifikim te ulet, si sherbime shtepiake, bujqesi, bare dhe restorante, pavaresisht nga niveli i tyre arsimor ose eksperienca ne pune.

Emigracioni i grave të martuara, shpesh të shoqëruara nga fëmijë qe jane ne moshë shkolllore, ka shkaktuar probleme per vazhdimësinë e familjes dhe jetës shoqerore dhe ka rrezikuar strukturen tradicionale te familjes. Megjithate shumë shpesh nënat jane kthyer ne nje prind të vetëm pasi tashme nuk eshte dicka e rralle qe burrat qe ndodhen ne emigracion te nderpresin dergimin e parave si dhe te humbin kontaktet me familjen. Bashkimi familjar është gjithashtu mjaft i vështirë si pasoje e politikave te rrepta për emigracionin në shumicen e vendeve pritese.

Gratë e moshuara janë një tjetër kategori shoqerore e prekur nga pasojat negative te emigracionit. Nje vezhgim per njerëzit e moshuar te bere ne 1997 ne qytetin e Tiranës

tregon që shumë gra të moshuara jetojnë vetëm, në kushte të pasigurta ekonomike si pasoje e vështirësive ligjore për t'u bashkuar me fëmijët e tyre që punojnë jashtë shtetit³.

7. Punesimi part-time dhe puna ne shtëpi

Nenet 14 dhe 15 te Kodit të Punës trajtojnë respektivisht punën part-time dhe atë ne shtëpi. Puna part-time përcaktohet si një kontratë punësi sipas të cilit punonjësi është i detyruar të punojë me ore, gjysëm dite ose me dite, për një javë të plote pune me të ulet se puna javore normale me kohe të plote. Punesimi part-time ka të njëjtat të drejta dhe detyrime ashtu si dhe punesimi me kohe të plote.

Puna ne shtëpi, ashtu sic përcaktohet në nenin 15, është një kontratë punësi sipas të cilit punonjësi i kryen detyrat e tij/e saj në një vend të caktuar prej tij/saj sipas kushteve të dhëna nga punëdhësi. Punonjësi që punon ne shtëpi ka të njëjtat të drejta me punonjësin që punon ne ambientet ku punëdhësi zhvillon aktivitetin e tij.

8. Puna e papaguar

Aktualisht në Shqipëri nuk ka asnjë dispozitë për të përfshirë dhe llogaritur në GDP e vendit tone, punën e papaguar që kryejnë gratë në mirëmbajtjen e shtëpise.

9. Vetëpunësimi

Përfshirja e grave në bizneset private është akoma e ulët (gratë drejtuese në biznesin privat ishin 21% në vitin 1994, 16.8% në vitin 1996 dhe 18% në vitin 1997). Aktiviteti ekonomik kryesor në të cilën janë përfshirë gratë është:

- Tregti, shitje me shumicë dhe dyqane;
- Shërbimet, (dentist, noterë, avokatë, permanent etj);
- Agro-biznesi dhe industria, (kryesisht produktet e qumështit, tekstil, shtëpitë botuese, rrobaqepësi dhe punimet artizanale). Tabela 23,24

KAPITULLI VIII SHËNDETI

Neni 12

1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas në fushën e kujdesit për shëndetin, për t'u siguruar, mbi bazën e barazisë midis burrit dhe gruas, mundësitë për të përfutur shërbime mjeksore, përfshirë dhe ato të planifikimit familjar.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të mësipërm, Shtetet Palë i sigurojnë gruas gjatë shtatzanisë, lindjes

³ Situata dhe Roli i të Moshuarve në Shoqërinë Shqiptare, Tiranë 1998, fq.4

dhe pas lindjes shërbime të përshtatshme shërbime të përshtatshme, po qe nevoja, falas, si dhe një ushqim të përshtatshëm gjatë shtatzanisë dhe mbajtjes së fëmijës në gj.

VIII. 1. SHERBIMET SHENDETESORE BAZE

Neni 55 i Kushtetutës parashikon të drejta te barabarta të shtetasve për të gëzuar, kujdesin shëndetësor të siguar nga Shteti, ndërsa sipas nenit 59 (c) Shteti synon të sigurojë standartin më të lartë të mundshëm të shëndetit fizik e mendor për shtetasit e tij.

Periudha e tranzicionit pati një ndikim negativ në shërbimet shëndetësore. Në Produktin e Përgjithshëm Kombëtar (GDP) përqindja që zene shërbimet shëndetësore ka rënë në mënyrë të vazhdueshme nga 4,2% në 1993, në 3 % në 1997 dhe për vitin 1999-2000 ka qënë 2,5%. Kjo rënie është me e ndjeshme në zonat rurale. Në vitet 1993-1994, mbështetur në kriteret e mbulimit të popullatës (raportit mjek-popullatë) aspektit gjeografik të vendit, largësisë së fshatrave nga qendrat e rrethit. Në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore, Ministria e Shëndetësisë përgatit hartën sanitare të institucioneve të KSHP për çdo rreth. Numri i përgjithshëm i ambulancave, sidomos në zonat rurale me përcaktimin e ri u reduktua në 640 qendra shëndetësore dhe rreth 2000 ambulanca. Pas vitit 1997 harta sanitare erdhi duke u kompletuar me investimet përkatëse të cilat parshikonin në ndryshim me periudhën para 1996 edhe pajisjen e qendrave shëndetësore me orëdi zyre dhe pajisje mjekësore. Pas 1999 e në vazhdim numri i shtretërve spitalorë ka ardhur duke u rritur dhe numërohen rreth 10197 shtretër.

Liçensimi i aktivitetit privat ka filluar në vitin 1993, i cili përfshin liçensimin e personelit stomatologjik, mjekësor dhe farmaceutik. Numri i të liçensuarve nga Ministria e Shëndetësisë arrin shifrën 3394, nga të cilët 570 janë personel mjekësor, 1293 personel stomatologjik dhe 1531 personel farmacist. Funksionojnë rreth 80 depo farmaceutike, 32 klinika mjekësore, 6 klinika stomatologjike, 5 laboratorë stomatologjikë.

Mundësia për të pasur kujdes shëndetësor është e kufizuar edhe nga aftësia për të paguar për shërbimet. Para 1995, i tere sistemi i shpërndarjes së kujdesit shëndetësor ishte teresisht i financuar nga Buxheti i Shtetit. Aktualisht për të mbështetur pagesat për shërbimet shëndetësore aplikohen rimbursimet për medikamentet mjekësore si dhe kontributet e sigurimit shëndetësor. Sipas një vëzhgimi të kryer nga Banka Botërore në zonat urbane në 1996 rezultoi se 54% e të varfërve në këto zona nuk kërkonin trajtime mjekësore sepse ishin shumë të shtrenjta. Pavaresisht nga aksesit, cilesia e shërbimeve shëndetësore është aktualisht jo në nivelin e duhur.

Ministria e Shëndetësisë ka planifikuar në të ardhmen krijimin e një tipi të ri ambulance duke qënë se ky rrjet institucionesh është tepër i dëmtuar dhe Ministria e Pushtetit Lokal që mbulon ligjërisht nga ana financiare këtë rrjet ka kontribuar shumë pak në këtë drejtim. Këtu duhet të përmendim edhe kontributet e projekteve të ndryshme të financuar nga organizma të huaj si Banka Botërore, UNICEF dhe OJQ të ndryshme, të cilat orientohen sipas prioriteteve nga Ministria e Shëndetësisë në ato rrethe ku Buxheti i Shtetit është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e tyre investuese.

VIII.2. SHËNDETI RIPRODHUES

Gjatë rregjimit komunist është ndjekur një politikë favorizuese për lindjet, sipas së cilës kontraceptivët dhe aborti ishin të paligjshëm. Numri i aborteve ilegale u rrit duke sjelle si rezultat një nivel të lartë semundshmerie dhe vdekshmerie amëtare, ku mbi më shumë se gjysma e vdekjeve tek gratë shtatzëna ndodhte si pasojë e abortit ilegal. Shtatzanitë ishin teresisht të kontrolluara dhe vizitat para dhe pas lindjes ishin të detyrueshme.

Gjatë tranzicionit politikat shëndetësore ndryshuan dhe respektivisht në 1991 dhe 1992 u lejuan aktivitetet e planifikimit familjar dhe abortet e kryera neper spitale. Numri mesatar i vizitave paralindjes të gruas shtatzënë në nivel kombëtar është 5,1 % (1998) dhe mbulimi i shtatzënanive nga personeli mjekësor: 72% (1998) Por megjithëse ky numër mbetet ende i lartë në total, dueht të themi niveli i cilësisë së shërbimeit antenatal të ofruar nga personeli mjekësor, sidomos në drejtim të këshillimit dhe edukimit të gruas shtatzënë, dhe niveli i edukatës shëndetësore të gruas dhe familjes mbeten ende për të dëshiruar.

Planifikimi familjar

Numri i lindjeve është ulur nga 7 fëmijë për grua në 1960, në më pak se 2.7 fëmijë për grua në 1995 dhe 2.5 fëmijë per grua në 1997. Lindshmeria është rreth 25% më e lartë në vendet rurale se në zonat urbane.

Shërbimet e planifikimit familjar dhe keshillimi ofrohen prane spitaleve dhe në qendrat shëndetësore (pilula gojore dhe paisjeve kunder mbetjes shtatzane); megjithëse metodat e planifikimit familjar u prezantuan në vend që në 1992, pranimi dhe kërkesa për kontraceptivë është akoma e ulët duke u krahasuar me vendet e tjera (sipas Ministrise se Shëndetësisë kemi një përdorim të kontraceptivëve prej 12% për gratë në moshën e riprodhimit kundrejt 39% në vendet e tjera në tranzicion dhe 73% në vendet e industrializuara). Ky nivel i ulët i përdorimit të kontraceptivëve lidhet kryesisht me punën e pamjaftueshme ne drejtim të Informim-Edukim-Komunikimit për Shëndetin Riprodhues që është bërë gjatë këtyre viteve. Për këtë Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur edhe projektin e "Strategjisë Kombëtare për Informim-Edukim-Komunikimin mbi Shëndetin riprodhues, ku janë përfshirë një sërë aktivitetesh që do të ndikojnë në përmirësimin e punës së personelit shëndetësor në drejtim të informimit të popullatës, si dhe të një edukimi më të mirë të popullatës me planifikimin familjar.

Aborti u liberalizua në 1991 me një Vendim te Qeverise, ndërsa Ligji Nr. 8045 "Për ndërprerjen e shtatzanisë" hyri në fuqi 7.12.1995. Në vitin 1997, 1 në çdo 3 shtatzani perfundonte në abort. Fakti që numri më i madh i aborteve është vënë re ndërmjet grave të grupmoshës 24-34 vjec, ne përgjithësi të martuara dhe me fëmijë, konfirmon që aborti përdoret akoma si metodë e planifikimit familjar. (Tabela 25,26,27)

Shtatzania mund të ndërpritet për arsye shëndetësore brenda 22 javëve dhe për arsye psikosociale brenda 12 javëve të para të shtatzanisë. Me se fundi, aborti është i lejueshem

për arsye sociale brenda 22 javëve të para të shtatëzanisë, kur një komision i përbërë nga një mjek, një punonjës social e një jurist provon që shtatëzania është rezultat i dhunës apo krimeve të tjera seksuale, ose kur ka arsye të veçanta shoqërore për të ndërprerë shtatëzani.

Në ligj nuk parashikohen rastet urgjente, por ndërprerja e shtatëzanisë mund të bëhet në ato raste kur jeta e gruas është në rrezik. Ligji nuk parashikon si një kusht paraprak pëlqimin e babait të fëmijës për abortin përderisa vendimi për vazhdimin ose jo të shtatëzanisë varet vetëm nga gruaja. Në rastet e shtatëzanisë për vajzat e reja nën 16 vjeç, kërkohet pëlqimi i prindërve ose i kujdestarit legal. Neni 93 i Kodit Penal ka të bëjë me ndërprerjen e shtatëzanisë pa dëshirën e gruas (abort i detyruar), duke përjashtuar rastet kur ndërprerja është e justifikuar për arsye shëndetësore (kur jeta e gruas është në rrezik) dhe kur aborti është kryer në vende të paautorizuara, si në ambiente publike jo-spitalore ose klinika private pa lejen e duhur ose nga persona të pakualifikuar, ose kur ndërprerja e shtatëzanisë kryhet jashtë periudhës së caktuar në ligj.

Mundësia e abortit të ligjshëm për një shtatëzani të padëshiruar e ka ulur vdekshmërinë memesore, por numri i aborteve në krahasim me lindjet e gjalla është akoma shumë i lartë në krahasim me vendet e tjera, duke e konsideruar abortin si një nga metodat më të përhapura kundër shtatëzanisë së padëshiruar. Në tabelën dhe grafikun 28 jepet numri i aborteve të krahasuar me lindjet e gjalla, (por shifrat nuk përfshijnë abortet e kryera privatisht).

Sipas grafikut pika më e lartë paraqitet në vitin 1994-1996 që më pas ndiqet nga një rënie e lehtë. Raporti abort/lindje për 6 muajt e para të vitit 1998 ishte 1 për 2.5 lindje të gjalla. Megjithatë legalizimi i abortit ka patur efekt pozitiv në reduktimin e vdekjeve, perseri metodat e pasigurta që përdoren akoma dhe mungesa e regjistrimit të aborteve të bëra në klinikat private pengojnë nxjerrjen e të dhënave të sakta.

Megjithatë kujdesi para lindjes është i mundshëm pavarësisht nga zona e banimit, infrastruktura e varfër, paisjet e kufizuara dhe personeli mjekësor i patrajnuar e bëjnë të papershmatshme shpërndarjen e ketyre shërbimeve.

Vdekshmëria amëtare

Vdekshmëria amëtare për vitin 1997 është 27.5 vdekje/100 mijë lindje të gjalla, në vitin 1998 kjo shifër është 20.5 dhe për 1999 16.5. Tabela 30) Vdekshmëria amëtare shkaktohet nga hemorragjitë e paslindjes si dhe nga infeksionet, nga hipertensioni gjatë shtatëzanisë dhe nga abortet septike. Mundësitë e pakta për një kujdes emergjent obstetrik, veçanërisht në zonat jo urbane, mungesa e infrastruktures dhe transportit, cilësia e ulet e shërbimeve shëndetësore baze dhe kushtet e varfra higjieno-sanitare ndikojnë në nivelin e lartë të vdekshmërisë memesore.

Treguesi i vdekshmërisë foshnjore për 1997 është 25.8 vdekje për 1000 lindje të gjalla, për vitin 1998 është 20.5 vdekje për 1000 lindje të gjalla e krahasuar me 25.8 vdekje për 1000 lindje të gjalla në vitin 1996, dhe për 1999 është 17.5. Shkaqet kryesore të vdekshmërisë foshnjore sipas Ministrisë së Shëndetësisë janë sëmundjet e rrugeve të frymemarjes,

anomalitë e trashëgueshme, sëmundjet diarreike, infektive, sëmundjet e të porsalindurit.
Tabela 29

Aksesi i pakët ndaj shërbimeve shëndetësore, niveli jo i mirë i cilësisë së këtyre shërbimeve sidoms në drejtim të informim këshillimit, mungesat në pajisjet dhe shërbimet, si dhe niveli i edukimit të familjes dhe kryesisht nënës, janë shkaqet kryesore që ndikojnë në vdekshmërinë foshnjore. Kanceri i gjirit the qafes se mitres ze nje vend te rendesishem ne listen e semundjeve kanceroze ne vlere absolute ne Shqiperi (te dhenat e viti 1997) .

Aktualisht ka një përmirësim të punës së personelit shëndetësor në drejtim të depistimit të këtyre kancereve dhe trajtimit të tyre që në stadet më të hershme dhe ky është një nga faktorët që ka ndikuar edhe në rritjen e numrit absolut të këtyre kancereve. Këto 5 vitet e fundit janë kryer ekzaminime të rëndësishme si kontrolli mamografik, pap test, kolposkopia, të cilat më parë nuk kryheshin në vendin tonë. Këto ekzaminime nuk janë shtrirë në të gjithë vendin dhe gjithashtu mbetet punë për të bërë në drejtim të informimit dhe edukimit të grave për ndërgjegjësimin e tyre për kryerjen e ekzaminimeve rutine për kapjen e këtyre kancereve në kohe.

Rëndësi ka këtu të përmendet edhe Ligji Nr. 8528/ 23.09.1999 "Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji", ligj ky që nxit dhe mbron ushqyerjen me gji, duke patur ndikim të drejtëpërdrejtë në shëndetin e nënës dhe fëmijës, si dhe rregullon praktikën e tregtimit të prodhimeve zëvendësuese të qumështit të gjirit, duke ndaluar promovimin, reklamimin dhe shpërndarjen e tyre në institucionet shëndetësore. Shkelja e këtij Ligji përbën kundërvajtje penale dhe prodhuesi apo shpërndarësi që kryen këtë kundërvajtje penale dënohet me gjobë. (Neni 13 i Ligjit), sanksioni shkon deri në heqje licëse.

VIII.3. SEMUNDJET SEKSUALISHT TE TRANSMETUESHME

Në Shqipëri, masat për parandalimin, zbulimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse parashikohen në dy Ligje bazë dhe 4 udhëzime të veçanta, Ligji Nr. 7761/ 19.10.1993 "Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, Ligji Nr. 8689 datë 16.11.2000 "Për parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë".

Sipas studimeve të kryera në Institutin e Shëndetit Publik rezultoi se disa nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme kanë tendencë të përhapen si rrjedhojë e ndryshimeve politike dhe sociale ekonomike që ndodhën vitet e fundit, pas hapjes së vendit në botën perëndimore. Infeksioni i HIV/AIDS u regjistrua për herë të parë në vitin 1993. Në vitin 1995 pas një periudhe të gjatë të zhdukjes u diagnostikuan rastet me sifiliz. Infeksionet e gonore, trikonomiazës dhe ato të shkaktuara nga klamidia kanë qënë prezëntë në nivele të ndryshme. Diagnostikimi i këtyre infeksioneve bëhet pranë laboratorëve të shëndetit publik dhe në Tiranë edhe pranë laboratorit mikrobiologjik të Spitalit Obstetrik-Gjinekologjik- Qendra e Referencës Kombëtare për HIV/AIDS dhe sifilizin është Instituti i Shëndetit Publik.

Për problemet e HIV/AIDS ka një vlerësim të veçantë. Janë dy laboratorë rajonalë dhe tre të tjerë në nivel nacional për diagnostikimin e HIV ndërsa në të gjithë rrethet që kanë Qendra të Dhurimit të Gjakut përdoren kitet e shpejta të diagnostikimit të dhuruesve.

Diagnostikimi dhe trajtimi i rasteve të zbuluara më HIV/AIDS behet pranë Qendrës Spitalore universitare në Tiranë. Shqipëria është vend me prevalencë të ulët të HIV-it.

Për këtë janë kryer studime në rekrutë, ka një interes në rritje të depistimit vullnetar, mjaft qytetarë që kërkojnë të emigrojnë jashtë kryejnë testimin për HIV. Nga këto ekzaminime nuk është zbuluar asnjë seropozitiv.

Deri tani sistemi i depistimit dhe këshillimit është realizuar nga institucionet e nivelit nacional ku ka dhe një bazë tëcmjaftueshme për të përballuar numrin e rasteve të diagnostikuara me HIV/AIDS.

Për sëmundjet seksualisht të transmetueshme ka një bazë ligjore të mirë ku mbështetet zhvillimi, deklarimi dhe trajtimi në mënyrë të detyrueshme. Mjekimi i HIV/AIDS, sifilizit dhe gonoresë, sipas Ligjit bëhet falas, pranë Klinikave spitalore ose ambulatorore.

Ne Nëntor 2000 është miratuar nga Parlamenti ligji "Për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë" dhe është krijuar Komisioni Ndërministror i HIV/AIDS.

Programi kombëtar për luftimin e SST/HIV-AIDS, i hartuar shumë vite më parë, ka gjetur zbatimin në mjaft drejtime dhe kemi gjetur mbështetjen e OBSH për zbatimin e tij. Kërkesat e reja që dalin do të përbëjnë objekt rishikimin e planit kombëtar ekzistues dhe veçanërisht në drejtim të forcimit të strukturave shëndetësore e joshëndetësore, për zbatimin e ligjeve në fuqi dhe për një veprimtari të organizuar multisektoriale.

VIII.4. SUBSTANCAT DROGUESE

1. Abuzimi me drogën

Kohët e fundit, përdorimi, prodhimi dhe trafiku i drogave janë përhapur shumë shpejt në Shqipëri. Rritja shpjegohet nga faktorë të ndryshëm socialë, politikë dhe ekonomikë. Problemi u perfocua edhe nga fakti se 65% e popullsisë është nën moshën 30 vjeç.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Rendit Publik numri i përdoruesve të drogës për çdo 1000 të rinj është dyfishuar në këto dy vitet e fundit. Drogat më të përdorura janë marijuana dhe produktet e tjera të cannabis sativa siç janë kokaina dhe heroina. Në shumicën e rasteve përdoruesit të drogës nuk e marrin atë në formë të pastër.

Analizat e kokainës dhe heroinës të bera në Shqipëri tregojnë se në to janë shtuar me shumë se 9 elemente të tjera duke u nisur nga aspirina e deri tek rera Grafiku 3 Ndërsa përdoruesit e drogës janë kryesisht të rinjtë, abuzuesit e drogave farmaceutike janë më të mëdhenj në moshë. (Grafiku 2) Gjithashtu ka dhe keqpërdorim të drogave psychotropike të cilat ose shiten nën dorë ose vidhen. Në të njëjtën kohë ato përdoren gjerësisht edhe si mjet për vetëvrasje. Vezhigimet tregojnë se raporti midis përdoruesve meshkuj dhe atyre femra të

droges eshte 4:1. Afersisht 70% e perdoruesve te droges vijne nga “familje normale”, me arsimim te larte dhe prinder me te ardhura te larta financiare. Pjesa tjetere kane vetem njerin nga prinderit ose asnje prej tyre, prinder te divorcuar ose me probleme sociale.

2. Duhani dhe alkoli

Per sa i perket konsumit te duhanit dhe alkoolit nuk ka te dhena statistikore te vlefshme dhe te besueshme. Vezhgimet e kryera midis nxenesve te shkollave te mesme (14-18 vjec) kane treguar se rreth 58% e meshkujve dhe 32% e femrave ishin pires te duhanit dhe ai konsumohet ne nje shkalle mjaft te larte nga popullsia shqiptare dhe eshte nje zakon shume i lejuar nga ana sociale.

Ndersa vezhgimet e kryera ne lidhje me konsumin e alkoolit treguan se perdorimi i tij fillon rreth moshes 15-16 vjeç dhe eshte kryesisht nje fenomen mashkullor. Nga Spitali Psikiatrik ne Tirane sigurohen edhe terapite e nevojshme.

Ka nje levizje te disa OJQ- te fushes se shendetit per ta ndaluar ne mjedise publike por nuk ka gjetur perkrahje nga strukturat ligjvënese.

KAPITULLI IX

NDIHMAT SOCIALE DHE EKONOMIKE

Neni 13

Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të eliminuar diskriminimin e gruas në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, për t'i siguruar, mbi bazës e barazisë së burrit dhe gruas, të njëjtat të drejta dhe pikërisht:

- a) *Të drejtën për shpërblime familjare;*
- b) *Të drejtën për hua bankare, ndihma hipotekore dhe forma të tjera të kreditit financiar*
- c) *Të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete zbavitëse, sportive dhe të gjitha aspektet e jetës kulturore.*

IX.1. E DREJTA PER NDIHME FAMILJARE

Qe nga krijimi i tij, programi i Perkrahes Sociale luajti nje rol vendimtar si ne zonat rurale ashtu dhe ne ato urbane pasi beri te mundur mbijetesen e fermave te vogla si dhe nje numri te madh te papunesh. Programi eshte krijuar per te siguruar nje kalim te ardhurash tek ato familje te cilat nuk kishin asnje te ardhur ose te ardhura te pamjaftueshme dhe nuk i plotesonin kerkesat per ndihme papunesie. Gjate vitit 1997 u vleresua qe 21% e popullsisë (prej te ciles 50% banonin ne zonat urbane) perfituan ndihmen e perkrahjes sociale (ky eshte dhe viti ne të cilin është dhënë më shumë perkrahje sociale).

Ne Tetor 1991, Ligji nr. 7521 u siguron ndihme papunesie per nje vit te gjithe atyre te cilet kishin humbur punen si rezultat i reformave ekonomike. Ligji nr.7579, Korrik 1992

parashikon disa klauzola shtese dhe qe atehere ndihma e papunesise paguhet (per nje periudhe maksimale deri ne nje vit) vetem per ata te cilet kane paguar sigurime shoqerore per te pakten 12 muaj. Te dhenat statistikore tregojne se numri i popullsisë qe perfitojne ndihme papunesie ne raport me te papunet e regjistruar ka pesuar nje rënie drastike nga 1993, duke treguar se papunesia ne Shqiperi eshte nje fenomen qe kerkon nje periudhe me te gjate kohe per t'u zbutur. Per me teper Ministria e Punes vlereson se ka nje perhapje te larte te punonjesve te cilet punojne pa kontrata te rregullta pune.

Instituti i Sigurimeve Shendetesore i krijuar ne 1995 subvencionon produktet farmaceutike per popullsinë qe mbulohen nga skemat e tyre (te gjithë qytetaret dhe rezidentet e huaj); kontributi i punedhenesve me 34.2% te pages **neto**. Keto sigurime perfshijne sherbime mjekesore falas (mjeku i familjes) dhe subvencionimet per blerjen e produkteve te caktuara farmaceutike. Grupi i cili perfiton nje pagese te plote te kontributit jane femijet nga mosha 1-6 vjec, studentet, personat te cilet marrin ndihme te perkrahjes sociale dhe te papunesise, pensionistet, personat me aftesi te kufizuar, grate shtatzane deri nje vit pas lindjes dhe personeli ushtarak. Invalidet, veteranet dhe pacientet me kancer e turbekuloz perfitojne 100% subvencionim.

IX. 2. E DREJTA PER KREDI BANKARE, PER TE HIPOTEKUAR DHE PER FORMA TE TJERA TE KREDITIMIT FINANCIAR.

Numri i bankave tregtare ne Shqiperi është rritur nga nje banke e linçensuar në 1992 ne 11 në vitin 1999. Megjithate ky numër është i vogël i karahasuar me vendet e tjera të rajonit. Megjithatë komuniteti i biznesit ka nevojë për një kreditim më të madh, mbi të gjitha kredite e dhena në sektorin privat në 3 vitet e fundit ishin jo më shumë se 3% e GDP-së krahasuar me 14-30% te vendeve te tjera të rajonit. Shkaku kryesor i kësaj praktike shtrenguese nga bankat eshte si rezultat i rrezikut te larte te moskthimit te kredive, mungeses se pergjithshme te stabilitetit ne biznes (bizneset e vogla kane mesatarisht nje jetegjatesi deri ne 1 vit), llogari te varfra dhe pamundesi te pergjithshme per te plotesuar kerkesat kolaterale. Mikrokredite jotregtare sigurohen nga agjensite e specifike kombetare dhe nderkombetare te zhvillimitte cilat jane te pranishme si ne zonat urbane ashtu dhe ne ato rurale (Banka Botërore, FZSHH, GTZ-DEG).

IX.3. E DREJTA PER TE MARRE PJESE NË AKTIVITETET KRIJUESE, SPORTE DHE NË TË GJITHA ASPEKTET E JETËS KULTURORE

Neni 58 i Kushtetutës lejon lirinë e krijimtarisë artistike dhe kërkimeve shkencore, ndërsa neni 59(h) njeh të drejtën e zhvillimit të sportit dhe të aktiviteteve krijuese. Pjesmarrja e grave në sport është e ulët së pari nga qëndrimet paragjyquese të cilat e konsiderojne sportin si një aktivitet të papërshtatshëm për to dhe së dyti për shkak të përgjegjësive familjare nga mundesive te kufizuara ekonomike.

Pavarësisht nga entuziazmi i grave per aktivitete kulturore, perfshirja e tyre mbetet përseri e ulët për shkak të faktorëve të mësipërm.

KAPITULLI X GRATE FSHATARE

Neni 14

1. Shtetet Palë duhet të mbajnë parasysh problemet e veçanta që ndesh gruaja fshatare dhe rolin e rëndësishëm që luan ajo për mbijetesën ekonomike të familjes, sidomos me punën e saj në sektorët jomonetarë të ekonomisë. Ata marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente në dobi të grave të zonave bujqësore.

2. Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të eliminuar diskriminimin e gruas në zonat fshatare me qëllim që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, pjesëmarrjen e saj në zhvillimin e fshatit dhe njëherësh në avantazhet që të sjell ai. Në mënyrë të veçantë ata i sigurojnë gruas këto të drejta:

- a) Të marrë pjesë në përpilimin dhe zbatimin e planeve të zhvillimit në të gjitha hallkat;
- b) Të përfitojë shërbime të përshtatshme në fushën e shëndetit, përfshirë informacionin, këshillimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar;
- c) Të përfitojë drejtpërdrejtë nga programet e sigurimeve shoqëror;
- d) Të marrë çdo lloj formimi dhe edukimi të rregullt ose jo, përfshirë atë që ka të bëjë me alfabetizimin funksional, si dhe inter alia të përfitojë nga të gjitha shërbimet e bashkësisë dhe të tjera, sidomos për të rritur njohuritë e saj teknike;
- e) Të organizojë grupe të ndihmës së ndërsjellë dhe kooperativa, me qëllim që të ketë mundësi të barabarta në rrafshin ekonomik, nëpërmjet punësimit ose vetëpunësimit;
- f) Të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e bashkësisë.
- g) Të ketë mundësi të marrë kredi bujqësore, lehtësi marketingu e teknologji të përshtatshme. Të ketë trajtim të barabartë në fushën e reformës tokësore e agrare, si dhe në projektet e sistemit bujqësor;

- h) *Të ketë kushte jetese të përshtatshme, sidomos lidhur me strehimin, përmirësimin e mjedisit, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, transportin dhe komunikacionin.*

X.1. SITUATA E PËRGJITHSHME

Shqipëria me gjithë procesin spontan e kaotik të urbanizimit, vazhdon të mbetet një nga vendet me pjesën më të madhe të popullsisë 60% që banon në fshat. Këto të dhëna e përcaktojnë Shqipërinë si një vend tipik bujqësor ku rreth 45.3% janë gra. Numri i grave që banojnë në zonat rurale ishte 98 690 në 1989 ndersa sipas të dhënave jo zyrtare rreth 100 000 gra jetojnë aktualisht në qytete me më pak se 10 mijë banorë. Niveli i jetës së grave në zonat rurale, krahasuar me nivelin e jeteses së burrave është shumë i veshtirë. Tradicionalisht gratë janë të përfshira në punët e bujqësisë njelloj si dhe burrat dhe kjo punë është shumë e vështirë si rezultat i mekanizimit të ulët dhe përdorimit të pakta të plehrave kimike. Për më tepër gratë fshatare duhet të bëjnë edhe të punët e shtëpisë.

Shumica e fermerëve nuk kanë mjete monetare për të investuar në mënyrë që t'i bëjnë fermat e tyre më produktive prandaj kërkesa për kredi në këto zona është e lartë. Sipas një studimi të kryer nga Banka Botërore në '95-'96, është llogaritur që 600 mijë njerëz në zonat rurale jetojnë nën nivelin e varfërisë. Veçanërisht e vështirë është situata në veri dhe në verilindje, ku sipërfaqja e tokës së punueshme është e vogël dhe mundësitë e punësimit janë të pakta dhe mungojnë mjetet kreditore.

Një karakteristikë tjetër e zonave rurale është niveli i lartë i migrimit. Në fillim të tranzicionit migrimi brenda vendit përfshiu të rinjtë 25-40 vjeç, në kërkim të mundësive të punësimit. Me kalimin e kohës, familje të tëra filluan të migrojnë nga qytetet e vogla dhe fshatrat në Veri si pasoje e gjakmarrjeve të vjetra e të reja, si dhe rritjes së vështirësive ekonomike. Lëvizja e pakontrolluar nga zonat rurale drejt zonave urbane solli përqëndrimin e popullsisë në periferitë urbane, veçanërisht në Tiranë dhe Durrës.

1. Kushtet e jetesës në zonat rurale krahasuar me zonat urbane

Sot për sot familja fshatare po i kushton shumë kujdes fitimit të castit dhe po nënvlefëson rrezikun social të analfabetizimit që çdo ditë po fiton terren dhe po rrezikon të ardhmen e vetë shoqërisë. Përkundrazi kjo ulje e nivelit arsimor ka filluar të ndikojë në largimin e gruas fshatare nga jeta publike, politike e shoqërore në fshat si dhe ngushtimin gjithnjë e më tepër të tregut të punës për gruan fshatare. Mundësitë për veprimtari ekonomike në këto zona janë tepër të kufizuara. Janë të rralla gratë fshatare që të jenë anetare dhe aktore të ndonjë biznesi individual apo që të jenë mbështetur me ndonjë kredi.

Në nivel kombëtar 2/3 e shtëpiakeve kanë mundësi për të patur ujë të vazhdueshëm, por ka diferencë thelbësore midis zonave urbane dhe rurale. Në zonat me më pak se 10 mijë

banorë, më shumë se gjysma e shtëpiakeve, 53.7% nuk kanë ujë të vazhdueshëm dhe si pasojë përdorin puset ose burime të tjera uji.

Rreth 1/3 e shtëpiakeve deklarojnë se përdorin energjinë elektrike si burim kryesor ngrohjeje. Por problemet e mungesës së energjisë elektrike i kanë detyruar ato që gjatë periudhës së dimrit për ngrohje të përdorin burime të tjera energjitike (dru, gaz, vajguri).

Një tjetër tregues i dallimit mes zonave rurale dhe urbane janë edhe paisjet shtëpiake. Siç tregon tabela 31, zonat me më pak se 10 mijë banorë nuk kanë mundësi që të përballojnë koston e një makine larëse (gjithashtu sepse ajo kërkon ujë të rrjedhshëm dhe energji të mjaftueshme) apo edhe një sobë elektrike për gatim.

X.2. TË DREJTAT SPECIFIKE

1. Mundësi për të patur pronësinë e tokës.

Në Kodin Civil ka një kapitull të veçantë që ka të bëjë me pronësinë e përbashkët midis anëtarëve të një familje fermere (neni 222 – 230). Pjesëtarët e familjes fermere gëzojnë të drejta të barabarta mbi pronën (persona me lidhje gjaku, martesë, adoptimi ose kur pranohen si anëtarë të familjes).

Familja prezantohet në marrëdhënie pronësie me palet e treta nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e familjes. Anëtarët nuk mund të ndajnë asnjë pjesë të pronës së familjes fermere, me përjashtim kur ajo i është dhënë atij/asaj si pronë personale, por çdo anëtar mund të kërkojë pjesën e tij/e saj të vlerësuar sipas sasise totale të pronës, numrit të pjesëtarëve dhe kontributit personal të personit që kërkon pjesën e tij/e saj. Në qoftëse ndarja kërkohet nga një anëtar i vetëm, pjesa e tij/e saj i jepet në vlerë monetare, ndërsa nëse disa anëtarë kërkojnë pjesën e tyre me qëllim për të krijuar një fermë të re familjare, atëherë pjesa mund t'u jepet në mënyrë që të sigurojë që pjesa e mbetur e tokës së kultivueshme nuk është më pak se minimumi i standartit të kultivimit.

Në nenin 230 përcaktohet në mënyrë specifike që familja fermere nuk është përgjegjëse për detyrimet ekonomike personale të anëtarëve të saj, kështu që kreditorët kanë të drejtë për t'u paguar vetëm nga pjesa e anëtarit debitor.

Pavarësisht nga keto dispozita, megjithëse kreu i familjes është zgjedhur në bazë të një marrëveshjeje jozyrtare, toka është e regjistruar nën emrin e tij. Në qoftëse kryefamiljari kërkon të ndajë tokën e familjes, ai mund të ndikojë apo detyrojë lehtësisht të shoqen dhe anëtarët e tjerë të familjes.

4. Mundësitë për vendimmarrje

Nëse mundësia për të zotëruar pozita vendimmarrëse dhe politike është e vështirë në zonat urbane, situata në zonat rurale është akoma më e vështirë. Në vitin 1996 nga 309 kryetarë komunash vetëm një ishte grua (ose 0.32%), nga 947 anëtarë të Këshillave të Bashkive

vetëm 61 ishin gra (ose 6.4%), nga 930 anëtarë të Këshillave të Rretheve vetëm 64 ishin gra (6.8%) dhe nga 3 548 anëtarë të Këshillave të Komunave vetëm 105 ishin gra (2.9%).

3. Mundësitë për shërbime shëndetësore

Mundësia për të patur shërbimet e kujdesit shëndetësor në zonat rurale është përfundimisht më e ulët se në zonat urbane, pasi shumica e ndërtesave dhe paisjeve u grabitën gjatë trazirave të 1991 dhe 1997, të tjerat u mbyllën për mungesë të personelit mjekësor të kualifikuar (u larguan në zonat urbane). Aktualisht numerohen 3494 qendra shëndetësore në zonat rurale por ato punojnë në kushte mjaft të vështira si rezultat i mungesë së paisjeve dhe personelit mjekësor. Në këto qendra punojnë vetëm infermiere dhe mami.

Gruaja fshatare ka nevojë jo thjesht vetëm për një mami por i duhet edhe mjeku dhe vizitat e tij, edhe higjienisti që t'i mesojë nevojën e higjenes së përgjithshme dhe personale, edhe psikologu për të përballuar stresin e shtatzanisë së parakohshme apo të paplanifikuar edhe sociologu për këshillën e dobishme dhe nevojën e integritit shoqëror të tyre. Megjithatë në fshat ka mungesë informacioni rreth shëndetit të nënës dhe fëmijës, shëndetit riprodhues, SST etj. Nga UNICEF, UNFPA dhe nga disa OJQ të shëndetit janë përgatitur shumë botime por është mjaft e vështirë shpërndarja e tyre në fshat për shkak të mungesës së infrastrukturës.

Ndërsa në vitin 1990 93% e të gjitha lindjeve bëheshin në maternitet ose në qendrat shëndetësore, sot është rritur numri i lindjeve në shtëpi vecanërisht në zonat rurale. Në vitin 1996, 11% e të gjitha lindjeve u bënë nëpër shtëpi, nga të cilat 0.5% pa asistencën e personelit të kualifikuar.

4. Mundësitë për sigurime shoqërore

Mbulimi nga sigurimet shoqërore është shumë i ulët dhe përfitimet janë të papërfillshme, vecanërisht nga të vetëpunësuarit në zonat rurale. Në vitin 1997 vetëm 27% e forcës punëtore të llogaritur paguante kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe si rrjedhojë mund të kishte mundësi për të përfituar p.sh pagesën për leje lindje. Në të njëjtin vit nga më tepër se 61 000 lindje të regjistruara në vend, vetëm 13 000 gra përfituan pagesën e lejes së lindjes (22% e të gjithë lindjeve). Sipas të dhënave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore vetëm 7.8% e të vetëpunësuarve në zonat rurale paguajnë kontributet; megjithatë pagesa e lejes së lindjes është aq e ulët sa është e pamundur për të mbijetuar prej saj (në 1998 një nënë e vetëpunësuar mori mesatarisht 5 USD gjatë 6 muajve të parë të lejes dhe 3 USD për periudhën e mëpasshme).

5. Mundësitë për kredi bujqësore dhe mjete marketingu

Në përgjithësi mundësitë për kredi tregtare për gratë janë të pakta dhe në zonat rurale kjo situatë është akoma më e vështirë për shkak të numrit të ulët të shërbimeve bankare të decentralizuara. Fondi i Zhvillimit Shqiptar, Fondacioni BESA, USAID dhe organizata të tjera sigurojnë mikro-kredi jotregtare për zonat rurale, por ndikimi i tyre është akoma i ulët për shkak të financimeve të kufizuara dhe përqendrimit rajonal. Programi Land O'Lakes në

Shqipëri, për shembull, ofron një paketë të plote trainimi për përmirësimin e produkteve të qumështit, nxitjen e vetëgrupimit dhe bashkëveprimit dhe asistencë në tregtimin e tyre.

KAPITULLI XI BARAZIA PARA LIGJIT DHE ME ÇËSHTJET CIVILE

Neni 15

1. Shtetet Palë i njohin gruas barazazinë me burrin para ligjit.

2. Shtetet Palë i njohin gruas, në lëmin civil, zotësi juridike të njëjtë me atë të burrit dhe të njëjtat mundësi për ta ushtruar këtë zotësi. Ata i njohin asaj në mënyrë të veçantë të drejta të barabarta përsa i përket lidhjes së kontratave dhe administrimit të pasurisë e po ashtu i akordojnë të njëjtin trajtim në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore.

3. Shtetet Palë u morën vesh që çdo kontratë ose çdo dokument tjetër privat, i çdo lloji qoftë, që ka për efekt juridik kufizimin e zotësisë juridike të gruas, duhet të konsiderohet i paqenë.

4. Shtetet Palë u njohin burrit dhe gruas të njëjtat të drejta lidhur me legjislacionin që trajton të drejtën e personave për të qarkulluar lirisht si dhe për të zgjedhur vendbanimin dhe banesën e tyre.

XI.I. BARAZIA E BURRAVE DHE GRAVE PARA LIGJIT

Neni 18 i Kushtetutës përmban parimin e barazisë para ligjit pa dallim seksi, feje, përkatësie etnike apo kushteve ekonomike, ndërsa neni 33 përcakton të drejtën për t'ju drejtuar një gjykate dhe neni 43 përcakton të drejtën e apelimit në lidhje me vendimet gjyqësore. Gjithashtu neni 42 i Kushtetutës siguron kryerjen e një procesi gjyqësor të paanshëm dhe publik nga një gjykatë e pavarur. Të gjitha aktet e tjera nënligjore duhet të jenë në pajtim me këto parime të përgjithshme.

XI.II. KUADRI LIGJOR I GRAVE

1. Kuadri i përgjithshëm ligjor

Sipas nenit 6(1) të Kodit Civil aftësia ligjore për të vepruar fitohet në moshën 18 vjeç, ndërsa gratë e martuara para kësaj moshe, nëpërmjet martesës fitojnë aftësi të plotë ligjore për të vepruar (neni 6(2)). Kjo e drejtë nuk humb as në rastet kur martesë deklarohet e pavlefshme apo zgjidhet pa u arritur mosha 18 vjeç për gruan. Mungesa e zotësisë juridike për të vepruar përcaktohet me ligj në rastet e sëmundjeve mendore apo të zhvillimit të kufizuar mendor. Çdo individ që ka zotësi juridike për të vepruar ka të drejtë të marrë pjesë në proceset gjyqësore civile (neni 91 i Kodit të Procedurës Civile).

II. Pronësia

E drejta e pronës private garantohet nga neni 41 i Kushtetutës, duke përcaktuar gjithashtu edhe mënyrat e fitimit të pronës (dhurata, trashëgimia, blerja e pronave të tjera sic parashikohet në Kodin Civil- kontratat). Ky parim trajtohet edhe në nenin 153 të Kodit Civil i cili parandalon humbjen e plotë ose të pjesshme të pronësisë të fituar ligjërisht (përveç rasteve të nevojave publike, shpronësimeve). Kodi Civil parashikon humbjen e pronësisë (neni 191) kur ajo fitohet nga një person tjetër ose kur hiqet dorë nga pronësia (në këtë rast është i nevojshëm akti noterial). Për më tepër pasuritë e palujtshme duhet të regjistrohen në përputhje me nenin 192 të Kodit Civil. Titulli III i Kodit ka të bëjë me pronën e përbashkët të dy ose më shumë individëve (e cila supozohet të jetë e barabartë për të gjithë deri në rast të kundërt). Cdo bashkëpronar ka të drejta dhe detyrime që rrjedhin prej pronës, por ata nuk mund të shesin pjesën e tyre pa u dhënë më parë mundësinë pronarëve të tjerë për ta blerë atë (neni 204).

3. Trashëgimia

Trashëgimia me ligj: zbatohet kur personi që lë një trashëgimi nuk ka bërë testament, ose ka bërë testament të pjesshëm, ose testamenti deklarohet pjesërisht ose terësisht i pavlefshëm (neni 316 i Kodit Civil). Çdo individ që jeton ose që është konceptuar para vdekjes së personit, ka të drejtën e trashëgimisë (neni 329). Brezi i parë i trashëgimtarëve është bashkëshorti/ja dhe fëmijët (edhe ata që janë jashtë martesë) të trashëgojnë pjesë të barabarta (neni 361); në qoftëse nuk kanë fëmijë, mund të trashëgojnë brezi i dytë i trashëgimtarëve, por gjithsesi bashkëshortja ka të drejtën e gjysmës së trashëgimisë.

Trashëgimia me testament: Duke ju referuar nenit 373 të Kodit Civil çdo individ me aftësi ligjore (sipas moshës), ashtu si dhe gratë e martuara, pavarësisht se nuk kanë moshën e duhur sipas ligjit, kanë të drejtë të bëjnë testament për pronën e tij/e saj (duhet theksuar se në rastin e pronës së përbashkët njëri nga bashkëshortët mund të përfshijë në testamentin e tij/saj vetëm 50% të pronës të krijuar gjatë martesës). Në cdo rast, sipas nenit 379, fëmijët minorenë ose minorenët e tjerë që trashëgojnë por nuk janë të brezit të parë, ose ata që trashëgojnë sipas përcaktimit nga ana ligjore (bashkëshorti/ja) nuk mund të perjashtohen nga trashëgimia ligjore. Në praktikë një pronë e fituar gjatë martesë u përket në mënyrë të barabartë bashkëshortëve, përsa kohë që nuk provohet e kundërta në gjykatë. Asnjë nga bashkëshortët nuk mund të vendose me ligj pjesën që i takon bashkëshortit tjetër.

2. LËVIZJA E LIRË DHE ZGJEDHJA E VENDQËNDRIMIT

Neni 38 i Kushtetutës garanton të drejtën e cdo individi për të zgjedhur vendin e tij/saj të banimit, dhe për të lëvizur lirisht brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Neni 12 i Kodit Civil jep përcaktimin e vendbanimit dhe garanton të drejtën e cdo të rrituri për të zgjedhur lirisht vendbanimin e tij/saj. Por megjithatë, në përgjithësi pas martesës gruaja shkon të banojë në vendbanimin e burrit.

XI.4. MUNDËSITË PËR MBROJTJE LIGJORE.

1. Mundesite në organet e drejtësisë

Ndërsa dispozitat ligjore janë në përputhje me mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, mundesite në praktike të grave në sistemin e drejtësisë për të fituar mbrojtjen e tyre janë të kufizuara nga një numër veshitësish. Para se gjithash, grate nuk janë gjithmone të ndergjegjshme për të gjitha të drejtat që ato duhet të gëzojnë, dhe si rrjedhojë ato nuk veprojnë mbi bazën e tyre. Aktivitetet për edukimin ligjor dhe fushata ndergjegjesuese kryhen nga OJQ-te, por përpjekjet e tyre janë të kufizuara kryesisht për mungesë të fondeve. Në lidhje me përmirësimin e edukimit ligjor të grave nuk ekziston asnjë program specifik qeveritar. Vecanerisht në rastet civile, procedurat ligjore janë shpesh shumë të zgjatura dhe si rrjedhojë edhe shumë të shtrenjta për paditesit, duke kufizuar në praktike mundesite për mbrojtje ligjore të grupeve me të varfra. Në fakt, megjithatë njëzërit mund të fillojnë një veprim civil duke u bazuar në aftësitë e tyre, procedurat janë shumë komplekse dhe kërkojnë asistencën e një përfaqësuesi ligjor, i cili nuk sigurohet në rrugë publike.

2. Mundesite për shërbime ligjore falas.

Shërbimet ligjore falas garantojnë nga neni 6 i Kodit të Procedurës Penale, ku për çështjet penale, i padituri ka të drejtë të marrë asistencë ligjore nëse ato nuk e përballojnë një avokat privat. Ndërsa në çështjet civile, palet mund të përfaqësohen vetë në gjykatë, duke përjashtuar rastet kur është i detyrueshëm përfaqësimi ligjor (neni 22 i Kodit të Procedurës Civile), ku sipas nenit 85 si të tilla përcaktohen çështjet që kanë të bëjnë me aftësinë e një individi për të vepruar, me interesat e minoreneve të cilat janë nën kujdestari si dhe ato çështje që duhet të prezantohen para Gjykatës së Lartë.

Megjithatë *ne teori* është e mundur ndihma ligjore (sepse nuk ka asnjë dispozitë ligjore kundër saj), *faktikisht* paditesit dhe të paditurit në çështjet civile asistohen nga avokate me pagesë që janë të zgjedhur prej tyre. Asistenca ligjore falas për grupet e pambrojtura në çështjet civile, aktualisht sigurohet nga shoqatat jo qeveritare (kombetare dhe ndërkombetare). Në vecanti Qendra Avokatore e Grave siguron ndihmë ligjore për grate në rastet e divorceve, ndarjeve, detyrimit ushqimor, kujdestarise së femijeve, për njohjen e atesise etj.

KAPITULLI XII

BARAZIA NË MARTESE DHE NË JETEN FAMILJARE

Neni 16

Shtetet Pal ëdo të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin e gruas në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe marrëdhëniet familjare. Në mënyrë të veçantë ata i sigurojnë gruas, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas:

- a) të njëjtën të drejtë për të lidhur martesë;*
- b) Të njëjtën të drejtë të zgjedhë lirisht bashkëshortin dhe të lidhë martesë vetëm me pëlqimin e vetë të lirë e të plotë;*
- c) Të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi gjatë martesës dhe në prishje të saj;*

- c) *Të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si prindër, cilado qoftë gjendja martesore, për ato çështje që lidhen me fëmijët. Në të gjitha rastet, interesi i fëmijëve është konsiderata parësore;*
- d) *Të njëjtat të drejta për të vendosur lirisht dhe me njohuri të plota për numrin dhe shkallëzimin e lindjeve e po ashtu për të marrë informacionin, arsimin dhe mjetet e nevojshme që bëjnë të mundur ushtrimin e këtyre të drejtave ;*
- e) *Të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi për çështjet që kanë të bëjnë me tutelën, kujdestarinë, ruajtjen dhe birësimin e fëmijëve ose lidhur me institucione të ngjashme , kur këto koncepte ekzistojnë në legjislacionin kombëtar; në çdo rast interesi i fëmijëve është konsiderata parësore;*
- ë) *të njëjtat të drejta personale, si burrit dhe gruas, përfshirë dhe të drejtën për të zgjedhur mbiemrin, profesionin dhe llojin e punës;*
- f) *Të njëjtat të drejta për secilin prej bashkëshortëve lidhur me pronësinë, blerjen drejtimin, administrimin, gëzimin dhe disponimin e pasurisë, si falas ashtu edhe me pagesë.*

XII.1. E DREJTA PER T'U MARTUAR.

Barazia në martesë dhe në jetën familjare është e garantuar nga Kushtetuta, Kodi i Familjes dhe Kodi Civil. Sipas Kushtetutës, neni 53, cdo individ ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje dhe martesë dhe familja gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti.

Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me dispozitat e Kodit të Familjes (Ligji nr. 6599 date 29.06.1982) dhe dispozitat e Kodit Civil. Sipas nenit 6 të Kodit të Familjes anëtarët e familjes kanë të drejta dhe detyrime të barabarta në familje. Ky nen në mënyrë specifike garanton të drejta të barabarta mes burrit dhe gruas në martesë. Sipas nenit 13 të dy bashkëshortët duhet të kenë dëshirë për t'u martuar dhe neni 22 parashikon që kur njeri nga bashkëshortët është i detyruar, atëherë martesë është e pavlefshme. Neni 26 parashikon të drejtën për të vendosur në mënyrë të pavarur për mbiemrin që secili bashkëshort do të mbajë pas martesës. Kjo bëhet në momentin e regjistrimit të martesës në zyrën e gjendjes civile nga të dy bashkëshortët personalisht dhe vendimi për mbajtjen e mbiemrit vendoset me një shkresë zyrtare.

Pronësia në martesë rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil, 1992 (neni 86 dhe 87). Sipas nenit 86 pasuritë e luajtshme, depozitat bankare dhe çdo gjë e fituar nga të bashkëshortët gjatë martesës duke përjashtuar pronat personale, janë pasuri e përbashkët. Pasuria e përbashkët presupozon që pjesët e secilit bashkëshort janë të barabarta, derisauk provohet e kundërta në bazë të kriterëve të pershtatshme. Bashkëshortët kanë të drejta të barabarta në

pasurinë e përbashkët. Madje edhe kur njëri prej tyre është marrë me punët e shtëpisë. Të tilla dispozita ligjore nuk ishin njohur para se të hynte në fuqi Kodi i vitit 1982.

Megjithatë, normalisht gruaja kur martohet shkon për të jetuar në shtëpinë e burrit (e cila nuk është pasuri e krijuar gjatë martesës), shumë shpesh gruaja nuk ka pretendime për shtëpinë. Numri i martesave në vitin 1996 ishte i njëjtë si në vitin 1986, 8.4 martesë në çdo një mijë banorë, ndërkohë që në vitin 1994 ishin 30% më pak se në vitin 1990.

Martesat janë më të shumta në zonat rurale (10 në 1) në krahasim me qytetet e mëdha. Tendenca e të rinjve është për të shtyrë martesën e tyre, veçanërisht në zonat urbane.

Martesat me shtetas të huaj filluan në vitet '90, pas një ndalimi për rreth 30 vjet.

Bashkëjetesa ose një çift i pamartuar që jetojnë së bashku, e njohur në shoqëritë e zhvilluar, është e pazakonshme në Shqipëri. Ka pak raste në kryeqytet, por kryesisht midis intelektualëve. Akoma nuk është vënë re një tendencë në rritje në lidhje me këtë fenomen. Në të shkuarën “bashkëjetesa pa një martesë civile ligjore ishte e dënueshme në rrugë administrative” ndërkohë që tani është njohur dhe pranuar nga shumica e popullsisë së re urbane.

XII.2. E DREJTA PËR T'U DIVORCUAR

Të dy bashkeshortet kanë të drejtën për paraqitur kërkesën për divorc në gjykatat civile individualisht ose bashkarisht. Gjykata sipas Kodit të Familjes nën 97 vendos për prindin që do të jetë përgjegjës për fëmijën e vogël dhe gjithashtu për kontributin e domosdoshëm për fëmijën sa ai/ajo të arrijë moshën madhore. Sipas nenit 101 të Kodit të Familjes gjykata vendos gjithashtu për pronësinë e shtëpisë.

Numri i divorceve në Shqipëri është rritur gjatë viteve '80. Në vitin 1980 numri total i divorceve ishte 2 024, ndërkohë që në vitin 1988 ai ishte 2 597 dhe në vitin 1989 prej 100 grave të martuara, 9.5 divorcoheshin. Në dy vitet e para të tranzicionit numri i të divorceve pësoi një rritje ndjeshme, në vitin 1991 ato arritën kulmin me një divorc në çdo dhjetë martesë. (Grafiku 6) Madje në qytetet e mëdha kjo përqindje ishte më e lartë. Ky kulm (jo i konfirmuar nga të dhënat e mëvonshme) është i mundshëm si pasojë e faktit që në këto vite martesat e deshtuara për një kohë të gjatë, u zgjidhën në mënyrë zyrtare. Në vitet e fundit numri i divorceve ka rënë në proporcion me numrin e martesave të reja (nga 7.5 divorce për çdo 100 martesë në 5.9 divorce në vitin 1997). Mbas 1997 vihet re një tendencë e rritjes së numrit të divorceve. (Tabela 32 dhe grafiku 6)

Diferenca sipas përqindjeve të mëparshme të divorceve është raporti midis seksëve të që kanë bërë kërkesë për divorc. Në vitin 1993, 1304 burra dhe 1589 gra paraqitën kërkesë për divorc, në 1994, 1297 burra dhe 1454 gra, dhe respektivisht në vitin 1996, 1114 burra dhe 1151 gra. Rënia e përqindjes së kërkesave për divorc nga gratë ka shumë mundësi të ndikohet nga fakti se papunësia ka prekur më shumë gratë se sa burrat dhe kjo bën që gratë të jenë në varësi ekonomike nga burrat e tyre.

Pas divorcit grate nuk perfitojne automatikisht pagesen per ushqime, ndersa kjo e drejte u jepet automatikisht vetem ne rastet kur bashkeshortja eshte e deklaruar si e paafte per te punuar dhe per nje periudhe deri ne tre vjet. Keshtu qe, pavaresisht nga kushtet ekonomike dhe papunesia e mundeshme, grate e divorcuara nuk perfitojne perkrahjen nga burri. Perkrahja e femijes ne parim duhet percaktuar ne perputhje me te ardhurat e prindit dhe mbi nevojat e femijes, ndërkohë që ne praktike gjykata cakton nje shume fikse mujore. Në rastet e divorceve gjykatat shqiptare kanë një tendencë për t'i dhene nënës kujdestarine e femijes,(kater ne pese raste).

XII. 3. TË DREJTAT E FAMILJES

Neni 11 i Kodit të Familjes garanton që anëtarët e familjes do te ndihmojne njeri tjetrin dhe do te marrin pjese ne permiresimin e standarteve te jeteses ne familje. Familja mbetet institucioni më i qëndrueshëm i shoqërisë shqiptare. Megjithate ndryshimet ekonomike kane sjelle nje pakesim te numrit te anetareve te familjes. Në fillimet e viteve '80 familja fshatare ishte e përbërë nga 6.2 anëtarë, ndërsa që në vitin 1989 kjo u zvogëlua në 5.3 anëtarë, ndërkohë që në vendet urbane ra nga 4.6 anëtarë në 3.9 anëtarë.

Ndryshimi në strukturën e familjes si rezultat se pari i periudhës komunizmit dhe me pas i asaj te tranzicionit kane ndikuar ndjeshem ne marredheniet gjinore. Ne te kaluaren orientimi i fortë patriarkal i jetës së familjes i jepte burrit mundësinë për të dominuar në politikën lokale dhe në vendimmarrjen ekonomike, ndërkohë ekonomia e sotme e tregut ka bere qe se bashku, burrat dhe grate te jene te paqarte rreth roleve te tyre. Shumica e familjeve akoma perbehen nga burri, gruaja, femijet e pamartuar dhe bashkeshortet dhe femijet e djemve te martuar.

Një tjetër efekt i tranzicionit është që mosha për martesë është në rënie për gratë fshatare, meqënëse shumica e te rinjve emigrojnë dhe meshkujt aktive seksuale jane te pakte ne numer. Kjo ndikon ne arsimimin e grave te reja te cilat shpesh fejohen dhe martohen para se ato te mbarojne shkollen, duke u kufizuar mundesite e tyre per te ardhmen.

Çiftet e reja të martuara jetojnë normalisht me prindërit e burrit ose të gruas (në raste me të rralla), deri kur të ardhurat e tyre i lejojnë qe te kene nje shtepi te tyren. Në një familje baze, të përbërë nga burri dhe gruaja, grate mund të nje status me te në qoftë se ato kontribuojne në të ardhurat e familjes dhe lindin një femijë mashkull.

Numri i familjeve me një prind është në rritje. Ndonëse nuk egzistojnë të dhëna të qarta, familjet me një prind jane si rezultat kryesisht per për shkak të vdekjeve natyrale. Vezhgimet e pjesshme tregojne se një grua drejton 80 përqind të punëve të shtëpisë si prind i vetëm.

Prej disa vitesh po punohet nga një grup ekspertësh për Kodin e Ri të Familjes, i cili do të sjellë ndryshime cilësore në rregullimin e mardhënieve brenda familjes.

SHTOJCA

TABELAT STATISTIKORE

Tabela 1: Bilanci i buxhetit të shtetit*Në milione Leke*

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Të ardhurat e buxhetit	8.291	5.168	13.31	33.48	46.83	54.41	52.91	60.35	101.8	124.8
% ndaj GDP (çm. Korente)	49	32	26	27	25	24	19	17.8	22.1	23
Shpenzimet e buxhetit	10.87	8.565	21.32	50.68	60.98	74.15	87.59	100.7	141.2	165.1
% ndaj GDP (çm. Korente)	65	52	42	40	33	32	31	30	30.6	30.4
Defiçiti i buxhetit të shtetit	-2.58	-3.4	-8.01	-17.2	-14.2	-19.7	-34.7	-40.4	-39.4	-40.3
% ndaj GDP (çm. Korente)	15.3	20.7	15.8	13.7	7.7	8.6	12.3	12	8.6	7.4

Burimi: Ministria e Financave**Tabela 2 - Bilanci i Forcave të punës⁴***Në mije*

	1992	1994	1999
Popullsia gjithsej	3190	3202	3373
Meshkuj	1580	1616	1662
Femra	1600	1586	1711
Popullsia në moshë pune	1849	1786	1911
Meshkuj	912	900	957
Femra	937	886	954
Forcat e punës	1489	1423	1305
Meshkuj	782	609	791
Femra	707	814	514
Të punësuar gjithsej	1095	1161	1065
Meshkuj	588	673	661
Femra	507	488	404
Të papunë të regjistruar gjithsej	394	262	240
Meshkuj	194	141	130
Femra	200	121	110

Tabela 3 – Papunësia e regjistruar, papunë`sia afatgjatë dhe niveli i papunësisë⁵

		1995	1996	1997	1998	1999
Të papunë të regjistruar - gjithsej	Në mije	171	158.2	193.5	235	240
Të papunë afatgjatë	Në mije	124.3	120.2	162.6	209	216
Niveli i papunësisë	Në %	12.9	12.3	14.9	17.7	18.3

⁴ Marre nga botimi “Femra dhe Meshkuj” III⁵ Marre nga “Raporti i Zhvillimit Njerezor per Shqiperine 2000” – UNDP; “Zhvillimi i Tregut te Punes 1990-1999” – INSTAT , fq.21

Tabela 4⁶ : Të punësuar në sektorin shtetëror sipas profesioneve dhe gjinisë në %

	1993		1994		1997		1998		1999	
	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Të punëuar gjithsej	35.1	64.9	36.3	63.7	38.2	61.8	39	61	41.8	58.2
Drejtues	20.9	79.1	19.8	80.2	24.2	75.8	24.5	75.5	24.4	75.6
Specialistë të lartë	43.3	56.7	46.2	53.8	46.3	53.7	46	54	45.9	54.1
Teknikë në zbatim	35.5	64.5	45.4	54.6	45.4	54.6	45.3	54.7	45.2	54.8
Nëpunës të thjeshtë	49.5	50.5	47.1	52.9	49.9	50.1	50.4	49.6	50.3	49.7
Punëtorë	32.3	67.7	29.9	70.1	28.4	71.6	29.9	70.1	38.3	61.7

Tabela 5⁷ : Të dënuar sipas grup-moshave dhe gjinive për vitet 1992-2000

Grup-moshat	1992	1993	1994	1996	1997	1998	1999	2000
14-18 vjeç								
Femra	6	2	7	16	1	1	1	4
Meshkuj	300	242	296	465	91	386	402	413
18 vjeç e lart								
Femra	85	87	83	34	41	64	27	38
Meshkuj	4051	3423	3609	3951	1065	3130	3568	3699

Tabela 6 : Përbërja e Parlamentit që nga viti 1920

Vitet	Numri		%	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
1920	0	37	0	100
1921	0	78	0	100
1925	0	75	0	100
1928	0	57	0	100
1945	6	76	7	93
1950	17	104	14	86
1958	17	171	9	93
1970	72	192	27	73
1974	83	167	33	67
1982	76	174	30	70
1990	81	169	32	68

⁶ Të dhënat janë marrë nga botimi “Zhvillimi i Tregut të Punës 1990-1999” – INSTAT fq.15

⁷ Të dhënat janë marrë nga botimi “Vjetari i treguesve sociale 2001” – INSTAT, fq.33

1991	51	199	20.4	79.6
1997	11	144	7	93




Tabela 7 : Përbërja e Parlamentit sipas postit

Pozicioni	1991		1997		% Femra
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
Kryetar i Parlamentit			1	0	0
Nën/Kryetar i Parlamentit			1	1	50
Kryetar i Komisionit parlamentar			13	1	7.1
Kryetar i Nën/Komisionit parlamentar			1	1	50
Kryetarë të grupeve parlamentare			6	0	0

Tabela 8 : Përbërja e Parlamentit sipas Partive politike, Qershor 1997

	Numri		Përqindja (%)	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Partia Socialiste	97	9	92	8
Partia Demokrate	22	1	96	4
Partia Socialdemkrate	9	1	90	10
Parti te tjera	16	0	100	0

Tabela 9 : Perberja e Komisioneve Parlamentare sipas gjinise, Qershor 1997

<i>Komisionet</i>	<i>Numri</i>		<i>Përqindja (%)</i>	
	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>
Drejtesi	12	1	92.4	7.6
Punët e Jashtme	11	0	100	0
Ekonomi, Finance, Privatizim	13	2	87	13
Bujqësia dhe Ushqimi	10	0	100	0
Industri, Transport, Tregëti	11	0	100	0
Arsimi, Kulture, Shkence dhe Sport	9	1	90	10
Informacion Publik	10	0	100	0
Te drejtat e Njeriut dhe Minoriteti	6	1	85.8	14.2
Shendetet dhe Mjedisi	8	1	89	11
Puna dhe Çeshtjet Sociale	11	2	84.7	15.3
Mbrojtja	9	0	100	0
Rendi Publik	9	0	100	0
Imuniteti, Mandatet	11	0	100	0

Tabela 10 : Përbërja e Qeverisë , Janar 2000

<i>Posti</i>	<i>Numri</i>		<i>Përqindja</i>	
	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>
Kryeminister	1	0		
Zëvendesministër	0	1		
Ministra	14	2	87.5	12.5
Zëvendesministra	16	4	80	20
Drejtorë	82	23	78.1	21.9




Tabela 11 : Zgjedhjet për Pushtetin Lokal , Tetor 1996

<i>Posti</i>	<i>Numri</i>		<i>Përqindja %</i>	
	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>
Prefekt	12	0	100	0
Kryetarë Bashkie	62	3	95.4	4.6
Kryetarë Rrethi	34	2	94.5	5.5
Kryetarë Komune	308	1	99.68	0.32
Anëtarë të Këshillave Bashkiake	886	61	93.6	6.4
Anëtarë të Këshillave të Rretheve	866	64	93.2	6.8
Anëtarë të Këshill. të Komunave	3443	105	97.1	2.9
Sekretarë të Këshillave të Rretheve	33	3	91.7	8.3
Sekretarë të Këshillave bashkiake	56	9	86.2	13.8
Sekretarë të Këshillave të Komunave	295	14	95.5	4.5

Tabela 12 : Drejtues dhe anëtarë të Gjykatave sipas seksit

<i>Pozicioni</i>	<i>Numri</i>		<i>Perqindja %</i>	
	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>
Kryetar i Gjykatës së Lartë	1	0	100	0
Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	1	0	100	0
Kryetarë të Gjykatës së Apelit	4	2	66.7	33.3
Anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë	13	2	86.7	13.3
Anëtarë të Gjykatës së Lartë	12	5	70.6	29.4
Anëtarë të Gjykatës Kushtetuese	8	1	88.9	11.1
Anëtarë të Gjykatës së Apelit	30	13	69.8	30.2

Tabela 13 : Staf drejtues në Universitete sipas gjinisë- Janar 2000

<i>Pozicioni</i>	<i>Numri</i>		<i>Perqindja %</i>	
	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>
Rektor	8	1	88.9	11.1
Zv/Rektor	7	2	77.8	22.2
Dekan	30	6	83	17
Zv/Dekan	10	3	77	23
Anëtarë Senati	151	40	79	21
Anëtarë të Këshillit të Fakultetit	344	150	70	30
Shef Departamenti	101	31	76.5	23.5

Tabela 14⁸ : Pjesmarrja në median e shkruar sipas gjinisë

<i>Emertimi</i>	<i>Numri</i>		<i>Ne %</i>	
	<i>Femra</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Meshkuj</i>
Drejtor	0	6		
Kryeredaktor	0	9		
Zv/Kryeredaktor	3	9		
Shefe Sektori	12	26		
Gazetare	72	92		

Tabela 15⁹ : Përqindja e nxënësve që mbarojnë arsimin 8-vjeçar dhe Vazhdojnë shkollën e mesme

<i>Viti Shkollor</i>	<i>% e nxënësve të 8-vjeçares që vazhdojnë shkollën e mesme</i>		
	<i>Meshkuj-Femra</i>	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>
1990-1991	97	113	82
1991-1992	72	78	64
1992-1993	70	79	61
1993-1994	72	83	58
1994-1995	60	70	50
1995-1996	55	61	48
1996-1997	65	69	60
1997-1998	63	70	55
1998-1999	67	74	58

Tabela 16¹⁰ :Numri i shkollave të mesme sipas llojit

<i>Viti arsimor</i>	<i>Sipas llojit</i>				<i>Në fshat</i>	
	<i>Gjithsej Pergjithsh. Profesional Bashkuar</i>				<i>Gjithsej</i>	<i>Pergjithsh</i>
1990-1991	827	75	575	177	568	7
1991-1992	763	89	209	465	510	20
1992-1993	650	107	95	448	428	42
1993-1994	577	161	87	329	371	86
1994-1995	472	362	69	41	288	267
1995-1996	430	352	50	24	269	262
1996-1997	408	337	51	20	259	251
1997-1998	400	337	60	3	252	247
1998-1999	394	331	54	9		
1999-2000	386	326	51	9		

⁸ Ne gazetate kryesore jane perfshire keto tituj:1)Gazeta Shqiptare 2) Koha jone 3) Zeri i Popullit 4) RD 5) Albania 6)Shekulli 7) Republika 8) Ekonomia 9)55

⁹ Të dhënat janë marrë nga “Vjetari Statistikor i Arsimit 2000” INSTAT fq.39

¹⁰ Te dhenat jane marre nga “Vjetari statistikor i Arsimit” 1998 –fq.33,2000 – fq.47, INSTAT

Tabela 17¹¹ : Disa përpjestime në sistemin e arsimit të Mesëm në %

<i>Viti arsimor</i>	<i>Numri i nxënësve në Shkollat e Mesme , ne %</i>					
	<i>Meshkuj</i>	<i>Femra</i>	<i>Përgjithsh.</i>	<i>Profesion. Ditën</i>	<i>Mbrëmje</i>	
1990-1991	55	45	28	72	70	30
1991-1992	51	49	49	51	80	20
1992-1993	48	52	63	37	87	13
1993-1994	50	50	71	29	88	12
1994-1995	51	49	78	22	92	8
1995-1996	51	49	79	21	92	8
1996-1997	52	48	82	18	92	8
1997-1998	53	47	84	16	92	8
1998-1999	52	48	85	15	90	10
1999-2000	51	49	86	14	82	12

Tabela 18 : Studentë të diplomuar në sistemin e ditës e korrespondence

<i>Viti shkollor</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Femra</i>	<i>Sistemi i ditës</i>		<i>Korespond.</i>	
			<i>Gjithsej</i>	<i>Femra</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Femra</i>
1990-1991	4647	2407	4029	2145	618	262
1991-1992	4373	2408	3633	2049	740	357
1992-1993	4416	2431	3931	2141	485	290
1993-1994	3972	2112	3343	1932	629	180
1994-1995	4436	2556	3711	2135	725	421
1995-1996	4630	2606	3702	2086	928	520
1996-1997	3708	1990	3295	1761	413	229
1997-1998	3861	2456	2861	1821	1000	635
1998-1999	3997	2612	2953	1991	1044	621

Tabela 19¹² : Studentë të diplomuar sipas shkollave të larta për vitin shkollor 1996-1997

	<i>Gjithsej</i>	<i>Femra</i>	<i>Femra %</i>
Inxhinieri Mekanike	89	18	20.2
Inxhinieri Elektrike	84	18	21.4
Inxhinieri Ndertimi	85	18	21.1
Inxhinieri gjeologji-miniera	1	0	0

¹¹ Te dhenat e tabelës 17,18 janë marre nga “Vjetari statistikor i Arsimit” 1998,2000 – INSTAT, fq.45, fq.56


¹² Te dhenat janë marre nga “Vjetari Statistikori Arsimit “ 1998- INSTAT fq.56

Ekonomik	481	238	49.4
Histori-filologji	164	115	70.1
Gjuhë të huaja	207	144	69.5
Mjekësia	432	207	47.9
Shkenca Sociale	50	40	80
Drejtësia	299	127	42.4
Shkenca të Natyrës	708	439	62
Bujqësore	164	59	35.9
Shkencave Pyjore	65	10	15.3
Veterinaria	88	16	18.1
Shkenca Shoqërore	493	313	63.4
Mësuesia	240	215	89.5
Muzika	61	22	36
Arte Figurative	27	7	25.9
Arti Skenik	26	8	30.7
Kultura Fizike	81	14	17.2

Tabela 20¹³ : Studentë të pranuar të rinj per çdo fakultet për vitin shkollor 1999-2000

<i>Fakulteti</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Femra</i>	<i>% Femra</i>
Inxhinieri Mekanike	145	53	36.5
Inxhinieri Elektrike	223	37	16.6
Inxhinieri Ndertimi	274	92	33.5
Inxhinieri gjeologji-miniera	91	22	24.17
Ekonomik	1084	647	59.6
Histori-filologji	332	277	83.4
Gjuhë të huaja	429	350	81.5
Mjekësia	299	201	67.2
Shkenca Sociale	149	122	81.8
Juridik	206	104	50.4
Shkenca të Natyres	776	511	65.8
Bujqesoe	528	233	44.1
Shkencave Pyjore	73	17	23.28
Veterinaria	44	12	27.27
Shkenca Shoqerore	917	654	71.3
Mesuesia	851	791	92.9
Muzika	54	25	46.3
Arte Figurative	51	19	37.2
Arti Skenik	25	14	56
Kultura Fizike	82	20	24.4
Tregëtise	141	93	65.9
Marinës	48	2	4.16

¹³ Te dhenat jane marrë nga botimi “Vjetari Statistikor i Arsimit 2000” – INSTAT fq.70

Graf.1 : Braktisja e shkolles në % nga nxënësit e 8-vjeçares**Tabela 21¹⁴ : Shkalla e papunësisë sipas gjinisë**

	1989	1993	1994	1997	1998	1999
Shkalla e papunësisë sipas gjinisë	7	22	18	15	18	18
Femra	8	24	20	17	21	21
Meshkuj	6	21	17	14	16	16

¹⁴ Të dhënat e tabelës 21,22 janë marrë nga botimi “Zhvillimi i tregut të punës 1990-1999” – INSTAT fq.21, 30




Tabela 22 : Paga mesatare mujore për një të punësuar sipas grupimeve kryesore të profesioneve (Sektori Shtetëror)

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Paga mesatare mujore	3084	4778	6406	8638	9558	11509	12708	14963
Për një drejtues	4595	7503	10105	14067	16129	19450	22750	24437
Për një specialist	3447	5334	7747	10158	11554	13877	15913	18159
Për një teknik	3044	4756	6286	8237	8440	9411	11951	13482
Për një nëpunës të thjeshtë	2905	4674	6116	7645	8483	9603	12829	14415
Për një punëtor	2833	4215	5701	7242	7974	9119	8605	12394

Tabela 23 : Numri i drejtuesve të biznesit privat sipas viteve dhe seksit

Vitet	Numri		Përqindja %
	Gjithsej	Femra	
1994	32968	6868	20.8
1997	58626	10772	18.3
1998	56453	9800	17.4

Tabela 24 : Bizneset e grave në sektorë të ndryshëm

Lloji i biznesit	Gjithsej	1996		Gjithsej	1998	
		Femra	%Femra		Femra	%Femra
Bujqësi	1466	31	2.11	1241	32	2.57
Industri-Agrobiznes	5231	560	10.7	5674	606	10.7
Ndërtim	1417	93	6.56	1905	124	6.5

Tregëti	30750	6501	21.14	29370	6415	21.8
Transport	9117	150	1.64	8199	157	1.9
Shërbime	9732	2342	24	10042	2564	25.5
Total	57712	9677	16.7	56453	9902	17.5

Tabela 25 : Abortet sipas grupmoshave për periudhën 1994-1997¹⁵

<i>Grupmoshat</i>	<i>1994</i>	<i>1995</i>	<i>1996</i>	<i>1997</i>
13-19	3.5	4.9	2.7	3.6
20-34	67	63.2	58	64.4
35+	27.7	19.5	26.4	32




Tabela 26 : Abortet sipas nivelit arsimor të grave për periudhën 1994-1997

<i>Shkalla arsimore</i>	<i>1994</i>	<i>1995</i>	<i>1996</i>	<i>1997</i>
Fillor	2.5	2.5	1.8	0.7
8-vjeçar	47.6	47.1	47.9	32.9
i mesëm	44.3	47.1	45.1	62.7
i Lartë	4.7	3.3	3.2	3.4

¹⁵ Te dhenat e tab.25,26,27 jane marre nga libri "Tregues te shendetit per vitet 1994-1998", fq.99,100 INSTAT





Tabela 27 : Aborti sipas llojit dhe vendbanimit

Vitet	Gjithsej	Lloji i abortit			Qytet	Vendbanimi FSHAT
		Provokuar	Spontan			
1994	18361	14456	3905	10455	7906	
1995	17504	13615	3889	9057	8447	
1996	10310	8435	1875	5738	4572	
1997	10564	8979	1585	6312	4252	

Tabela 28 : Aborte per 100 lindje të gjalla 1994- 1999 ¹⁶

Vitet	Abortet për 1000 lindje të gjalla
1994	435
1995	449
1996	480
1997	400
1998	380
1999	390

¹⁶ Te dhenat e Tab. 28 jane marre nga botimi “Vjetari i Treguesve Sociale 2001”, fq.28- INSTAT



Tab. 33: Tregues të shërbimit spitalor¹⁷

Indicators of hospital service

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Spitale Hospitals	51	51	51	51	51	51	51
Shtreter gjithsej Total Beds	9661	10371	10319	10133	9480	10237	10197
Shtime gjithsej Total hospitalizations	28199	288856	289268	255203	250043	265321	260770

Tab 34: Tregues te sherbimit mjekesor pa shtreter

	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000
Qendra mjeksore pa shtreter Medical center without beds	2733	2507	2437	2155	2257	2191	2241
Poliklinika Clinics	58	53	53	53	53	51	51
Qendra Shendetesore Health center	702	622	637	602	637	567	611
Ambulanca Ambulances	1973	1832	1747	1500	1563	1573	1579

¹⁷ te dhenat jane marre nga "Vjetari i treguesve sociale 2001" – INSTAT, fq.28

Tabela 29: Struktura e vdekshmërise foshnjore¹⁸

NR	Emertimi	1994
	Lindjet e gjalla	72179
1	Vdekjet sipas gjinisë	2547
	Meshkuj	1390
	Femra	1152
	Panjohur	5
2	Vdekjet sipas grup-moshës	2547
	0-1 ditë	510
	1-6 ditë	318
	7-27 ditë	578
	28-364 ditë	1141
3	Shkaku i vdekjes	2547
	Sëmundjet infektive	115
	Sëmundjet pulmonare	959
	Sëmundjet gastrointestinale	333
	Sëmundje e të porsalindurit	339
	Sëmundje te Anom. Kongenitale	188
	Sëmundje te tjera	392
	Pa diagnozë + Të papritura	221
4	Vendi i vdekjes	2547
	Institucion	1316
	Spital	801
	Shtëpi lindje	515
	Shtëpi	1231
5	Vdekjet për rreth lindjes	1040
	para lindjes	369
	Gjatë lindjes	161
	pas lindjes	510
6	Vdekjet sipas vendbanimit	2547
	qytet	759
	fshat	1788

Tabela 30 : Vdekshmëria mëmësore në Shqipëri¹⁹


Emërtimi	Vitet	
	1994	1995
Numri i grave të moshës 15-49	819717	835659
Numri i Barrave	103471	104349
Numri i lindjeve	72179	72081
Numri i vdekjeve në gra gjatë lindjes	29	21
Ritmet e vdekshmërise amtare		
vdekjet 100.000 gra, mosha 15-49	3.53	2.5
vdekje per 100.000 barra	28.2	19.8

¹⁸ Të dhënat janë marrë nga botimi “Tregues të shëndetit për vitet 1994-1998” – fq.41, INSTAT


¹⁹ Te dhenat jane marrenga “Tregues të shëndetit për vitet 1994-1998” – fq.91, INSTAT

vdekje per 100.000 lindje të gjalla	40.6	28.5
Numri i vdekjeve gjatë abortit	6	3
Raporti i vdekshmerisë amtare gjate abortit	0.7	0.4

Grafiku 2²⁰ : Përdorues droge për çdo 1000 banorë




Grafiku 3 : Përdorimi i llojeve të ndryshme të drogave



Grafiku 4²¹ : Sifilisi për vitet 1993-1998

²⁰ Te dhenat e paraqitura ne grafiket 2,3 jane marre nga “Raporti i zhvillimit Njerezor per Shqipërinë 2000” UNDP

²¹ Grafiket 4,5 jane marre nga botimi i UNDP “Albanian National Women Report 1999”, fq. 30



Graf. 5: Gonorrea në vitet 1981-1998




Tabela 31²² : Shpërndarja e familjeve sipas zoterimit të të paktën nje pajisje afatgjatë dhe zonave

	Zona 1		Zona 2		Totali	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%
TV bardhë-zi	31767	4.3	193372	26.4	225139	30.7
Tv me ngjyra	215170	29.3	265996	36.3	481166	65.6
Video	49432	6.7	38555	5.3	87987	12
Antenë satelit	57473	7.8	94099	12.8	151572	20.6
Frigorifer	222887	30.4	286976	39.1	509863	69.5
Makinë larëse rrobash	169223	23.1	61361	8.4	230584	31.5
Makine lërese enësh	5703	0.8	3846	0.5	9549	1.3
Fshese me korent	68043	9.3	21361	2.9	89404	12.2
Sobë gatimi me korent-gaz	174605	23.8	144326	19.7	318931	43.5
Sobë me mikrovale	13378	1.8	9282	1.3	22660	3.1

²² Te dhenat jane marre nga botimi “ Rezultate te Anketes se Nivelit te Jeteses tetor 1998” – INSTAT fq.61

radiator	108960	14.9	73238	10	182198	24.9
Sobë me dru	69792	9.5	362870	49.5	432662	59
Sobë ngrohje me gaz	23498	3.2	15683	2.1	39181	5.3
Sobë ngrohje me vajguri	18253	2.5	6619	0.9	24872	3.4
Impiant stereo	35362	4.8	32968	4.5	68330	9.3
Biçikletë	62139	8.5	79615	10.9	141754	19.4
Motor	7990	1.1	12397	1.7	20387	2.8
Veturë	27987	3.8	19025	2.6	47012	6.4
Kompjuter	4771	0.7	850	0.1	5621	0.8
Shtëpi të dytë	5655	0.8	7324	1	12979	1.8
Traktor	467	0.1	5298	0.7	5765	0.8
Gjithsej familje	248276	33.9	484983	66.1	733259	100

Tabela 32²³ : Martesat dhe divorcet për vitet 1990-1999

<i>Vitet</i>	<i>Martesa</i>		<i>Divorcet</i>	
	<i>Gjithsej</i>	<i>per 1000 banore</i>	<i>Gjithsej</i>	<i>Per 100 martesa</i>
1990	28992	8.9	2675	9.2
1991	24853	7.6	2236	9
1992	26405	8.3	2480	9.4
1993	25963	8.2	2251	8.7
1994	27895	8.7	2108	7.6
1995	26989	8.3	2331	8.6
1996	27690	8.4	1901	6.9
1997	24122	7.3	1430	5.9
1998	27871	8.3	2005	7.2
1999	27254	8.1	2114	7.8

Grafiku 6 : Raporti i divorceve per 100 martesa

²³ Te dhënat janë marrë nga botimi “ Vjetar i Treguesve sociale 2001” – INSTAT fq.12

